Rruga e Arbërit

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 5 (189) MAJ 2022. ÇMIMI: 50 LEKË. 0,5 €

BIG market
PESHKOPI MAQELLARË
Plot oferta dhe surpriza...

REPORTAZH

Rrugës së Arbrit drejt Prizrenit, mes mundimit dhe magjisë

Nga **ÇAPAJEV GJOKUTAJ** — Faqe 3

STUDIM

Shkëmbinjtë dhe mineralet industrialë jo metalorë të Shqipërisë

Nga **prof. dr. BASHKIM LLESHI** — Faqe 14

MIRËNJOHJE

A ka heronj dhe heroizëm sot në jetën tonë?


Nga **XHAFER MARTINI** — Faqe 16

Dibra çel sezonin turistik, mundësi të reja për zhvillimin ekonomik të rajonit

— Faqe 2-3

Tri ditë veprimtari në Dibër, një mundësi për promovimin e bukurive dhe prezantimin e vlerave dhe traditës së zonës.

"Dibra është vendi i bekuar, me natyrë të jashtëzakonshme, me peizazhe unike, me njerëz punëtorë e mikpritës. Vizitorët dhe turistët kanë mundësi të provojnë përvoja të ndryshme të turizmit të natyrës, turizmit malor, atij kurativ etj., si dhe të shijojnë gatimet tipike të zonës në bujtinat që sa vijnë e shtohen"



Fotografia e Dorian Bulkut në Liqenin e Madh në Lurë, e cila fitoi çmimin e parë në konkursin "Ngjyrat e Dibrës"

PROTESTA NË SKAVICË DHE URA E LUSHËS

Të ndalohen punimet në Skavicë

— Faqe 7

OPINIONE

Lëreni Drinin të rrjedhë në shtratin e tij...

Nga **AGIM CANI** — Faqe 6

Dibra, "jastëku" i lagur i Ramës

Nga **MAJLINDA HOXHA** — Faqe 5



Pamje nga punimet në hapjen e rrugëve që të çojnë në vendin ku do të ndërtohet diga në Skavicë

SETA E THYER, DIKUR NJË MREKULLI NATYRORE, SOT NJË KASKADË HIDROCENTRALESH

INA - Investigative Network Albania heton kontratat koncensionare mbi hidrocentralet e ndërtuara mbi lumin Seta — Faqe 4



EDLIRA HAXHIYMERI
(28 shkurt 1960 - 14 maj 2022)

Ndahet nga jeta prof.dr. Edlira Haxhiymeri, një personalitet i spikatur i botës akademike

Me personalitetin dhe shembullin e saj ndriçoi dhe ndryshoi jetën e shumë njerëzve dhe fali dashuri pa kushte

Nga **NIKOLETA MITA**

Edlira Haxhiymeri, intelektuale e përmasave kombëtare e ndërkombëtare

Edlira Haxhiymeri nuk nguroi kurrë të përdorte imazhin dhe lidhjet e saj për të ndihmuar dibranët dhe për të promovuar Dibrën me të gjitha mundësitë e saj. Ajo luajti një rol të rëndësishëm në organizimin e komunitetit dibran në Tiranë.

Nga **MUSA RIÇKU**

Pranvera plot lule e Edlira Haxhiymerit

INTERVISTË NGA ARKIVI
Nga **FLORA NIKOLLA**
FAQE 10-13

Gazeta "Rruga e Arbërit" është një media e lirë dhe e hapur.
Çdo kontribut me shkrime, abonime ose donacione është i mirëpritur!
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro.
Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

Posta e Rruga e Arbërit

Gazetë e pavarur. Nr. 5 (189). Maj 2022
Gazeta doli nga shtypi, 6 qershor 2022.
Gjendet në treg gjatë gjithë muajit qershor 2022.

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.

Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.

Shkrimet refuzohen për botim vetëm në rast se merrni përgjigje me email. Për çdo rast tjetër shkrimet priten për botim në numrat e radhës.

Shkrimet në redaksi për numrin e radhës priten deri më **datë 20** të muajit, përveç rasteve të bashkëpunëtorëve të rregullt.

Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**

GJITHASHTU, KUJTOJMË SE ÇDO SHKRIM I BOTUAR NË NJË MEDIA TJETËR APO RRJETE SOCIALE NUK KA PËRPARËSI BOTIMI.

JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN "ë".

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

BOTUES:
Musa Riçku
Bujar Karoshi
Shaqir Skarra

Editor i faqes online: Agim Deva

Kontribuan për këtë numër:
Osman XHILI
Abdurahim ASHIKU
Adriatik BALLA
Agim CANI
Bashkim LLESHI
Çapajev GJOKUTAJ
Flora NIKOLLA
Haki PËRNEZHA
Halil RAMA
Ismen BRIKA
Jona KASO
Llesh NDOI
Majlinda HOXHA
Nikoleta MITA
Shaqir ÇERPJA
Xhafer MARTINI
Xhevat JELLA
Zabit LLESHI

KËRKOHEN KORRESPONDENTË NË PESHKOPI DHE DIBËR TË MADHE

Të interesuarit për korrespondentë/menaxherë duhet të kenë pasion gazetarinë. Përbën avantazh përvoja në shtypin e shkruar ose në qoftë se kanë mbaruar studimet për gazetari dhe letërsi / marketing. Të jenë të angazhuar për punën në grup dhe të jenë të pavarur politikisht gjatë kohës që bashkëpunojnë me gazetën.
Të interesuarit të shkruajnë email
në adresën <rrugaearberit@gmail.com>
ose të telefonojnë në numrin 069 20 68 603.

Arkivi i gazetës është PA pagesë në faqen e internetit **www.rrugaearberit.com.**
Falënderojmë z. **AGIM DEVA** për kontributin e vazhdueshëm për mirëmbajtjen e faqes së gazetës në internet dhe arkivin online.
Pajtimet në gazetë mund t'i bëni në çdo kohë duke komunikuar në adresat e redaksisë.
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit
<rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro. Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.
Për kontribute për gazetën mund të kontaktoni redaksinë ose mund t'i bëni ato përmes numrit të llogarisë më poshtë:
Raiffeisen Bank
Rruga e Arberit / NIPT: K82019002S
Nr. llog. në lekë: 0010036640
IBAN: AL44 2021 1219 0000 0000 1003 6640

Adresa e gazetës:
Rr. "Zenel Baboçi",
Pall. "Ferar", Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
+355 69 20 68 603
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë
Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

Dibra çel sezonin turistik, mundësi të reja për zhvillimin ekonomik të rajonit

Tri ditë veprimtari në Dibër, një mundësi për promovimin e bukurive dhe prezantimin e vlerave dhe traditës së zonës.



Pamje nga festa. *Foto: Bashkia Dibër Faqja Zyrtare/FB*

Bashkia e Dibrës hapi sezonin turistik me një serë veprimtarish, që filluan të premten me 27 maj dhe përfunduan të dielën, me datë 29 maj.

Gjatë këtyre ditëve pati veprimtari të ndryshme kulturore e artistike, ekspozita që evidentuan historinë dhe traditën, ushqime tradicionale, ture turistike dhe rafting në Dri.

Ceremonia e hapjes së veprimtarive u zhvillua në sheshin para Pallatit të Kulturës më 27 maj në mesditë, ndërsa më herët një paradë e motorëve Vespa u zhvillua në bulevardin "Elez Isufi".

Po në bulevard ishin vendosur edhe çadra ku operatorë turistikë në rajon ekspozuan ofertat e tyre turistike gjatë këtij sezoni, si dhe u zhvilluan një një serë veprimtarish të tjera.

Dokumentari "**KUSH ËSHTË 'DIBRANËT'**" i regjizores së njohur Donika Mustafaj, prodhim i RTSH, u shfaq për herë të parë në Peshkopi me 27 maj në orën 16:00 në Pallatin e Kulturës. Dokumentari u ndoq me interes nga të pranishmit. Në këtë dokumentar Donika Mustafaj përqendrohet te dibranët, te një nga bashkësitë krahinore më të spikatura të Shqipërisë, të cilin ajo nuk e ka zgjedhur rastësisht. Autorja nuk e fsheh që nxitjen e pare për këtë vepër e ka marrë nga "borxhi" që ndjente ndaj vendlindjes. Ky film është konceptuar që në zanafillë si një himn për virtytet e dibranëve. Ajo ka qëmtuar me seriozitet dhe realizëm në trashëgiminë e pasur kulturore dhe zakonore të kësaj krahine, e cila ndahet përgjysmë nga kufiri shtetëror midis Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut, duke nxjerrë në pah kryesisht ato virtute me vlerë të dyfishtë: edhe si përbashkuese të dallueshme midis dibranëve, edhe si arterie lidhëse jetike me identitetin kombëtar të shqiptarit. Nëpërmjet një paradoksi gjuhësor të theksuar qysh në titull, autorja synon të tërheqë vëmendjen te fakti se "dibranët" nuk janë një grumbull njerëzor me një fytyrë të përbashkët, por janë secili veç e veç individualitete me personalitet të qartë.

Pas dokumentarit, në praninë e publikut, para Pallatit të Kulturës u dha një koncert nga këngëtarët e artistët dibranë Liri Rasha, Vera Laçi, Ingrid Jushi, Lirim Hoxha etj. si dhe u shoqërua nga vallet tradicionale të ansamblit "Hazis Ndreu". Kulmi i ditës së parë ishte atmosferën e jashtëzakonshme që dhuroi grupi legjendar i rrokut "Elita 5", në praninë e një publiku të shumtë që këndoi së bashku me grupin gjatë gjithë kohës.

Në ditën e dytë të festës, me interes u ndoq edhe koncerti i grupit të talenteve të reja në kitarë, me mësuesin Ermal Lushi, i cili prej disa vitesh ofron falas kurse të kitarës në Peshkopi. Për një kohë të shkurtër ky grup ka arritur të këndojë dhe luajë pjesë të ndryshme muzikore me kitarë. Natën e fundit festive e mbyllën këngëtarët Lorenc Hasrama dhe Fatjon Dervishi.

Një nga veprimtaritë që u ndoq me interes ishte edhe ekspozita me fotografi të titulluar "Ngjyrat e Dibrës", e cila përmes angazhimit vullnetar të pasionuarve pas fotografisë, kishte si qëllim shpalosjen dhe promovimin e destinacioneve turistike dhe natyrore të Dibrës.

Lindita Manga, drejtuese e fondacionit ALCDF dhe Sajmir Kojnozi, zv.kryetari i bashkisë Dibër, ndanë çmimet për fotografitë më të bukura. Me çmim të parë u vlerësua, Dorian Bulku, me çmim të dytë u vlerësua, Albina Roshi dhe me çmim të tretë u vlerësua gjimnazi "Fiqiri Dine".

Disa nga veprimtaritë e tjera në këto ditë ishin edhe turet malore me biçikleta, rafting në lumin Drin, paradë veshjesh me kostume popullore etj. Ndërsa disa nga restorantet kryesore në qytet patën muzikë live, duke ofruar për turistët e shumtë argëtim.

"Mes ngjyrash të kostumeve popullore, prodhimeve të fermerëve, gatimeve tradicionale, energjisë së të rinjve dhe ritmeve të muzikës, Peshkopia dukej më e bukur se kurrë", shkroi në Facebook Almira Xhembulla, zv. Ministre e Turizmit dhe Mjedisit.

Sipas saj, kjo festë ishte një mundësi unike për promovimin e bukurive dhe prezantimin e vlerave dhe traditës së zonës.

"Dibra është vendi i bekuar me natyrë të jashtëzakonshme, me peisazhe unike, me njerëz punëtorë e mikpritës. Vizitorët dhe turistët kanë mundësinë të provojnë përvoja të ndryshme të turizmit të natyrës, turizmit malor, atij kurativ etj., si dhe të shijojnë gatimet tipike të zonës në bujtinat që sa vijnë e shtohen", shkroi ajo në profilin e saj zyrtar në FB.

Hapja e sezonit turistik në Dibër u krye nën kujdesin e kryetarit të ri të bashkisë, z. Rahim Spahiu.

"Dibra n'fest" jo vetëm i dha gjallërinë e munguar për 3 ditë me radhë qytetit, por ishte nisja e duhur drejt një impuls të ri zhvillimi për turizmin në Dibër!" - shkruhej në faqen zyrtare të Bashkisë së Dibrës në Facebook.

"Nga Drini në Korab, nga Lura në Radomirë, nga Kalaja e Grezhdanit në Muzeun e Skënderbeut në Sinë, nga burimet e njohura termale tek ujëvarat dhe liqenet me ujin kristal, nga mundësitë e shumta për agroturizëm e deri te sportet e aventurës, Dibra është një thesar i çmuar që duhet zbuluar e shijuar në çdo pëllëmbë të saj!"

ALCDF KONTRIBUON NË ORGANIZIMIN E "DIBRA N'FEST"

Fondacioni Shqiptarë i Zhvillimit të Kapaciteteve Lokale (ALCDF) është një nga promotorët e zhvillimit të zonës së Dibrës dhe veçanërisht i sektorit të turizmit. Pothuajse të gjitha botimet e produkteve turistike, shtigjet e ndërtuara dhe të markuara, sinjalistika, zyra e informacionit turistik, bujtinat dhe kampingjet e ndërtuara dhe organizimi i festave lokale kanë vulën e ALCDF. Edhe në këtë veprimtari ALCDF nuk mungoi të kontribuojë në çeljen e sezonit turistik me angazhimin e stafit të palodhur të kësaj organizate.

Besnik Alku, menaxher i projekteve në këtë organizatë, thotë për gazetën "Rruga e Arbërit" se "ndihet i kënaqur që tashmë



Pamje nga veprimtaria artistike e zhvilluar në kalanë e Grezhdanit nga nxënësit e shkollës së mesme "Fiqiri Dine", nën drejtimin e mësuese Zamira Gjeleshi

aktualitet

“Dibra është vendi i bekuar, me natyrë të jashtëzakonshme, me peizazhe unike, me njerëz punëtorë e mikpritës. Vizitorët dhe turistët kanë mundësi të provojnë përvoja të ndryshme të turizmit të natyrës, turizmit malor, atij kurativ etj., si dhe të shijojnë gatimet tipike të zonës në bujtinat që sa vijnë e shtohen”

Bashkia Dibër, që është autoriteti vendorë, ka marrë përgjegjësinë kryesore për organizimin e këtij eventi dhe shumë aktorë të tjerë institucionalë si Drejtoria e Bujqësisë, Policia, Drejtoritë e shkollave, Drejtoria e Kulturës dhe OJF lokale kanë qenë aktive”.

“Ajo që dallohet në këtë ngjarje - thotë Alku, ka qenë angazhimi i sektorit privat që është dhe përfituesi kryesore i turizmit, si me organizimin e festës, por edhe me ndarjen e informacionit. Kjo është ajo për të cilën ka punuar ALCDF me grupin e festave për të kuptuar që festat lokale janë një instrument i rëndësishëm i promovimit të zonës dhe duket se ALCDF ja ka arritur të ndryshojë kapacitet dhe sjelljen e aktorëve vendore për të qenë më festiv dhe më organizatorë në ngjarje të tilla promocionale”.

Lindita Manga, drejtoresha e ALCDF, e palodhur dhe me shumë pasion përgjatë gjithë javës së organizimit të kësaj ngjarje të madhe promovuese, me modesti na shpjegoi që “ALCDF këtë vit ndoqi një taktikë pak më të tërhequr, për ti lënë aktorët vendorë të kenë rolin e lidershipit dhe sidomos Bashkia në koordinimin e grupit të festave’ Zyra e Informacionit turistik në organizimin e eventeve dhe aktorët e tjerë si Black Drini Rafting, Resthouse Korabi dhe Shkolla e mesme «Fiqiri Dine» e Maqellarës të demostrojnë aftësi në organizimin e ngjarjeve turistike dhe promovojnë bizneset dhe veten e tyre”.

“Në këtë kuadër ALCDF mbështeti organizimin e ekspozitës së ngjyrave, që qëndroi e hapur për tre ditë, por për gati 2 muaj shumë pasionante të Dibrës sollën fotografitë e tyre, u bë përzgjedhja dhe printimi, dhe në fund të ditës së tretë u ndanë edhe çmimet për fotografinë më të mirë, duke nxitur kështu që çdo dibran të mund të jetë ambasadorë i vendit të tij”.

Manga tha se veprimtaria tjetër e mbështetur nga ALCDF, në bashkëpunim me shkollën e Maqellarës, organizuan ngjarjen artistike në kalanë e Grezhdanit, ku nxënësit e shkollës së mesme «Fiqiri Dine», nën drejtimin e mësuese Zamira Gjeleshit, me kostume popullore improvizuan pjesë artistike të jetës në kalanë e Grezhdanit, duke tërhequr interesin e shumë vizitorëve që erdhën dhe vizituan kalanë, duke promovuar në këtë mënyrë vlerat kulturore të kalasë por edhe të Dibrës.

“Nga Drini në Korab, nga Lura në Radomirë, nga Kalaja e Grezhdanit në Muzeun e Skënderbeut në Sinë, nga burimet e njohura termale tek ujëvarat dhe liqenet me ujin kristal, nga mundësitë e shumta për agroturizëm e deri te sportet e aventurës, Dibra është një thesar i çmuar që duhet zbuluar e shijuar në çdo pëllëmbë të saj!”

“Nuk mund të lihet pas dore promovimi i qershisë, fruti i parë dhe më dallues i Dibrës”, - theksoi Lindita. ALCDF, në bashkëpunim me nxënësit e shkollës së Maqellarës dhe fermerë të zonës së Melanit, organizuan në plantacionet e qershive një demonstrim të mbledhjes së frutave dhe lojëra të tjera për të promovuar frutin, por edhe bukuritë e plantacioneve me qershi. Një nxënëse e talentuar në pikturë nga Maqellara pikturoi frutat dhe plantacionet e qershive, dhe promovuan eventin në rrjetet e tyre sociale.

“Nuk mund ta linin jashtë vëmendjes dhe mbështetjes Fluturim Elezin dhe Resthouse Korabin, thotë Lindita Manga, në nismën e tij për organizimin e «Festës së Bjeshkës» në Llapshnik të Zimurit, që megjithëse mot i keq, por ishte një organizim perfekt, me pjesëmarrje nga nxënësit e shkollave të qytetit, vizitorë nga Shkodra, Tirana dhe turistë të huaj, të kësaj bukurie të rrallë, vetëm 20 minuta nga Peshkopia”.

Zenulla Mehmeti, menaxher i projekteve të ALCDF, me urtësinë e tij na shpjegoi për aktivitetet e turizmit të aventurës që u promovuan gjatë këtyre ditëve festive.

“Biçikletat malore ishin në qendër të vëmendjes - thekson Zenullahi, - pasi në bashkëpunim me Qarkun Dibër dhe komunën e Rostushës dhe financim të Bashkimit Europian në Maqedoninë e Veriut, janë bërë funksionale më shumë se 140 km shtigjesh për biçikletat malore në dy anët e kufirit, me standarde europiane teknike dhe janë aftësuar guidat vendore për të shfrytëzuar këto shtigje, që janë më të mirat në Shqipëri dhe Maqedoninë e Veriut”

Gjatë një jave Zenullahi ka shoqëruar një grup gazetarësh nga Gjermania, të cilët do të promovojnë turizmin në revistat dhe portalet më të mira në Gjermani, që nga natyra, kulinaria, shtigjet e biçikletave, shtëpitë pritëse dhe festat e organizuara në vendin e tyre.

“Një grup nga Dibra e Madhe, Mavrova dhe Shkupi erdhën me biçikleta dhe provuan dhe shijua festën dhe shtigjet malore të Hinoskës, Hoteshit dhe Rabdishtit”.

Një prezantim i bukur i Dibrës ishte edhe video prej 3 minutash e përgatitur në gjuhën gjermane e nxënësve të shkollës “Nazmi Rushti”, nën kujdesin e mësuesit Drilon Murrja.

Nuk mund të flasim për turizmin e aventurës pa përmendur rafting në Drinin e Zi. Një bashkëpunimin I ALCDF dhe agjencinë “Black Drini adventure” drejtuar nga Edi Truka, u arrit që për shumë nxënës të shkollës së Maqellarës, dhe pedagogë, agjenci turistike, zhvillues nga Holanda, të huaj dhe vendas, u mundësua një tur raftingu, si një ide për të ftuar turistë të tjerë nga vendi e botë për të ardhur në Dibër.

Anita Zebi, një tjetër staf i ALCDF, sëbashku me Nevila Manga, specialiste e turizmit në bashkinë Dibër, theksuan që “organizimi i tendeva të panairit me materiale promovuese nga të gjitha bujtinat dhe operatorët turistikë është tashmë bërë traditë dhe duhet të vazhdojë”.

“ALCDF mbështeti shtëpitë pritëse dhe artizanët që të promovojnë produketet dhe bizneset e tyre, duke u krijuar lehtësirat e nevojshme”.

“Këto festa, duhet të jenë të vazhdueshme, jo mbase me këtë gamë sa këto tre ditë, por të vazhdojnë dhe të shpërndahen në të gjithë territorin, duke i bërë banorët krenarë për potencialet turistike të vendit dhe të tjerët të ftohen që të vizitojnë Dibrën”, theksoi Anita.

“Dibra n’Fest” ishte një hapje e mbarë për sezonin turistik, duke treguar se rajoni ka mundësi të mira për zhvillimin e sektorit të turizmit, duke sjellë më shumë punësi, zhvillim dhe të ardhura për banorët e Dibrës.

Korresp. Rr.A.



Rrugës së Arbrit drejt Prizrenit, mes mundimit dhe magjisë

Nga **ÇAPAJEV GJOKUTAJ**

Për fundjavë thamë të shihnim Rrugën e Arbrit që është hapur qysh në nëntor, të vazhdonim Peshkopi-Kukës, të bujtnim në Prizren dhe të nesërmen të ktheshim përmes Rrugës së Kombit. Udhëtim shumë lakadredhas sidomos në ditën e parë, po mesa duket mbyllja e gjatë nga pandemia na kishte ndezur deshirën për udhëtim, siç ndez “hyjtë errësina”, do thoshte poeti.

Kënaqësisë që të japin kilometrat e para të Rrugës së Arbrit, buzë lumit e mes malesh, shpejt ia zuri vendin trysnia që krijohej nga që, për shkak të terrenit rrëshqitës korsia e majtë nuk ishte asfaltuar dhe të duhej të bëje kujdes me makinat që vinin përballë.

Por Golgota fshihej në bypass-in e Murrizit, ku rruga fare e ngushtë, tejet e perpjetë dhe me kthesa të shumta e dramatike të bënte të ndiheshe se, me makinën mbi supe po ngjitje Rrugën e Mundimeve.

Si të mos mjaftonte cfilitja prej terrenit dhe prej burive nervoze të atyre që vozisnin pas e thuajse ngjitur teje, në një të përpjetë afër majës u shaqën dy gra me tre katër lopë. “S’asht vetëm për ju rruga, asht edhe për ne”, hakërrehej njera nga gratë pa e prishur terezinë se lopët kishin zenë rrugën. Për të shfryrë sadokudo u bëra cinik e thashë me vete se gruaja nevrike perfshinte tek vetori “ne” edhe lopët, që vazhdonin të çapiteshin në mes të rrugës pa e çarë shumë për nervozimin e dykëmbëshve.

Pas gjithë atij stresi provoje një ndjenjë lehtesimi kur në largësi shihje urën e Vashës që, hedhur mbi një hon të thellë, lidhte dy tunele. Po kur hyje brenda tuneleve pa ndriçim e pa kurrfarë sinjalistike rrugore, përjetoje ndjesinë e të qenit në haur. Mes kësaj ndjesie të ngjante se dëgjoje alter egon e Edi Ramës që parodizonte të zotin dhe përsëriste me shpejtesinë e rrotullimit të gomave frazën proverbiale: rrugë të lëna rrugëve...



Kënaqësisë që të japin kilometrat e para të Rrugës së Arbrit, buzë lumit e mes malesh, shpejt ia zuri vendin trysnia që krijohej nga që, për shkak të terrenit rrëshqitës korsia e majtë nuk ishte asfaltuar dhe të duhej të bëje kujdes me makinat që vinin përballë.

Golgota fshihej në bypass-in e Murrizit, ku rruga fare e ngushtë, tejet e perpjetë dhe me kthesa të shumta e dramatike të bënte të ndiheshe se, me makinën mbi supe po ngjitje Rrugën e Mundimeve.

Kënaqësia e rrugës së re niste tej Bulqizës dhe e kishe vështirë të thoshje nëse kjo kënaqësi përzier me një ndjenjë lehtësimi buronte nga standardet e ndërtimit apo nga prania e një pejsazhi të butë në kulmin e gjallimit pranveror.

Në rrugën Peshkopi-Kukës kënaqësia fqinjëronte me magjinë. Dhe s’dije si ta shpjegoje pse kjo rrugë e vjetër por e mirëmbajtur, me vargan dredhash e kthesash, shijonte aq shumë.

Mbase prania e malit, me pllangat e borës dhe majat në re, të percillte ndjesinë e qiellit dhe ti ndjeheshe sadopak fluturak, si një tufë pëllumbash të egër që, të trembur nga zhurma e makinës u ngritën vërtik në fluturim dhe pasi bënë një gjysëm harku mbi rrugë vozitën drejt malit. Ikën sa hap e mbyll sytë, por ndriçimi tafta i krahëve dhe barkut të tyre na shoqëruan një copë herë si për të na thenë se e bukura bëhet edhe më ngashënjyese kur është e përkohëshme dhe tejet kalimtare.

Eleganca e lëkundjes së thekrës në një arëz mbi rrugë, ngashënjimi që përcillte një kalë i bardhë e i bukur teksa kulloste tej në krye të një livadhi të pjerrët, gurgullima e ujrave që dëgjohej herë pas here shoqëruar nga cicërima e zogjve - këto e të tjera të bënin t’i ikje vetes e të ndiheshe disi fëmijë, që në gjirin e natyrës shuan etjen e përjetshme të qytetarit për ndjesi të virgjëra e bazike.

Në Prizren të bënte pershtypje numri i madh i turistëve dhe mirësjellja në standarde europiane e punonjësve të shërbimit në hotel, kafe e restorant.

Me kalimin e orëve zhaurima e rrugëve u fashit dhe ia la vendin gurgullimës së lumit dhe këngës së bilbilit që ngjante sikur vinin nga lirikat e Naimit për të hijeshuar edhe më natën e Prizrenit, qytetit të traditës, historisë dhe mirësjelljes.

** Marrë nga profili në FB i autorit*

Rruga e Arbërit nr. 189

Sipas ERE-s, të 4 HEC-et e Hydro Seta Power, të ndërtuara mes përplasjeve dhe kundërshtive të forta me banorët, kanë prodhuar vetëm 47.785 KWH përgjatë vitit 2019-2020, ndërsa në kontratën koncesionare ishte parashikuar që të 4 HEC-et të kishin një kapacitet prodhimi 86 milionë KWh/vit. E thënë më qartë, të katërta HEC-et kanë prodhuar vetëm 0.05% të sasisë së energjisë që kishin parashikuar në kontratë.

Seta e thyer, dikur një mrekulli natyrore, sot një kaskadë hidrocentralesh

Nga JONA KASO

I ndërtuar mbi një monument natyror, HEC-i Seta 4 ka dështuar në prodhimin e energjisë. Krejt ndryshe nga shifrat e fryra në kontratën koncesionare, 4 HEC-et e ngritura mbi lumin Seta kanë arritur të prodhojnë vetëm 0.05% të energjisë së premtuar. Vetë kompania fajëson reshjet e pakta dhe përplasjet e ashpra me banorët, që nuk i kanë lejuar ta përdorin të gjithë ujin.

Dëshira për ta kthyer fshatin Çidhën në një zonë turistike, u zbeh pas ndërtimit të hidrocentralit Seta 4, në lumin me po të njëjtin emër, Seta.

Gryka e ngushtë e Setës me kanionin e saj, bashkë me burimin, si dhe shpellën e ujëvarën e Sopanikës, që bëjnë pjesë në listën e monumenteve të kulturës dhe mbrohen nga UNESCO, janë kthyer në një rrugë kalimi për HEC-et.

"Do të doja që në këtë zonë të ndërtoja një bujtinë, për të afruar sa më shumë turistë dhe për të promovuar vendin tonë, por tani, pas shkatërrimit të kësaj mrekullie që ka na falur Zoti, nuk mundemi të investojmë më", – shprehet për INA MEDIA-n Liman Kola, banor i fshatit Çidhën.

Në mënyrë absurde, kjo perlë, monument kulture, së bashku me 4 burimet e ujëvarave fantastike, është burgosur nga tubacionet që e marrin ujin direkt nga burimi dhe e çojnë në HEC.

Më konkretisht, HEC-i Seta 4 ka futur një tub prej 1.8 km të gjatë pikërisht në përroin e Sopanikës, duke e marrë ujin që nga burimi.

SETA 4 NUK PRODHON ENERGJI

Krejt ndryshe nga shifrat e majme që parashikonte në kontratën koncesionare, edhe dy vite pasi vuri për herë të parë turbinat në punë, Seta 4 pothuajse nuk ka prodhuar fare energji.

Më konkretisht, referuar kontratës koncesionare dhe përllogaritjeve të bëra në VNM-në paraprake, koncesionari deklaronte se vetëm HEC-i Seta 4 do të prodhonte një sasi prej 27.740.047 KWH, duke shfrytëzuar një volum prej 122.7 milionë m3 ujë. (VNM paraprake, faqe 39-40)

Por, raportimet e Entit Rregullator të Energjisë tregojnë se HEC-i Seta ka dështuar.

Nga monitorimet që Investigative Network Albania-s kreu në faqen zyrtare të ERE-s, rezulton se të 4 HEC-et e ndërtuara nga kompania Hydro Seta Power nuk kanë prodhuar as energjinë që duhet të prodhonte vetëm njëri prej tyre.

Sipas ERE-s, të 4 HEC-et e Hydro Seta Power, të ndërtuara mes përplasjeve dhe kundërshtive të forta me banorët, kanë prodhuar vetëm 47.785 KWH përgjatë vitit 2019-2020, ndërsa në kontratën koncesionare ishte parashikuar që të 4 HEC-et të kishin një kapacitet prodhimi 86 milionë KWh/vit. E thënë më qartë, të katërta HEC-et kanë prodhuar vetëm 0.05% të sasisë së energjisë që kishin parashikuar në kontratë.

Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, që e ka për detyrë monitorimin e zbatimit të kontratës, thotë se nuk është në gjendje të identifikojë se sa prej kW energji ka prodhuar Seta 4.

"Në lidhje me prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet Seta 1-2, 3, 4, si nga raportimet e shoqërisë koncesionare, ashtu edhe nga OSHEE sh.a., është për të gjithë kontratën (pra, për të katërta hidrocentralet së bashku) dhe jo për secilin hidrocentral më vete. Duke marrë shkas nga sa më sipër, nuk mund të identifikojmë prodhimin vetëm për hidrocentralin Seta 4", – i tha INA MEDIA-s një përgjigje me shkrim Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore.

Ndërsa shpjegon se kontrata me tri HEC-et e Hydro SETA Power ka hyrë në prodhim për herë të parë në muajin prill 2019, nuk ka ndodhur e njëjta gjë me Seta 4, i cili ka disa vepra të marrjes së ujit. Agjencia Kombëtare e Mjedisit thotë se vetëm në një vepër marrje janë ndaluar punimet, e kjo vepër ka qenë saktësisht në burimin e Sopanikës.

"Në momentin e monitorimit, HEC-et ishin të përfunduara nga ana ndërtimore, me përjashtim të njërës nga veprat e marrjes së HEC-it Seta 4, burimi i Sopanikës, ndërtimi i së cilës është bllokuar nga banorët dhe çështja është në gjykatë", – sqaron AKBN.

Vetë kompania pranon se nuk kanë prodhuar energji, aq sa ishte parashikuar në kontratë, por, sipas tyre, kjo jo për faj të tyre.

"Sa për prodhimin e energjisë mesatare, vjetore, arsyet kanë qenë dy: e para, kushtet e motit që kanë qenë shumë të disfavorshme, sepse të gjitha HEC-et kanë qenë me minus; e dyta, për shkak se banorët, që kanë bërë ankesën, nuk na kanë lejuar që ne ta zbatojmë projektin sipas vendimit të Këshillit të Ministrave dhe ne nuk kemi mundur që ta marrim të gjithë ujin që kemi pasur leje për ta shfrytëzuar", – thotë Pëllumb Beta, përfaqësues i kompanisë Hydro Seta Power.

Nga ana tjetër, sipas Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, rezulton se kompania Seta Hydro Power ka qenë korrekte në raportim gjatë fazës së ndërtimit, por jo gjatë fazës së prodhimit, që daton që prej muajit prill të vitit 2019.

Referuar raportit 6-mujor të HEC-it Seta 1, koncesionari parashikon që të investojë rreth 16 milionë euro për ndërtimin e këtyre 4 veprave, por nga të dhënat e prodhimit të energjisë duket që është shumë larg vjeljes së këtij investimi. (1.993.076.966 lekë – faqe 3/raporti 6-mujor/ HEC-i Seta 1)

Këtë hendek të madh mes parashikimeve në VNM dhe asaj që prodhon realisht ky HEC, eksperti hidrik, Abdulla Diku, e lidh me të dhënat shumë të vjetra, ku bazohen ekspertët që merren me hartimin e VNM-së.

Sipas tij, të dhënat paraqesin klimën e dekadave më parë, ndërkohë që aktualisht ka më pak reshje dëbore e për rrjedhojë më pak burime të qëndrueshme uji.

"Arsyeja, pse ky HEC nuk ka arritur të prodhojnë energjinë e përcaktuar në kontratë, është se abuzohet me të dhënat e reshjeve. Shpeshherë për të kënaqur zhvilluesit e HEC-eve, shifrat fryhen në mënyrë artificiale, duke mos dhënë realitetin. Kjo bën që projekti të jetë shumë larg realitetit", – shpjegon eksperti Abdulla Diku.

Sipas tij, nga ana tjetër janë shtuar ngjarjet ekstreme të motit (p.sh., reshjet intensive), duke bërë që sasia e ujit të mos shfrytëzohet maksimalisht. Veçanërisht HEC-et pa rezervuare uji e vuajnë këtë fenomen, sepse nuk kanë kapacitete të ruajtjes së ujit.

"Ka mjaft studime që HEC-et e vogla i vlerësojnë si jo-efektive në drejtim të përfitimit financiar. Pra, pavarësisht investimit, përfitimi prej tyre është gjithnjë në nivelin minimal", – thotë për Investigative Network Albania-n eksperti, Abdulla Diku.

Të tjerë ekspertë mendojnë se mungesa e prodhimit të energjisë së premtuar duhet të jetë për një periudhë të gjatë kohe që të konsiderohet. Sipas tyre, fillimisht duhet kuptuar nga se vjen, vjen nga keq-kalkulimet e bëra në projektimin e HEC-it apo nga mosrealizimi i plotë i investimeve.

"Në të dyja rastet mungesa e prodhimit është diçka, për të cilën dikush duhet të japë llogari, pasi shteti ka sakrifikuar mjedisin, ka shkatërruar një ekosistem biologjik, për ta mundësuar atë energji dhe, kur energjia mungon, dikush duhet të japë llogari, përse po ndodh", – argumenton për Investigative Network Albania-n eksperti i ekonomisë, Pano Soko.



Pamje nga kanioni i Setës.

Foto: Vladimir Marku

Në vitin 2013 u mor leja e parë e ndërtimit për një HEC-i pranë lumit Seta, pjesë e Njësisë Administrative Arrëz në fshatin Çidhën. Në vitin 2015 u bë rilidhje kontrate me kompaninë Hydro Seta Power sh.p.k., për të vazhduar punimet për ndërtimin e këtij HEC-i.

Në Shqipëri numërohen 179 hidrocentrale, të cilat janë në prodhim energjie, ndërsa numri i projekteve të planifikuara është 410, aktualisht në ndërtim janë 24 të tilla. (të dhënat janë marrë nga studimi "Projekte hidroenergjitike në lumenjtë ballkanikë" për vitin 2020.)

QIRA QESHARAKE, 7 MIJË LEKË PËR 2 HEKTARË

Kontrata e qirasë, që ka lidhur Hydro Seta Power me komunën Arrëz për sipërfaqen e marrë në shfrytëzim, është krejt qesharake. Referuar kësaj kontrate, që Investigative Network Albania e disponon, vitin e parë vlera e qirasë do të jetë 687.950 mijë lekë për 2 ha tokë, shumë në të cilën llogariten edhe dëmtimet që i shkaktohen florës dhe faunës, ndërsa për çdo vit tjetër kjo kompani do të paguajë një qira prej vetëm 91.450 lekësh në vit, një shumë qesharake kjo për një sipërfaqe të tillë.

E thënë ndryshe, kjo kompani paguan një qira mujore prej 7.620 lekësh të reja ose 76 mijë lekë të vjetra për 2 hektarë tokë, sipërfaqe e cila u lëshua me qira pas vendimit të lidhjes së kontratës.

E kontaktuar nga INA MEDIA për kontratën e shfrytëzimit të dy hektarëve tokë me komunën Arrëz vetë kompania u shpreh se nuk paguante vetëm këtë kontratë, pasi kishte edhe një tjetër kontratë me komunën Lurë.

"Paguajmë 12 milionë lekë qira për tokën, pasi kemi dy kontrata, një në komunën Arrëz dhe një në komunën Lurë dhe të dyja bashkë shkojnë 12 milionë lekë. Kontrata me Arrëzën mund të ketë qenë më pak, sepse ne nuk kemi bërë asnjë dëm atje", – tha për Investigative Network Albania-n Pëllumb Beta, përfaqësuesi i kompanisë Hydro Seta Power.

Ndryshe nga kontrata e qirasë me komunën Arrëz, që AKM e dispononte si dokument, kontrata me Lurën nuk gjendet në dosjen koncesionare. Sipas AKM-së, bazuar në Ligjin Nr. 10440, datë 07.07.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", i ndryshuar, ky dokument (pra, kjo kontratë qiraje) nuk është pjesë e dokumentacionit që duhet gjatë fazës së VNM-së, pasi është një marrëdhënie midis shoqërisë dhe njësisë përkatëse, vendore.

Nga dokumentet e siguruara rezulton se shoqëria Hydro Seta Power Sh.p.k., ka lidhur kontratë me Njësinë Administrative, Lurë në vitin 2015. Referuar kësaj kontrate, shoqëria koncesionare Hydro Seta Power Sh.p.k., shfrytëzon 4.4856 ha tokë, me një qira vjetore prej 2.555.228 lekësh për vitin e parë, ndërsa për vitet në vazhdim shoqëria paguan një qira vjetore prej 1.180.195 lekësh të reja.

Në total kjo kompani paguan një qira vjetore prej 1.2 milionë lekësh të reja për një sipërfaqe prej 6.5 hektarësh, të marrë me qira në Lurë dhe në Setë.

DËGJESA PA BANORË

Kompania zhvilloi dëgjesat publike në një prej lokaleve të fshatit për të dytën herëshumë prej banorëve e kanë kundërshtuar sërish këtë projekt, me pretendimin se ndërtimi i tij do të shkatërrojë një monument të mbrojtur natyror, si dhe do të ndikojë direkt në jetën e tyre. Konsultimi me banorët duket se është bërë vetëm në letrat e kompanisë, pasi, sipas banorëve, ata nuk kanë nënshkruar kurrë për ndërtimin e këtij HEC-i, gjithashtu ata shprehen se disa prej firmave të banorëve mund të jenë falsifikuar.

"Ne e kundërshtojmë ndërtimin e HEC-it Seta 4, që po ndërtohet në zonën e mbrojtur, në territorin e dy monumenteve të mbrojtura të natyrës, si dhe dy kalave, njëra prej tyre ilire, 3300-vjeçare, tjetra e Kastriotëve, të dyja në luginën strategjike të Setës, vetëm 5 km larg njëra-tjetrës. Në atë luginë ndodhen edhe dhjetëra gjeo-monumente dhe shpella të banuara, si dhe një territor arkeologjik, shumë i rrallë ndër territoret shqiptare, ndoshta i vetmi i shekullit 3-7 pas Krishtit, kur shkëputet vazhdimësia ilire", – thotë banori Mustafa Tola.

SETA, BANORËT, 7 VITE "BETEJË" NË GJYKATË

Të vendosur për të mos lejuar ndërtimin e këtij HEC-i, banorët e zonës enden dyerve të gjykatës që prej vitit 2015, duke kërkuar anulimin e këtij koncesioni.

"Që në vitin 2015, kur kompania erdhi të

aktualitet

bënte dëgjesat me publikun dhe prezantoi projektin, ne kemi nisur përpjekjet për ta kundërshtuar ndërtimin e këtij HEC-i. Nuk mund të lejonim që të shkatërrohej një mrekulli natyrore, siç është Seta. Ngritëm peticione me 350 firma të banorëve të territorit dhe i dërguam në institucionet përkatëse, në Kryeministri, në Ministrinë e Mjedisit, në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, por nuk morëm përgjigje", – shprehet Tola për Investigative Network Albania-n.

Mes kundërshtive të forta të banorëve dhe proceseve gjyqësore, ndërtimi i HEC-it Seta 4 shkoi përpara dhe sot, jo vetëm është ndërtuar, por është futur edhe në punë, duke prodhuar energji.

"Kemi organizuar protesta, që qeveria dhe institucionet e tjera përkatëse të mos e lejonin miratimin e këtij projekti. U bë e kundërta nga ajo që kërkonim ne, madje policia ka proceduar penalisht 25 banorë protestues, vetëm se ishim kundër ndërtimit të këtij HEC-i", – thotë Qazim Daci, një tjetër banor.

Banorët e kanë çuar çështjen në Gjykatën Administrative që në vitin 2015, por pas zvarritjeve të paarsyeshme, me vetëm një seancë në një vit e gjysmë, aktualisht çështja ndodhet në Gjykatën e Shkallës së Dytë, por deri tani nuk është bërë asgjë për t'u gjykuar.

"Kemi bërë 25 seanca. Një seancë gjyqësore na ka shkuar 18 muaj. Një vit e gjysmë, një seancë! Gjykata e Shkallës së Parë e ka rrëzuar padinë, me pretekstin që ne nuk kishim të drejtë të bënim padi, sepse nuk na janë prekur interesat drejtpërdrejt", – shprehet Mustafa Tola

Pas një kalvari të gjatë prej 25 seancash gjyqësore, banorët nuk kanë aspak ndërmend të heqin dorë, përkundrazi.

"Në shkallë të dytë e kemi çuar në vitin 2019 dhe deri tani nuk ka asnjë tentativë për ta gjykuar, asnjë gjykatës nuk e merr përsipër për ta gjykuar. Që kur e kemi nisur, ne e kemi pasur të qartë, do t` i kalojmë të gjitha shkallët, madje do ta çojmë edhe në Strasburg", – thotë Qazim Daci.

"Unë kam qenë prezent në 13 seanca gjyqësore në Gjykatën Administrative. Pavarësisht vendimit, ne do ta vazhdojmë edhe më tej. Do ta çojmë deri në Strasburg çështjen, nuk heqim dorë nga e drejta jonë, e cila na është shkelur", – këmbëngul Liman Kola, banor i fshatit Çidhën

Pas një beteje 7-vjeçare për të kundërshtuar ndërtimin e HEC-it në Setë, banorët ende kanë një proces të hapur, gjyqësor me kompaninë koncesionare Hydro Seta Power.

Avokati i banorëve, Përparim Noka, thotë se kontrata e koncesionit është lidhur jashtë çdo respektimi ligjor, duke nisur që me lejen e kontratës koncesionare, cenimin e një zone të mbrojtur natyrore, ndryshimin e vendndodhjes së shtratit të lumit dhe përroit të Setës.

"Nuk mund të jepej një leje mjedisore për atë vend, i cili është shpallur me ligj Monument Natyror. Është shkelur ligji për menaxhimin e burimeve natyrore, si dhe ai për mbrojtjen e mjedisit", – sqaron avokati Noka

Shkelja fillon që me VNM, e cila për këtë HEC duhet të ishte një VNM e thelluar, ndërsa e ka marrë lejen vetëm me VNM paraprake.

Agjencia Kombëtare e Mjedisit nuk e konsideron një zonë me rëndësi këtë monument kulture dhe shprehet se "projekti nuk ka nevojë për procedurë të thelluar të VNM-së, pasi kjo vlen për projekte me impakte potencialisht të konsiderueshme në mjedis".

DËMET E PARIKUPERUESHME NË NATYRË

Banorët e kësaj zone të strukur mes maleve kanë nisur të ndjejnë efektet e HEC-eve. Tokat kanë ngelur djerrë për shkak të ujit, ndërsa edhe ajo pak infrastrukturë ka dalë jashtë funksionit, për shkak të kamionëve të rëndë që punuan për ndërtimin e HEC-eve.

"Tokat na i kanë shkatërruar, rrugët na i kanë shkatërruar, ujin na e morën. Këtu te ne shkojnë temperaturat deri në 37 gradë, si në Tiranë, kjo për shkak të tharjes së ujit", – shprehet banori Qazim Daci.

Sipas ekspertëve, ndërtimi i HEC-eve ka sjellë shkatërrim, jo vetëm të natyrës, por edhe të gjallesave që jetojnë në këtë lumë. Më e rëndësishme për banorët e zonës është se, si pasojë e marrjes së ujit dhe futjes se tij në tuba rrezikon të zhduket edhe trofta, i vetmi lloj peshku që rritet në lumin e Setës.

"Ndikimet e pritshme në ekosistem kanë të bëjnë me një efekt domino, negativ që nis me ndryshimin drastik (deri në tharje) të regjimit ujor në lumë e që lidhet me ndërprerjen e lidhjes gjatësore ekologjike të sistemeve lumore. Kjo ndërprerje në vetvete përkthehet në ndërprerje të rrugëve të migrimit të peshqve, sidomos të troftës. Një çekuilibrim i tillë, jo vetëm që kërcënon seriozisht gjallesat ujore, siç është trofta, por sjell edhe dëmtimin e vetë zinxhirit ushqimor, pasi shumë lloje të tjera mbështeten te peshqit, si p.sh., lundërza", – thotë për Investigative Network Albania-n eksperti i mjedisit, Olsi Nika.

Si pasojë e tharjes së lumit, trofta e egër me pika të kuqe tashmë rrezikon të zhduket. Kjo gjë ka ndikuar shumë në ekonominë e banorëve, pasi nuk mund të vazhdojë dot si më parë veprimtaria e peshkimit.

Vetë shoqëria koncesionare Hydro Seta Power nuk pranon që ta ketë dëmtuar mjedisin dhe shpjegon se për këtë kanë marrë aprovimin e të gjitha instancave publike.

"Kjo nuk është e vërtetë, pasi ne kemi pasur edhe një kontroll nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, janë bërë të gjitha verifikimet", – tha për Investigative Network Albania-n Pëllumb Beta, përfaqësuesi i shoqërisë koncesionare, Hydro Seta Power.

Sa iu përket proceseve gjyqësore, ai shprehet se nuk i kupton arsyet e pretendimeve të banorëve, pasi kompania nuk e ka dëmtuar mjedisin.

"Çfarë detyrimesh kemi pasur për mjedisin, janë plotësuar. Nuk kemi prishur gjë në mjedis, madje kemi instaluar një tub brenda shtratit të lumit, pra nuk kemi prerë pemë, nuk kemi prishur toka, por nuk e dimë se sa do të vazhdojmë akoma të jemi në procese gjyqësore", – thotë Beta për INA MEDIA-n.

HEC-i Seta 4 ka disa vepra të marrjes së ujit, por banorët nuk kanë lejuar që të futet në tubacione njëri prej këtyre burimeve, që është pikërisht Sopanika.

Për banorët ai është një monument natyre dhe nuk duhej të shkatërrohej, për këtë shkak kanë bërë edhe protesta, duke e çuar deri në gjykatë si çështje.

Ndonëse pjesa më e madhe e veprave kanë përfunduar dhe janë futur në prodhim, banorët ende shpresojnë që kjo zonë të presë mijëra turistë, duke ringjallur të gjitha ekonomitë e vogla të zonës. Pavarësisht kësaj situate, ata shprehen të vendosur që të përballen me kompaninë koncesionare, Hydro Seta Power, që lumi Seta të mos shfrytëzohet nga ndërtimi e 4 HEC-eve.

"Të vetmen gjë që duam tani, është që të na kthehet vendi, siç ka qenë. Kompania e ka në karta, e ka me shkresa ligjore, duam të na mbjellë pemët, ta kthejë, siç ishte, vendin, pasi e ka shkatërruar komplet dhe s`ka bërë asgjë", – përfundon Miftar Cerri, një tjetër banor i zonës.

(Marrë nga INA - Investigative Network Albania: https://ina.media/?p=5886)

KOMENT

Dibra, "jastëku" i lagur i Ramës

Kompania zhvilloi dëgjesat publike në një prej lokaleve të fshatit për të dytën herëshumë prej banorëve e kanë kundërshtuar sërish këtë projekt, me pretendimin se ndërtimi i tij do të shkatërrojë një monument të mbrojtur natyror, si dhe do të ndikojë direkt në jetën e tyre. Konsultimi me banorët duket se është bërë vetëm në letrat e kompanisë, pasi, sipas banorëve, ata nuk kanë nënshkruar kurrë për ndërtimin e këtij HEC-i, gjithashtu ata shprehen se disa prej firmave të banorëve mund të jenë falsifikuar.

Nga **MAJLINDA HOXHA**

Teksa lexoja një shkrim më të fundit për shkeljet ligjore të privatizimit të disa heceve të rëndësishme në Shqipëri, më ra ndërmend vegjetimi i dibranëve në gjithë këta muaj, qëkur është promovuar me të madhe ndërtimi i Skavicës.

Dhe vendosa të ridëgjoja disa nga fjalimet e kryministrit tonë me vegjetuesit atje, përgjatë një viti.

Nuk di se si ia dola t'i dëgjoja të gjitha pa vjellur, nga gjithë ato grahma çjerrëse, tallëse. Dhe nuk ishte nevoja të ndodheshe afër për ta ndjerë atë kundërmim lëtyrës.

Më duhet të shprehem kështu, pasi diferenca e prijësit me tipare diktatoriale përballë turmës së nënshtruar, ishte tepër e dukshme. Si për ironi edhe me maskën e logos "Voto 12PS".

Por në një vend që aspiron BE-në dhe është pjesë e organizatave më të rëndësishme botërore, ishte një kontrast shumë i madh.

Po flas për atë takimin në stadiumin e Peshkopisë gjatë fushatës elektorale dhe le të analizojmë ca nga premtimet e thëna aty.

Gjatë gjithë atij fjalimit të gjatë paraqiste me britma se do jenë 1 miliardë euro të investuara në bujqësi për 2021-2025. Do ketë 150 pika grumbullimi, 6000 hektarë serra, dhe 0 taksë për 5 vitet e ardhshme për agro-turizmin. Sepse shqipëria tashmë eksporton 3 dhe importon 1 pasi punon dyfishin e tokës së para 6-7 viteve.

Por Dibra nuk do përfitojë asgjë nga këto sepse Skavica nuk do lërë asnjë tokë bujqësore të punueshme, si rrjedhojë nuk do ketë asgjë për ato pikat grumbulluese dhe nuk do ju duhet asnjë taksë zero sepse nuk kanë çfarë pordhojnë e përpunojnë. Do jenë vetëm konsumator që do blejnë për të mbijetuar.

Për më tej vijonte më delirin e madhështisë duke premtuar se do jepte nga 5 milionë lekë të vjetra për çdo emigrant që vendos të vijë dhe të investojë për shtëpinë e babës dhe të gjyshit, sepse do kemi 1000 bujtina dhe 500 agroturizme.

Edhe në këtë rast Dibra nuk do përfitojë. Sepse nuk do ketë më shtëpi të babës apo gjyshit pa fundosur nën ujë, dhe as varre babe, gjyshi nuk do gjeni më: as ju emigrantë dhe as ju që jeni aty e strukeni e nuk flisni sot, për t'ia hedhur surratit të gjitha fjalet boshe të së djeshmes.

Dhe as ju që do ngeleni në ato shpata malesh me një mjegullmbledhes perballë që edhe lajthite nuk do ju piqen më, le frutat e perimet e tjera; as për ju s'ka bujtinë e agroturizëm.

Egjithë madhështia e treguar aty lidhej me Rrugën e Arbrit, se siç shprehej ngazëllueshëm: "-E cila nuk është thjeshtë një rrugë, por një rrugë që do hapte një hapësirë të pafund zhvillimi ekonomik; zhvillimi ekonomik familjar dhe komunitar. Rrugë e cila do u shërbejë edhe turistëve nga porti i Durrësit".

Të themi të vertetën, Rruga e Arbrit është gjëja më me mend që ka berë qeveria edhe pse e ka ndërtuar pa mend, duke parë sot rezultatin dhe sa po kushton.

Por me ndërtimin e Skavicës shohim se kjo rrugë nuk do ketë asnjë nga këto benefite që thuhen, sepse Dibra do vdesë me përmbytjen e saj, gjë që nuk do sjellë asnjë zhvillim turistik në të ardhmen. Kështu i bie që kjo rrugë u bë vetëm në shërbim të projektit të Skavicës dhe parisë, jo të dibranëve.

Nuk di se si e kanë emërtuar këtë takim elektoral, por aty si duket iu përshfaq mesias së ardhmërisë sonë, shprehja e bukur

> Nuk do ketë më shtëpi të babës apo gjyshit pa fundosur nën ujë, dhe as varre babe, gjyshi nuk do gjeni më: as ju emigrantë dhe as ju që jeni aty e strukeni e nuk flisni sot, për t'ia hedhur surratit të gjitha fjalët boshe të së djeshmes. Dhe as ju që do ngeleni në ato shpata malesh me një mjegullmbledhës përballë që edhe lajthite nuk do ju piqen më, le frutat e perimet e tjera; as për ju s'ka bujtinë e agroturizëm.

"Dibra, jastëku i gjelbër i Tiranës". Si duket, kjo duhet të jetë edhe gjetja elektorale meqë vazhdon të përdoret edhe sot në çdo takim në Dibër.

Dhe për 't'i vënë vulën" në fund zotëria në fjalë paska folur edhe për Skavicën, duke e ringritur tonin e tij acarues se çdo dibran do marrë një shtëpi më të mirë se sa e ka tani. Ndërsa për tokën do marrë ashtu siç e meriton dhe kështu do u hapët të gjithëve perspektiva e jetës.

Kjo "meriton" duhet të kishte merituar më shumë vëmendje.

Jo vetëm për faktin që mikrofoni kishte vetëm një pronar, por askujt nuk i është kujtuar të pyesë se:"-Për tokën që kemi trashëguar dhe punojmë, apo për atë që është me dokumenta?"

Sepse shumica më e madhe e dibranëve nuk kanë dokumente pronësie për tokën. Per t'mos harruar që pyjet dhe kodrat nuk quhen pronë private.

Ndërkohë që premtohej dhe deklarohej aty se çdo shqetësim i juaji është i imi, dhe çdo zë i juaji do dëgjohet, ku do ketë dëgjesa publike, konsultime, studime fizibiliteti, në po të njëjtën kohë deklarohej se punimet e Skavicës do nisin sa më shpejt të jetë e mundur.

Mjafton ky fakt për të treguar hipokrizinë e qeverisë aktuale dhe gënjeshtrën e madhe se po presin përfudimin e studimit për të nisur punimet. Aq më pak të pyeteni ju, të pyetemi ne, apo të maten ndikimet sociale, mjedisore sipas standarteve.

Ky fakt është vërtetuar edhe me mënyrën se si kanë rrjedhur ngjarjet më vonë.

Në çdo dalje të kryeministit, ministres apo përfaqësuesve të KESH, kemi dëgjuar vetëm një fjali "Ndërtimi i Skavicës do sjellë këtë apo atë përftimin, të mirë, zhvillim". Në asnjë dalje nuk është thënë që po shohim mundësinë e ndërtimit të kësaj vepre, nëse studimi dhe të dhënat dalin positive.

Tashmë që shohim tunele dhe rrugë që hapen dhe zgjerohen çdo ditë, nuk kemi asnjë dyshim për këto deklarata dhe që punimet kanë nisur pa përfunduar studimi.

J'ua solla këto fakte për t'ju bërë me dije edhe njëherë e shumëherë, se propaganda për digën e Skavicës dhe benefitet e saj, janë të rrejshme; ashtu siç janë të gjitha ato premtime elektorale. Ashtu siç duket të jetë çdo investim i ashtuquajtur strategjik gjatë kësaj dekade.

Për ju dibranët e mi që keni vegjetuar ato ditë, çdo ditë dhe po vazhdoni të vegjetoni edhe sot, duhet të dini se Skavica do jetë një rezervuar i madh, dhe "peshqit" e vetëm që do lundrojnë aty, DO JENI VETË JU, populli dibran.

Popull, që do flerë në jastëkun e lagur në pellgun e Skavicës, se jastëku i gjelbër është vetëm në imagjinatën e kryeministrit.

Rruga e Arbërit nr. 189

OPINION



Lëreni Drinin të rrjedhë në shtratin e tij...

Nga AGIM CANI

Sipas mediave të shkruara e vizive, sipas portaleve rrjeteve sociale, por edhe sipas ligjëruesve në protestat "Po Dibrës, Jo Skavicës", studiues e intelektualë dibranë mësohet se ka filluar puna në Skavicë.

Mungesa totale e informacionit qeveritar, mungesa e dërgesave publike me banorët e zonës grupet e interesit e shoqërinë civile që preken nga përmbytja, u mbajtën disa protesta që nga Skavica e deri në Tiranë. Një protestë e ligjshme në mbrojtje të vlerave shpirtërore e kombëtare të kësaj treve të njohur në 35 fshatrat që mund të përmbytje. Çdo ditë historianë, arkeologë, intelektualë nga të gjitha fushat po e ngrenë zërin, po i bashkohen kauzës së madhe "Të mbrojmë Dibrën, Jo Skavicës!".

Ka ardhur koha kur duhen përshkallëzuar protestat, duhet sensibilizuar opinioni publik në mbrojtje të Dibrës, në mbrojtje të pasurisë shpirtërore e kombëtare. Koha thërret për një Kuvend Kombëtar të Madh në mbrojtje të Dibrës.

Hec-i i Skavicës me vlerë tenderi ndërkombtarë 510 MLN €, sado produktiv që mundet të jetë, nuk i mbulon humbjet e mëdha që vijnë si pasojë e këtyre punimeve.

Janë 35 fshatra që i kap përmbytja, fshatra me histori e tradita, me vlera shpirtërore e kombëtare të padiskutueshme.

Në Luginën e bukur të Drinit Zi do mbulojë uji muret ilire, qyteti i famshëm ilir jenë aq që historianët e arkeologët e legalizojnë në Listën e Poshtme, së bashku me 12 qytete tjera ilire do i përmbys Hec. Skavicës duke e dërguar në harresë totale kulturën qytetare ilire. Në Zall-Dardhë nuk do këtë më "Mej e qytetit", me gjetje të rëndësishme arkeologjike.

Në Luginën e Drinit përmbytjet vendlindja e Skënderbeut, muzeu Gjergj Kastrioti Skënderbeu në Sinjë, përmbyten 18 fushëbetejat fitimtare të ushtrisë së heroit tonë kombëtar Skënderbeu. Këto 18 betejat janë zhvilluar në këto troje të Luginës Drinit nga 26 betejat që ka zhvilluar Skënderbeu.

Përmbytet Lugina nga Kukësi deri në kufi me Maqedoninë e Veriut në një hapësirë mbi 75 km. Përmbushen 12.500 ha tok, nga këto 8.000 tokë shumë produktive, që do të thotë gati 40.000 kv grurë më pak, 80.000 kv misër më pak, 9.000 krerë kjo e 25.000 krerë imta më pak do prodhojë Dibra për popullsinë e saj. Dibra e veçanërisht Lugina në dy anët e Drinit njihen për frutikulturë, e pas Hec Skavicës do kemi 50.000 dru frutore më pak.

Ka ardhur koha kur duhen përshkallëzuar protestat, duhet sensibilizuar opinioni publik në mbrojtje të Dibrës, në mbrojtje të pasurisë shpirtërore e kombëtare. Koha thërret për një Kuvend Kombëtar të Madh në mbrojtje të Dibrës.

"Ta mbrojmë Dibrën siç mbrojtëm Radikën"

Ministri për diasporën në Maqedoninë e Veriut, Xhemail Çupi, takim me Shoqatën Bashkësia Dibrane, pjesë e komunitetit dibran tradicional të Tiranës

Nga Halil RAMA



Në takimin që Ministri për Diasporën në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Xhemail Çupi, zhvilloi të hënën më 30 maj 2022, me Shoqatën Bashkësia Dibrane, pjesë e komunitetit dibran tradicional të Tiranës, veç të tjerash u ngrit shqetësimi për dëmin e madh që i sjell Dibrës realizimi i projektit të Skavicës.

Prof. dr.Adem Bunguri, një ndër arkeologët më në zë të vendit, argumentoi bindshëm se Skavica përbën një kërcënim real për banorët e pellgut të Drinit, duke përmbytur thuajse gjithë luginën (ose "Myzeqenë e Dibrës" siç krahasohet kjo luginë për nga pjelloria e saj), nga Reçi, Zall-Dardha, Fushë Alie, Muhurri, Katundi i Ri e deri në Gjoricë.

"Për pasojat e rënda që do të ketë për Dibrën, ndërtimi i HC të Skavicës, ky problem nuk mund dhe nuk duhet të kalohet në heshtje. Për hir të së vërtetës, një projekt për ndërtimin e një HC mbi Skavicë, ka qenë hartuar edhe në kohën e komunizmit, përkatësisht në vitet 1983-1984. Sipas ekspertëve të hidrologjisë së asaj periudhe, qeveria Çarçani u tërhoq nga ndërtimi i këtij HC, përballë kostës së madhe të humbjes së tokave më të mira dhe më pjellore të këtij rajoni. Se Dibra është konsideruar gjithnjë si Myzeqeja e Shqipërisë Lindore!

Kjo çështje qe rihapur në shkurt 2010 nga qeveria Berisha, dhe shihej në atë kohë si zgjidhje e problemit të përmbytjeve në zonën Shkodër-Lezhë, edhe pse më vonë u gjetën zgjidhje të tjera shumë më racionale. Banorët e Dibrës e kundërshtuan këtë projekt, kundërshti që e kanë shprehur prej kohësh në shtypin periodik disa nga përfaqësuesit e spikatur të publicistikës dibrane si A. Hoxha, A. Ashiku, V. Hoxha, B. Karoshi, M. Koltraka, Sh. Skara etj. Për fat të mirë, qeveria demokratike e asaj periudhe u tërhoq nga kjo ndërmarrje me pasoja të padëshirueshme për Dibrën", theksoi prof. Bunguri.

Ky reagim i një prej zërave më elitarë të Dibrës në metropolin shqiptar vjen pasi Koorporata Elektroenergjitike Shqiptare (KESH) nënshkroi në muajin korrik të vitit të kaluar kontratën me kompaninë amerikane "Bechtel" për të filluar punimet e para për ndërtimin e hidrocentralit të Skavica në lumen Drin, me kapacitet 210 megavat.

Kjo marrëveshje dhe insisitimi qeveritar për t'i shkuar deri në fund asgjësimit të luginës së Drinit, ka shkaktuar reagimin e ashpër të shoqatave dibrane në Dibër dhe në Tiranë e diasporë. Gjithsesi, ministri shqiptar për diasporën në Qeverinë e RMV, duke konfirmuar mbështetjen ndaj reaguesve kundër këtij projekti, i konsideron jo në nivelin e duhur protestat e zhvilluara deri kohët e fundit. Sipas tij është koha që të reagohet me forcë, ashtu siç reaguan dibranët e dy Dibrave para tetë viteve kundër projektit të qeverisë së atëhershme maqedonase për devijimin e lumit Radika.

Para tetë vitesh, ashtu si edhe pjesa më elitare e shoqërisë shqiptare, Z.Çupi tha se iu bashkua protestës së banorëve të dy Dibrave dhe të shoqatave mjedisore kundër devijimit të Radikës në lumin Vardar. Madje edhe për këtë fakt ai u ndje u ngazëllyer kur Sekretari i Shoqatës "Bashkësia Dibrane", Dr.Saimir Shatku i dhuroi veprën e tij "Dibra e Madhe dhe Radika", me bashkautorët: Tofik Jegeni e Molnar Kolaneci.

Mirënjohje shprehu Z.Çupi edhe për librat "Burri i odës dibrane", "Historia e Dibrës dhe "Magjia e fjalës" që i dhuruan autorët dibranë Prof.Dr.Bujar Kapexhiu, Prof.dr.Bajram Xhafa dhe Halil Rama.

Në këtë takim ministri shqiptar për diasporën në Qeverinë e RMV, Z.Çupi prezantoi disa projekte të qeverisë së tij, në ndihmë të komunitetit dibran të Tiranës, lidhur me trashëgiminë kulturore, historinë, botimet, promovimin e librave me karakter historik, kulturor etj, vëmendja u spostua tek domosdoshmëria e një reagimi më të ashpër kundër projektit për ndërtimin e HC të Skavicës që i sjell dëme të konsiderueshme Dibrës.

Nëse gjatë gjithë vitit 2014, personalitete të elitës intelektuale shqiptare, iniciuan dhe drejtuan protesta masive në Tiranë, në Dibër të Madhe, por edhe në Peshkopi, për të mos pranuar projektin e qeverisë maqedonase për të ndryshuar rrjedhën e lumit Radika, pasi kjo ndërhyrje do të ishte me pasoja katastrofike për ekosistemin dhe burimet ujore të zonës, në këtë takim u evidentua domosdoshmëria që po me atë forcë e shpirt proteste të veprohet edhe për mbrojtjen e Dibrës.

Nëse i referohemi studimit të Dr. Adriatik Balla, gjeograf, studiues dhe gazetar i njohur, lartësia e madhe e digës së HC të Skavicës prej më shumë se 400 metrash mbi nivelin e detit, përveç përmbytjes së 35 fshatrave do të izolojë po ashtu mbi 100 fshatra të tjerë të Dibrës. Kjo digë do të ndajë luginën e Drinit të Zi në dy pjesë; në lindje dhe në perëndim, duke vështirësuar lidhjen mes tyre. "Ose do të bësh shumë ura, një investim katastrofik, shumë i madh ose do të ndërtosh tragete të vegjël, pra humbje kohe, shpenzime, ndërtime në infrastrukturë, krijohet ajo që quhet denatyralizim i Drinit të Zi", – thotë Balla.

Ai shpjegon se ky projekt do të ndryshojë strukturën e përdorimit të tokës, duke nxjerrë jashtë loje me qindra hektarë pyje shumë të vlefshëm. Pikërisht, për këto dëme kolosale, banorët e Dibrës dhe disa përfaqësues të Shoqatës për mbrojtjen e Luginës së Drinit të Zi, kanë protestuar në vijimësi kundër projektit të qeverisë për ndërtimin e Hidrocentralit të Skavicës. Ata gjithashtu, kanë kërkuar dhe kërkojnë transparencë për këtë, ndërsa nuk pranojnë ndërtimin e basenit, që sipas tyre përmbyt gjithë fushën e Dibrës.

Asgjësimi përfundimtar i pjesës më pjellore të tokës së Dibrës, do t'i hiqte asaj bazën e nevojshme ekonomike që e ka mbajtur popullsinë dibrane aty prej më shumë se 8000 vjetësh. Fusha e Dibrës historikisht ka qenë hambar për Malet e Dibrës, dhe të dy këto njësi të saj kanë qenë përherë në marrëdhënie të ngushta ekonomike njëra me tjetrën.

Në këtë takim, kreu i Shoqatës "Bashkësia Dibrane", Bujar Kapexhiu dhe Sekretari i Përgjithshëm Saimir Shatku, pasi prezantuan arritjet mbresëlënëse të komunitetit dibran përgjatë një shekulli shprehën angazhimin për realizimin e disa projekteve në dobi të këtij komuniteti si dhe mbështetjen për protestat kundër projektit të HC të Skavicës.

Për këtë takim, vetë ministri Çupi do të shkruante në faqen e tij në facebook se i përmbylli takimet në Tiranë me vizitën më domethënëse për të si dibran, pikërisht me shoqatën "Bashkësia Dibrane" me seli në Tiranë, një nga komunitetet më të vjetra dibrane që jetojnë në Tiranë, por që pa dëshirë kanë migruar nga Dibra gjatë viteve 1912-1913 si rezultat i dhunës së atëhershme serbe. Sot ky komunitet ka një numër të madh intelektualësh, profesorësh, shkencëtarësh, punëtorësh kulturorë, shkrimtarësh etj. që tashmë si brez i gjashtë i integruar, vazhdojnë traditën dhe kulturën dibrane në Tiranë.

"Në takim, duke qenë se edhe ato llogariten pjesë e jona, i informova për mundësitë e pjesëmarrjes së tyre në projekte të ndryshme kulturore, botuese dhe aktivitete të tjera për të ushqyer traditën dhe kulturën dibrane në Tiranë dhe më gjerë", -shkruan ministri Çupi. Ndërkohë ai bën të ditur se ka ftuar kryesinë e Shoqatës "Bashkësia Dibrane" të vizitojnë RVM-në për të vendosur bashkëpunim me institucionet shtetërore në Republikën e Maqedonisë së Veriut.



Bashkoju peticionit të krijuar nga shqiptarët në SHBA. Kliko në lidhjen më poshtë dhe firmos peticionin online në **www.change.org**
tinyurl.com/mrykme42

aktualitet

NISIN PROTESTAT, kërkohet ndalimi i punimeve në Skavicë



Ndërsa në Skavicë vazhdojnë punimet për studimet inxhinierike dhe të projektimit, të banorët e Dibrës është rritur frika se qeveria po vendos për Skavicën pa i marrë parasysh mendimin dhe interesat e tyre.

Rreth 40 banorë dhe aktivistë të shoqatës për Mbrojtjen e Pellgut të Drinit të Zi udhëtuan më 16 maj 2022 në Skavicë për të parë ecurinë e punimeve.

Banorët vunë re se po hapen rrugët që të çojnë në kantier dhe këto punime, sipas banorëve, nuk kanë lidhje me studimin e fizibilitetit, por është një punë në terren që ka nisur për ndërtimin e hidrocentralit.

"Nga qeveria shqiptarë na është thënë se jemi në fazën e studimit të fizibilitetit, por këtu puna vazhdon në mënyrë intensive, janë hapur rrugët për të shkuar të gryka e tunelit për të devijuar Drinin" - i tha Nazmi Drizi, kryetari i Shoqatës për Mbrojtjen e Pellgut të Drinit të Zi, një media lokale.

> "Nga qeveria shqiptarë na është thënë se jemi në fazën e studimit të fizibilitetit, por këtu puna vazhdon në mënyrë intensive, janë hapur rrugët për të shkuar të gryka e tunelit për të devijuar Drinin".
>
> Për protestuesit është tashmë e qartë dëmet që sjell ndërtimi i HEC të Skavicës: ndarja e Dibrës ose zhdukja e saj - siç e vlerësojnë disa protestues, mbytja e tokave bujqësore, prishja e ekosistemit, ndryshimi i klimës, mungesa e reshjeve, mungesa e dokumenteve të pronësisë, mbytja e vendeve historike etj.

Drizi paralajmëroi përplasje të ashpra mes banorëve dhe qeverisë, por edhe punëtorëve që do të punojnë në këtë kantier.

"Në kemi ardhur këtu që ti dërgojmë një mesazh kompanisë "Bechtel": Ajo dorë që na mbyt je ti!. Vërtetë ke marrë bekimin e qeverisë shqiptare, por je ti që po na mbyt", deklaroi Drizi.

Nazmi Drizi është gjobitur në nëntor 2020, bazuar në një akt normativ të qeverisë, e cila ndalonte tubimet. Drizi udhëhoqi një protestë në Fushë Alie kundër planeve të qeverisë për HEC Skavica dhe autoritetet policore e ndaluan Drizin duke e gjobitur me një shumë prej 5 milionë lekësh. Drizi e ka konsideruar gjobën si një mënyrë për të frikësuar banorët që të ndalojnë protestat.

"Protestat do të jenë më të shpeshta dhe me më shumë njerëz", thotë Drizi.

Për protestuesit është tashmë e qartë dëmet që sjell ndërtimi i HEC të Skavicës: ndarja e Dibrës ose zhdukja e saj -siç e vlerësojnë disa protestues, mbytja e tokave bujqësore, prishja e ekosistemit, ndryshimi i klimës, mungesa e reshjeve, mungesa e dokumenteve të pronësisë, mbytja e vendeve historike etj.

"Qeveria nuk po i merr parasysh dëmet", - thotë Skënder Kuta, një ish-mësues në pension.

"Ne vlerësojmë se dëmi ekonomik që vjen me ndërtimin e HEC, është më i madh se përfitimet që llogarit qeveria". "Dibra shkatërrohet, nuk ka më Dibër", thotë Kuta.

Banorët janë të shqetësuar se deri më tani askush nuk ka shkuar ti pyesë, të diskutojë me to dhe të marrë mendimin e tyre.

"Skavica zhduk Dibrën përgjithmonë dhe pa e pyetur fare" shkruhet në një nga parullat e protestuesve.

KESH: STUDIMET PËRPARA, KONSULTIMET MË PAS

Katër ditë para kësaj proteste, më 12 maj 2022, Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH) njoftoi përmes faqes së saj në Facebook se po "vijon puna në terren për realizimin e fazës së parë të projektit Skavica".

KESH thotë se "ndërtimi i kësaj vepre mbi lumin Drin do të rrisë sigurinë e furnizimit me energji në vendin tonë, do të përmirësojë menaxhimin e kaskadës së Drinit dhe të ulë rreziqet e përmbytjeve në zonën e Shkodrës".

KESH dhe qeveria shqiptare vazhdojnë ti gjejnë përfitimet ekonomike jashtë Dibrës, por deri më tani nuk kanë gjetur mundësinë të bëjnë publike planet e tyre për banorët që shpërngulen nga shtëpitë, trojet dhe tokat e tyre.

Përmes njoftimit publik të datës 12 maj 2002, KESH thekson se "faza e parë e këtij projekti konsiston në realizimin e studimeve dhe analizave inxhinierike, mjedisore, sociale dhe financiare për të përcaktuar realizueshmërinë e tij (fizibilitetin)".


Vëzhgim i terrenit me helikopter. Foto: KESH


Pamje nga punimet në hapjen e rrugëve që të çojnë në vendin ku do të ndërtohet diga në Skavicë

Aktivitetet që po kryhen në këtë fazë përfshijnë: studimet inxhinierike dhe të projektimit, vrojtimet mjedisore dhe sociale si pjesë të procesit të vlerësimit të ndikimit mjedisor e social, studimet gjeoteknike, vrojtimet topografike, batimetrike dhe fotogrametrike etj.

Por vetëm 10 ditë më vonë nga ky njoftim publik, më 23 maj 2022, KESH njoftoi se "në kuadër të zbatimit të fazës së I-rë të projektit të Hidrocentralit të Skavicës, kanë përfunduar tashmë në terren vrojtimet mjedisore të vjeshtës dhe dimrit".

"Këto studime u kryen në kuadër të procesit të Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor e Social dhe kanë për qëllim evidentimin e ndikimeve të mundshme të projektit në mjedis si dhe identifikimin e masave që duhen marrë për shmangien, minimizimin apo adresimin e këtyre ndikimeve".

"Aktualisht është duke u kryer në terren edhe studimi ekologjik dhe po ashtu është në përfundim edhe studimi i gjendjes ekzistuese sociale të zonës së projektit".

"Të gjitha studimet e përmendura më sipër do të jenë pjesë e Raportit të Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor e Social, i cili pritet të përfundojë në tremujorin e tretë të këtij viti, e më pas do të konsultohet me të gjitha palët e interesit nëpërmjet takimeve dhe dëgjesave publike. Komentet dhe opinionet e marra gjatë procesit të konsultimit do të reflektohen më tej në raportin përfundimtar", shkruhet në njoftimin publik të KESH, shpërndarë përmes Facebook.

BANORËT PROTESTOJNË SËRISH: QEVERIA PO TALLET ME NE

Deklarata e dytë e KESH, shumë e ndryshme nga deklarata e parë, ka nxitur një protestë tjetër të banorëve, e cila është mbajtur në Fushë Alie, pranë Urës së Lushës mbi Drin.

"Qeveria po tallet me ne, - thotë një banorë për gazetën. Nga njëra ana thotë se "është duke u studiuar", nga ana tjetër thotë se "kanë përfunduar studimet". Si u përfunduakan studimet brenda 10 ditësh?

"Ne nuk kemi parë ekipe që të studiojnë mjedisin në terren. Nuk e dimë nga i kanë bërë studimet mjedisore "ekspertët" e kompanisë ose nënkontraktorët e tyre, por ata duhet ta dinë se po bëhen pjesë e një krimi, po bëhen pjesë e një genocidi ndaj banorëve të luginës së Drinit", tha një protestues.

"Si ka mundësi që studime të tilla, që duan vite, duan ekipe studimi, të mbarojnë kaq shpejt? Si u merrka një vendim për "mbytjen e Dibrës" kaq shpejt? Ky nxitim ka vetëm një shpjegim: "korrupsionin", - thotë Dalip Alia, njëri nga banorët e Fushë-Alies.

"Në qoftë se hidrocentrali ndërtohet dhe toka, shtëpitë, trojet dhe varret tona mbyten, jeta jonë mbaron këtu" - tha një banor i revoltuar.

"Ne nuk jemi dibranë, ne nuk jemi shqiptar dhe ne nuk ka asgjë që na bën krenar" -tha ai.

Banorët kërkuan një aleancë më të madhe të banorëve, ngado që janë, për të ndaluar planet për ndërtimin e HEC.

Shoqata për Mbrojtjen e Pellgut të Drinit të Zi ka paralajmëruar protesta të tjera përgjatë rrjedhës së lumit Drin, nga Kukësi në Dibër të Madhe.

Protesta e radhë do të mbahet me 5 qershor pranë Urës së Muhurrit, dhe të tjerat në ditët në vijim te Ura e Luznisë, Ura e Drinit në Gjoricë etj.

ORGANIZATA MJEDISORE KUNDËR PROJEKTEVE TË QEVERISË

Qeveria shqiptare që nga 3 qershori 2020, kur prezantoi studimin e fizibilitetit për Skavicën hartuar nga një kompani franceze, ka vazhduar planet e saj për ndërtimin e hidrocentralit.

Që pas nënshkrimit të kontratës mes KESH dhe Bechtel për fazën e parë të ndërtimit, qeveria ka bërë publike dy alternativat më të mundshme për ndërtimin e digës.

Varianti i parë parashikon ndërtimin e hidrocentralit në kuotën 388 metra mbi nivelin e detit, 92 metra lartësia e digës, 17.6 km2 sipërfaqja e rezervuarit, 326 milion metër kub ujë, me fuqi instalimi 120 MW dhe prodhim vjetor 479 GHh. Kosto e ndërtimit parashikohet 308 milionë Euro, nga të cilat 250 milionë për ndërtimin dhe 58 milionë euro për shpronësime dhe infrastrukturë.

Variantri i dytë parashikohet në kuotën 443 metra mbi nivelin e detit, 147 metra lartësia e digës, 54 km2 sipërfaqja e rezervuarit, 2319 milion metër kub ujë, me fuqi instalimi 210 MW dhe prodhim vjetor 915 GHh. Kosto e ndërtimit 510 milionë Euro, nga të cilat 350 milionë për ndërtimin dhe 160 milionë euro për shpronësime dhe infrastrukturë.

Në lidhje me kostot e ndërtimit, nga kjo fazë e parë e studimit pritet të dalin kosto shumë më të larta, për shkak të konfliktit Rusi-Ukrahinë, gjë që ka çuar në rritjen e ndjeshme të kostove të lëndës së parë për ndërtim.

Ndërkohë, disa organizata mjedisore në vend janë duke punuar për nisjen e një fushate në terren, për ndërgjegjësimin e banorëve për rreziqet që sjell ndërtimi i hidrocentralit, për ndikimet në jetën e tyre dhe në ekosistemin mbi nivelin e rezervuarit.

Ekspertët mjedisore mendojnë se ndërsa për një pjesë të luginës së Drinit toka do të mbulohet nga uji, pjesa tjetër e natyrës do të pasojë ndryshime të pariparueshme për mjedisin dhe jetesën në këtë zonë.

Organizata mjedisore të njohura në botë pritet që të vijnë në ndihmë të organizatave mjedisore lokale, me ekspertët e tyre të mjedisit dhe ligjit, në mënyrë që fushata kundër ndërtimit të hidrocentralit, sipas planeve të bërë publike nga qeveria, të ndalohet.

Për organizimin e një fushatë kundër ndërtimit të hidrocentralit është e nevojshme edhe ngritja e fondeve. Shoqata e Drinit të Zi ka kërkuar publikisht mbështetje financiare, sidomos nga të rinjtë jashtë vendit, dhe për këtë ajo ka publikuar edhe personat përgjegjës për mbledhjen e fondeve dhe ka publikuar gjithashtu edhe emrat e atyre që kanë ndihmuar deri më tani.

Korresp. Rr.A.

Ujëvara e Sopanikës? Si ka mundësi që një bukuri e tillë e rrallë, e trashëguar në shekuj, e cilësuar si një monument natyror i mbrojtur nga shteti, të sulmohej kaq egërsisht?

NJË DITË PER SKËNDERBEUN

Nga **OSMAN XHILI**

Data 6 maj bëri bashkë një grup jo të vogël njerëzish. Kishin ardhur në Dibër nga anë të ndryshme të vendit, nga Tirana Shkodra, Çamëria, Tuzi, Shkupi, Tetova,Kosova e shumë rrethina të tjera. Natyrisht kishte dhe dibranë, që si vendas, që ishin, i shoqëronin dhe i respektonin miqtë, që na nderonin.Inxhinjeri Munir Hoxha, profesori Hysen Uka, poetesha Miranda Derti e shumë të tjerë e zbukuronin takimin me praninë e tyre. Ndalesa e parë ishte bërë në Bulqizë, për të përkujtuar betejën e famshme të Vajkalit. Disa aktivitete u zhvilluan në qytetin e Peshkopisë. Një tryezë diskutimi rreth kësaj epoke dhe këtij personaliteti u zhvilluan hotel "Veri".Më tej, grupi u zhvendos në shëtitoren e blinave, ku u bënë homazhe pranë bustit të Skënderbeut, sponsorizuar nga biznesmeni dibran, Zaim Korsi.

Karvani i njerëzve dhe makinave vazhdon përpara. Një tjetër lapidar në Laçes,në anë të rrugës. I kushtohet betejës së Torviollit dhe masakrës, që bën turqit në këto rrethina, duke vrarë tetë mijë persona, burra, gra e fëmijë. Tashmë jemi duke lëvizur drejt Sinës, fshatit të lindjes së heroit tonë kombëtar, ku ndodhet dhe muzeu historik, që i kushtohet kësaj figure legjendare. Rruga e shkurtër, por e paasfaltuar, gjithë gropa e pluhur. Nëse vërtetë do ta donim aq shumë figurën e Skënderbeut,që shumëkush do të donte ta bënte të tijën, të paktën,rrugën ta kishim rregulluar në nder të tij.

Ndalojmë. Bëhen vizita te muzeu nga gjithë pjesëmarrësit, bëhen foto për ta përjetësuar këtë takim të bukur e më pas njerëzit ulen në formë rrethi në oborrin e muzeut, në një bashkëbisedim. Ashtu kishte bërë heroi ynë kombëtar me trimat e tij, sa herë që ishte në prag betejash dhe eventesh të rëndësishme.



Takimin e përshëndeti kryetari i Akademisë" Rrënjët tona", profesori Stefan Pinguli. Ai theksoi se është shumë e rëndësishme që t'i kërkojmë rrënjët tona, nga kemi ardhur, se kështu qartësojmë më mirë dhe udhën, që duhet të ndjekim në të ardhmen. Ne,si Akademi,- vazhdoi ai, - kemi 2500 vepra, dhe shumë shpejt do të sjellim nga një kopje, këtu, në muzeun e heroit tonë kombëtar. Le tu tregojmë skeptikëve, se e vërteta nuk mund të mbulohet e të manipulohet.

Pas tij e merr fjalën dhe profesori tjetër, drejtues i kësaj Akademie, Sazan Guri, ambientalisti aq i dashur dhe i njohur për publikun e gjerë.- Jo rastësisht,- tha profesor Sazani, nëntëmbëdhjetë, nga njëzetepesë beteja janë zhvilluar në Dibër, në vendlindje të heroit. Bota e shpik heroin dhe kur nuk e ka një të tillë, kurse ne që e kemi, nuk dimë ta mbajmë e ta vlerësojmë. Vazhdoi më pas, se Akademia ka grumbulluar kaq shumë të dhëna, në favor të kësaj teze e ka publikuar



disa libra, duke dhënë kështu një kontribut shumë të çmuar. Në fund, profesori citoi Gëten, duke thënë se : "Një popull, që nuk njeh rrënjët e veta, është i dobët si kallami dhe jo si një lis i fortë".

E morën fjalën dhe miqtë nga Kosova, që aq shumë e duan dhe e çmojnë heroin tonë kombëtar. Nikollë Perkaj është historian dhe kryetar i "Ballit kombëtar."Ai e vlerësoi Skënderbeun si një mburojë për kombin. Të huajt duan ta shkatërrojnë kombin tonë dhe pikë së pari ata duan të heqin këtë mburojë, duke zhvlerësuar dhe tjetërsuar figurën përbashkuese të heroit tonë kombëtar. Historiani është nga Gjakova dhe kishte marrë me vete nga malet rreth qytetit gjashtë gështenja të egra, për ti mbjellur këtu te muzeu. Nuk di pse në atë moment dhe unë ndjeva një krenari të të brendshme, pasi vitin e kaluar kisha sjellë dhjetë bredha si dhuratë për muzeun. Miku im i nderuar Hazis Kaloshi është kujdesur maksimalisht, për të mirëmbajtur godinën dhe ambientin për rreth tij, duke vaditur bimët dekorative dhe duke bërë ciceronin, aq sa mundet.


Ashtu si në shumë evente të tjera të bukura, nuk do të mungonte dhe deputeti Krashi. Ai u shpreh se jam në trojet e mia dhe më vjen mirë, që bëhemi bashkë këtu, nga anë të ndryshme të shqiptarisë. Sa më të thella rrënjët e historisë, shtoi ai, aq më larg duhet të shohim nga e ardhmja. Merr dhe një angazhim, për të lobuar fort në asfaltimin e rrugës për te muzeu, gjë që do të rriste mjaft numrin e vizitorëve për të ardhur këtu.

Në të gjitha këto takime më bënte përshtypje një burrë i gjatë me kostum popullor, me një pamje impozante, që për asnjë çast nuk e lëshonte nga dora flamurin kombëtar. Ishte Irfan Domnori nga Shkodra, që vinte nga një familje e hershme flamurtare dhe patriotike e këtij qyteti historik. Atlet i lindur dhe fitues i disa garave të saj në rini dhe tash pjesëmarrës e sfidues maratonash të organizuara. Dikur kish marrë pjesë si volejbollist i ekipit të Vllaznisë dhe më pas dhe i ekipit kombëtar, si një lojtar i talentuar dhe i palodhur. Deri në Çanakala të Turqisë kishte dërguar flamurin kombëtar, duke shfaqur shpirtin e tij atdhetar e patriotik. Ndoshta do ti kushtojmë një tregim më të zgjeruar këtij njeriu të paepur, që dhe pse u paralizua pas një aksidenti fatal, u ngrit në këmbë, falë forcës dhe vullnetit, duke marrë pjesë sërish në maratona dhe evente të tjera, si ky.

Bëmë dhe ca foto të tjera te gështenjat pesëqindvjeçare të kohës së Skënderbeut, pranë muzeut me emrin e tij dhe u nisëm sërish. Do të shkonim në stacionin e fundit,



të udhëtimit tonë ditor, drejt ujëvarës së Sopanikës. Nuk kishte lidhje direkte me heroin tonë kombëtar, por do të ishte një atraksion i veçantë për syrin e njeriut, po pse jo dhe për stomakun e tij. Duke lënë Çidhnën, devijuam majtas dhe ju afruam ujëvarës fantastike. Sapo kaluam rreth saj me miliona pikla të bardha na njomën e na ledhatuan. I gëzoheshin lirisë së fituar, pasi për pak do kishin përfunduar në tubat e errët të Hecit, që u tentua të ndërtohej para dy vjetësh. U shtangën banorët e Çidhnës e më gjerë. Si ka mundësi që një bukuri e tillë e rrallë, e trashëguar në shekuj, e cilësuar si



një monument natyror i mbrojtur nga shteti, të sulmohej kaq egërsisht?E çfarë kishin banorët mjet tjetër për ta mbrojtur, përveçse me trupat dhe jetët e tyre. Mjeku veteriner, Mustafa Tola, bir i këtij fshati ishte në krye të kësaj qëndrese. Kushëriri i tij, Mexhit Tola, i sëmurë me dializë erdhi nga Tirana, për të dorëzuar dhe atë pak frymë që i kishte mbetur, nëse kjo do të shërbente për të mbrojtur Sopanikën. Të tjerë e të tjerë banorë u grumbulluan, për të mos e dorëzuar ujin, amanet të të parëve. Atë që se kishin marrë serbët me luftë, po përpiqeshin ta marrin tani me dinakëri e forcë pushteti.

Fadroma po ecte përpara për të bërë gati vendin për të shtrirë tubat. Liman Kola, një nga banorët e fshatit, që kishte shërbyer me dekada si kuadër i bujqësisë dhe i arsimit, i del fadromës përpara. Ishte një vendim ekstrem, ku në pak sekonda ai mjet i stërmadh mund ta shtypte si një milingonë. – Nuk mund të merrni ujin, pa kapërcyer mbi trupin tim, - bërtiti me të madhe. Nuk kishte zgjidhje tjetër. Vendi do të thahej e do bëhej shkretëtirë. Tufa e dhive që kishte në shtëpi, kuajt e lopët do të kërkonin ujë për të pirë.

Mjeti u ndal e nuk bëri më tutje. Erdhën dhe të tjerët pastaj. Fadroma dhe njerëzit që e kishin sjellë deri aty u tërhoqën të mundur. Portelashet nuk paskan të sosur. Ata vazhdojnë akoma me gjygje,për tokat e tyre, pasuritë e tyre, ujrat e tyre. Kanë zhvilluar 19 seanca deri tani dhe më 20 qershor kanë të njëzetën.

Shumë pak nga ne mysafirët, dinim për këto gjëra. Po të mos ishte qëndresa e banorëve nuk do të kishte më Sopanikë, as vizita turistësh si kjo e jona. Aty pranë ujëvarës u shtrua një drekë e këndshme nga banorët bujarë të zonës. Mishi ikecit të pjekur, kosi, hudhrat, buka e zonës na shijuan kaq shumë, sa lodhja u hoq si me magji. Izet Shulku, Tarzani i Dibrës, nuk mund ti mungonte këtij takimi. Ai bëhet gati me kostumin e notit dhe zhytet në ujërat e ftohta e të rrëmbyera të ujëvarës. I bën ballë furisë së ujit dhe e sfidon atë.

Ndoshta pas një ëndrre të keqe, vjen diçka e mirë. Rruga mendohet të asfaltohet tani shpejt. Limani a dikush tjetër mendon të ngrejë një bujtinë. Pse jo dhe një mulli të bukur, që të bluaj drithin si dikur, si shumë të tillë, që ka pasur këtu pranë. Marrim rrugën e kthimit, të kënaqur, nga ato që pamë e dëgjuam, me miqtë që njohëm dhe shkëmbyem telefonat. Falenderuam dhe heroin tonë kombëtar, që dhe jetëndërruar na bashkoi atë ditë, që do të donim ta quanim, "Dita e Skënderbeut".

turizëm

Rafting në lumin e Drinit



Nga **OSMAN XHILI**

Mes shumë aktivitetesh të zhvilluara gjatë tre ditëve të festës në qytetin e Peshkopisë, jo pak interesant ishte dhe sporti i raftingut në lumin e Drinit. Diversiteti i formave të shtratit të këtij lumi, me zgjerim e ngushtim, me ujëra të qeta e më të rrëmbyera, me peizazhe interesante faqesh shkëmbore, kodrash, apo tokash të punuara e të mbjella, bashkuar me adrenalinën e këtij sporti të guximshëm, bëjnë një shumatore, që çdokush do të donte ta provonte e ta shijonte.

Dhe pse nisja e varkave do të bëhej poshtë urës së Topojanit, që nga lokali i Pajtim Beçës, nxënësit e gjimnazit " Fiqiri Dinja " të Maqëllarës, me në krye drejtorin e shkollës Admir Asllani dhe të kudogjendurën mësuese Zamirën, menduan ta zgjerojnë paksa hartën e aktivitetit. Ata u tubuan fillimisht te ura e re e Drinit, pranë Gjoricës. Pa u vonuar gjatë, nxënësit nisën të pastrojnë e të grumbullojnë mbeturinat e ndryshme të hedhura pa kujdes, apo ato që lumi i kishte nxjerrë në breg. Bashkë me ta ishte dhe zv/ministrja e turizmit, Almira Zebi Xhembulla, e bërë njësh me nxënësit e shkollës. Lodra dhe cula të luajtura mjeshtërisht nga Pëllum dhe Zabit Osmani e shoqëronin aktivitetin dhe sikur e përcillnin larg jehonën e tij.

Në një moment që ata e ndalën lojën virtuoze, afrohem dhe i pyes rreth pasionit



të tyre. Më tregojnë se janë aktivizuar që në moshën dhjetë vjeçare te Pallati i Pionierëve me profesorin e nderuar Hilmi Kolgjegja. Që atëherë ata nuk u janë ndarë aktiviteteve të ndryshme artistike dhe festivaleve të Gjirokastrës, duke merituar jo rrallë dhe çmime fituese. Krahas kënaqësisë kur tregojnë për arritjet e tyre, kanë dhe një merak. Nuk shohin të rinj të aktivizohen në këto lloje zhanresh dhe ndoshta vjen një ditë dhe nuk i pason më askush. Kanë dhe shumë gjëra për të treguar, por tashmë nxënësit po lëvizin për tek lokali i Pajtim Beçës pasi sportistët profesionistë të raftingut dhe dashamirës të shumtë bëhen gati për të lëshuar varkat në ujë.

Edi Truka është një djalë mjaft i shkathët, pjesë e grupit profesionist të "Rafting Black Drini". Bashkë me të janë dhe mjaft djem të tjerë pasionantë si Gesti, Blerimi, Gojarti, Niku, Eraldi, të cilët i pëlqejnë mjaft sportet e aventurës. Përveç raftingut, ata praktikojnë dhe kanoe, kajak, hidrospit, e të tilla si këto. Lumenj të tjerë përveç Drinit, si Vjosa, Osumi, por dhe destinacione jashtë vendit, janë të pëlqyera për grupin e djemve të guximshëm.

Tashmë njerëzit afrohen grupe-grupe pranë varkave të ankoruara. Ka ardhur deputeti Krashi, admirues e praktikues i sportit, bashkë me Sokol Savën, kryetar i këshillit bashkiak, që do të jenë pjesë e raftingut të sotëm. Ka ardhur dhe një familje nga Tirana, Sokoli, Vanina dhe dy vajzat e tyre, që së bashku do të jenë në të njëjtën varkë. Kanë qenë dhe në lumenj të tjerë të Shqipërisë dhe sot kanë vendosur të vizitojnë Dibrën me bukuritë e saj. Vanina ka marrë me vete dhe Manjola Fagun, kolegen e punës te ministria e financës. Ka ardhur dhe një turist holandez për të qenë pjesë e aktivitetit. Ai është për herë të dytë në Shqipëri dhe për herë të parë në Dibër. Quhet Nik Baker dhe drejton një organizatë me drejtim promovimin e turizmit, në vend dhe jashtë tij. Thotë se Zoti nuk është kursyer duke i dhuruar Shqipërisë bukuri përrallore. Ja, kështu vijnë turistët, duke tërhequr njëri tjetrin, si dallëndyshet kur zbulojnë vende të pëlqyera, për të të ndërtuar foletë dhe për të kaluar verën aty.





Edi Truka është një djalë mjaft i shkathët, pjesë e grupit profesionist të "Rafting Black Drini". Bashkë me të janë dhe mjaft djem të tjerë pasionantë si Gesti, Blerimi, Gojarti, Niku, Eraldi, të cilët i pëlqejnë mjaft sportet e aventurës. Përveç raftingut, ata praktikojnë dhe kanoe, kajak, hidrospit, e të tilla si këto.

Lindita Manga është drejtuese e ALCDF-së, që në terma të gjatë nënkupton Fondacionin shqiptar të zhvillimit të kapaciteteve lokale. Kjo organizatë filloi aktivitetin në vitin 2010, kur SNV pati mbyllur veprimtarinë e saj. ALCDF-ja është e shtrirë në katër qarqe të vendit, në Dibër, Tiranë, Korçë dhe Elbasan. Ajo ka pasur në fokus veprimtaritë e përbashkëta krosborder me Kosovën, Malin e Zi dhe Maqedoninë. Flora dhe fauna e liqeneve, shtigjet malore të biçikletave, menazhimi korrekt i mbetjeve dhe shumë projekte të tjera, janë fituar e realizuar me shumë korrektesë, duke dhënë një ndihmë shumë të çmuar për komunitetin. Dhe ky aktivitet i raftingut të kësaj dite, ishte produkt i punës së kësaj organizate e për këtë duhet falenderuar. Jo rastësisht, zyra e turizmit në Peshkopi, e menaxhur prej tyre, mbetet më e kompletuara, ndoshta dhe në rang vendi.

Besnik Alku ka vite që punon me këto projekte. Ai thotë se ka dhe shumë gjëra për të cilat duhet të falënderohet kjo organizatë, por ne po përmendim vetëm dy vlerësime speciale. I pari vjen për menaxhimin perfekt të fondeve të USAID-it dhe i dyti nga Zvicra për reformën territoriale .

Ikin dhe minuta të tjera dhe niveli i adrenalinës ka filluar të ngjitet, akoma pa u nisur. Edi Truka i fton të gjithë ata që do marrin pjesë të afrohen pranë varkave. Jepen kështillat e fundit para nisjes. Çfarë duhet bërë me komandën para, po me atë prapa, me komandën majtas dhe me atë djathtas. Si fiksohen këmbët për të pasur sa më shumë siguri. Si duhet mbajtur lopata në ujë, apo kur nuk vozisim. Po nëse bien aksidentalisht nga varka, si duhet të veprojmë? Disa prej tyre kanë marrë pjesë dhe herë të tjera dhe janë ambientuar, kurse disa e kanë për herë të parë. Pesë djem të gjimnazit bëhen gati për vozitje, të veshur me kostumet përkatëse. Bashkë me ta është dhe drejtori, Edmir Asllani, që nuk mungon asnjëherë në evente të tilla të bukura. Varkat nisen, që të katra, njëra pas tjetrës. Do të kalojnë Gradecin dhe do të përfundojnë në Hotesh, për të kënaqur të gjitha shqisat dhe gjymtyrët, gjë që ta dhuron vetëm një sport si ky.

Tashmë e kuptojnë akoma më qartë se sa vende të bukura na ka dhuruar Zoti dhe sa pak e dimë vlerën e tyre. Jo vetëm kaq, por dhe i shkatërrojmë këto pamje e mjedise të mrekullueshme. Nëse ndërtohet Skavica do të humbin njëherë e mirë këto kanione e bukuri natyrore, do të humbet përfundimisht mundësia për të bërë rafting, apo sporte të tjera të aventurës. Ndoshta për të moshuarit do të jetë më mirë, pasi do të notojnë në një traget të qetë, që nga ura e Drinit, deri në fshatrat e Reçit. Lusim Zotin, që të bëhet më e mira për banorët e Dibrës.

Rruga e Arbërit nr. 189

vlerësim

EDLIRA HAXHIYMERI, *intelektuale e përmasave kombëtare e ndërkombëtare*

Nga **MUSA RIÇKU***

Më 14 maj 2022 u nda nga jeta prof. dr. Edlira Haxhiymeri. Ikja e saj e parakohshme ka lënë në pikëllim jo vetëm familjen e saj, po edhe ne, miqtë e saj, anëtarët e Shoqatës Lidhja e Intelektualëve Dibranë, të cilët patëm fatin që për vite me radhë të udhëhiqeshim nga një grua mend-jendritur, të zgjuar e të dashur si ajo.

Edlira ishte një "cucë dibrane". Shtëpia e saj e fëmijërisë ishte pikërisht në Rrugën e Dibrës, pranë komuniteti dibran që ishte zhvendosur në Tiranë që para viteve të luftës. Gjatë fëmijërisë Edlira shpenzonte vazhdimisht verën pranë familjeve të gjyshërve të saj në Peshkopi. Ajo ka ndjerë dhe përjetuar ndjenjën e fortë të dashurisë, që vetë prindërit i kanë ushqyer për vendlindjen që në vitet e para të saj. Lidhja e fortë me Dibrën, e cila u brumos që në fëmijëri, mbeti një gur reference përgjatë çdo angazhimi të mëtejshëm të Edlirës.

Vlerësimi i saj për Dibrën si qyteti më i bukur, më i pastër, më mikpritës më me traditë, por dhe për karakterin punëtor dhe të ndershëm të dibranëve, mbeti i pandryshuar përgjatë jetës së saj. Fati, puna, detyra e saj i krijuan mundësitë që të vizitonte qytete nga më historikët dhe madhështorë të botës, si në Lindje, ashtu edhe në Perëndim, por kur kujtonte Dibrën, rruga e kthimit i bëhej edhe më e shkurtër se sa ajo që kishte vajtur. Ky lloj vlerësimi shkonte deri atje saqë nuk e mendonte që jetonte në kryeqytet, por kryeqendra e vendit për të duhej pa dyshim që të ishte vendlindja e prindërve të saj, Dibra.

Prof. dr. Edlira Haxhiymeri ishte një personalitet i spikatur i botës akademike, i politikës dhe i shoqërisë civile shqiptare.

U diplomua në fushën e gjuhës angleze në Universitetin e Tiranës në vitin 1982 dhe kreu studimet pasuniversitare për Psikologji-Pedagogji, duke u diplomuar në vitin 1987.

Në vitin 1992 ishte një nga themelueset e Departamentit të Punës dhe Politikës Sociale në Fakultetin e Shkencave Sociale. Mbrojti doktoratën në fushën e studimeve psiko-sociale në Universitetin e Tiranës në vitin 1995.

Fitoi titullin akademik "Profesor i Asociuar" në vitin 2003, ndërsa titullin akademik "Profesor" në vitin 2016.

Ajo kishte kryer specializime pasuniversitare në fushën e pedagogjisë dhe të psikologjisë në vend dhe në fushën e politikave dhe administrimit të arsimit në SHBA. Ka punuar si pedagoge vizitore në GVSU, Miçigan, dhe bashkëpunëtore e jashtme e Universitetit Clemson në Karolinën e Jugut në SHBA.

Pati një përvojë prej 39 vitesh në mësimdhënie dhe kërkim në fushën e pedagogjisë, psikologjisë dhe të punës sociale, e përqendruar në nënfushat: sjellja njerëzore, mirëqenia e fëmijës, zhvillimi i fëmijës, të drejtat e fëmijëve, gjinia dhe barazia, të drejtat e grave, fuqizimi i grave. Ka kontribuar në themelimin dhe zhvillimin e shkollës së punës sociale në Shqipëri, si dhe në formimin, përgatitjen dhe diplomimin e dhjetëra brezave të punonjësve socialë dhe profesionistëve të tjerë të shërbimeve psiko-sociale në vend. Kishte përvojë të pasur në planifikimin, organizimin dhe drejtimin e projekteve të kërkimit në fushën e arsimit dhe të shkencave sociale.



Prof. dr. Edlira Haxhiymeri dhe z. Musa Riçku, gjatë një veprimtarie të shoqatës Lidhja e Intelektualëve Dibranë

Ashtu si i ati, edhe Edlira nuk nguroi kurrë të përdorte imazhin dhe lidhjet e saj për të ndihmuar dibranët dhe për të promovuar Dibrën me të gjitha mundësitë e saj. Ajo luajti një rol të madh si kryetare e shoqatës "Lidhja e Intelektualeve Dibranë". Si drejtuese e Shoqatës ajo luajti një rol të rëndësishëm në organizimin e komunitetit dibran në Tiranë si dhe evidentimin e vlerave më të mira dibrane në kryeqytet.

Angazhimi i saj pranë Lidhjes së Intelektualëve Dibranë ishte pikërisht vazhdimi i kësaj përpjekje, por tashmë në bashkëpunim me figurat e tjera publike të vendlindjes së saj. Përpjekja e kahershme e dibranëve për të mbështetur ndërtimin e Rrugës së Arbrit ishte një qëllim i rëndësishëm për Edlirën, të cilën fatkeqësisht nuk pati mundësinë të shihte të mbaruar.

Prof. dr. Edlira Haxhiymeri ka dhënë gjithashtu një kontribut aktiv në zhvillimin e reformave dhe politikave arsimore të të gjitha niveleve në Shqipëri. Gjatë 22 viteve të fundit ajo ka mbajtur pozicione të rëndësishme drejtuese në arsimin e lartë, si përgjegjëse e Departamentit të Punës Sociale, anëtare e Senatit të Universitetit të Tiranës, zv. Rektore e Universitetit të Tiranës dhe zv. Ministre e Arsimit. Gjatë vitit 2005 ajo ushtroi dhe detyrën e Prefektes së Qarkut të Tiranës.

Kontribuoi për zhvillimin e arsimit të lartë dhe zhvillimin e programeve të studimit edhe në trojet shqiptare përtej kufirit në fushën e punës sociale në Universitetin e Evropës Juglindore të Maqedonisë së Veriut dhe në Kosovë.

Prof. dr. Edlira Haxhiymeri spikati për aktivizimin e saj për të drejtat e njeriut, të drejtat e fëmijëve dhe të grave. Ajo ishte themeluese dhe drejtore ekzekutive e Strehëzës për Gra dhe Vajza të Dhunuara në Tiranë, i pari institucion i ngjashëm në vend, i cili u kthye në pikë referimi edhe për institucione të tjera publike që u ngritën më pas.

Ajo luftoi për kauza të rëndësishme të shoqërisë dhe në veçanti të familjes shqiptare. Ishte anëtare e disa shoqatave profesionale ndërkombëtare të fushës së arsimit dhe të punës sociale në nivel evropian e më tej. Pati një përvojë të pasur në koordinimin dhe realizimin e projekteve të përbashkëta ndërkombëtare në fushën e arsimit

Prof. dr. Edlira Haxhiymeri ka botuar si autore dhe bashkautore shumë artikuj në revista kombëtare dhe ndërkombëtare, botoi tekste shkollore dhe universitare. Disa nga botimet e saj më të rëndësishme janë: "Dhuna në familjen shqiptare", "Sjellja njerëzore dhe mjedisi social", "Rolet dhe stereotipat gjinore", "Mitet dhe realitetet e dhunës në familje", "Dhuna ndaj fëmijëve dhe pasojat në zhvillimin e tyre" etj.

Ashtu si i ati, edhe Edlira nuk nguroi kurrë të përdorte imazhin dhe lidhjet e saj për të ndihmuar dibranët dhe për të promovuar Dibrën me të gjitha mundësitë e saj. Ajo luajti një rol të madh si kryetare e shoqatës "Lidhja e Intelektualeve Dibranë". Si drejtuese e Shoqatës ajo luajti një rol të rëndësishëm në organizimin e komunitetit dibran në Tiranë si dhe evidentimin e vlerave më të mira dibrane në kryeqytet.

Angazhimi i saj pranë Lidhjes së Intelektualëve Dibranë ishte pikërisht vazhdimi i kësaj përpjekje, por tashmë në bashkëpunim me figurat e tjera publike të vendlindjes së saj. Përpjekja e kahershme e dibranëve për të mbështetur ndërtimin e Rrugës së Arbrit ishte një qëllim i rëndësishëm për Edlirën, të cilën fatkeqësisht nuk pati mundësinë të shihte të mbaruar.

E gjithë jeta e prof. dr. Edlira Haxhiymerit u karakterizua nga humanizmi, aktivizimi, profesionalizmi dhe dashuria për vendin. Me shembullin e saj ajo ndriçoi dhe ndryshoi jetën e shumë njerëzve. Edlira do të kujtohet si një ndër personalitetet e shquara të botës akademike dhe gratë e suksesshme të Shqipërisë.

Edlira Haxhiymeri ishte një intelektuale emërmirë e përmasave kombëtare dhe ndërkombëtare

Kryesia e Shoqatës Lidhja e Intelektualeve Dibranë i ka propozuar kryetarit të Bashkisë Dibër dhe Këshillit Bashkiak, që të vlerësojë kontributin e prof.dr. Edlira Haxhiymerit si: "Profesore e Shkencave Sociale në fushën e pedagogjisë, psikologjisë, të drejtat e fëmijëve dhe grave; në fuqizimin e rolit të gruas në jetën shoqërore e publike; kontributin në themelimin dhe zgjerimin e arsimit publik në Maqedoninë e Veriut dhe Kosovë; si dhe rolin si udhëheqëse e komunitetit dibran në Tiranë në organizimin e jetës shoqërore dhe politike, duke nderuar gjithmonë dhe pa kufij Dibrën dhe dibranët.

Vlerësimi që duhet t'i bëhet nga Këshilli Bashkiak i Dibrës dhe anëtarët e saj është një vlerësim i merituar jo vetëm për profesoreshën tonë, por edhe për komunitetin dibran, që ka nxjerrë personalitete të tilla, që nderojnë emrin e tyre dhe të Dibrës sonë.

**Nënkryetar i Shoqatës LID*

homazh

Kryesia e Shoqatës Lidhja e Intelektualëve Dibranë dhe redaksia e gazetës shprehin ngushëllimet për ikjen e parakohshme nga kjo botë të prof. dr. Edlira Haxhiymeri. Ajo do të mbahet mend gjatë për kontributin e saj në shoqatë, në udhëheqjen e saj në krye të shoqatës LID, për organizimin, ndërgjegjësimin dhe punën e mirë në dobi të komunitetit dibran në Tiranë dhe kudo.

Me personalitetin dhe shembullin e saj ndriçoi dhe ndryshoi jetën e shumë njerëzve dhe fali dashuri pa kushte

Nga **NIKOLETA MITA**

Të dashur familjarë të Edës, miq, kolegë dhe të njohur,

Ndonëse jam ende e tronditur nga ndarja nga jeta e mikes sonë të dashur, Edlira, jam e përulur dhe e prekur nga jeta që ajo ndau me ne.

Të gjithë jemi këtu sepse diku, disi, jetët tona ishin të lidhura me Edën. Besoj se që të gjithë keni momentet tuaja personale, të veçanta dhe private me Edën që do t'i çmoni dhe do t'i mbani në zemrat tuaja.

Eda bëri një betejë të guximshme dhe të fortë për pesë vjet me sëmundjen, duke shpresuar se trajtimet do të përfundonin më në fund që të mund të vazhdonte jetën e saj. Kjo ishte edhe shpresa e të gjithëve ne. Por, nuk ndodhi kështu.

Është një detyrë e vështirë të përmbledhësh në fare pak minuta një jetë të tërë, e aq me teper një jetë të jetuar intensivisht, siç ishte jeta e Edës.

E lindur dhe e rritur në një familje të nderuar, ajo mbarti në personatiltetin e vet tiparet më të mira të prindërve dhe të fisit të saj. Mirënjohje prindërve, bashkëshortit, djalit, vëllait dhe Silvës të cilët e mbështetën Edën në rrugëtimin e saj të ndritur dhe në betejën e saj për jetën. Por, unë do të ndalem vetëm në katër aspekte që e bëjnë Edën të paharrueshme nga kushdo: humanizmi, aktivizmi, shumëkulturalizmi dhe profesionalizmi.

Eda ishte gjithmonë e zënë duke ndihmuar të tjerët. Ajo i bënte të gjithë të ndiheshin të veçantë. Kjo ishte dhurata e saj më e madhe për njerëzit. Eda ndihmonte këdo që kishte nevojë. Pozitiviteti i saj ishte një frymëzim për të gjithë ata që takonte. Askush që e ka njohur Edën, nuk e harron dot sepse ajo linte gjurmë e ndikonte te njerëzit në mënyra të ndryshme, ajo pati ndikim në jetën e shumë njerëzve përreth saj.

E gjithë jeta e saj u karakterizua nga një aktivizëm i shprehur. Ajo çdo ditë në mënyra të ndryshme promovonte vlerat më të mira njerëzore dhe vlerat më të mira të Shqipërisë. Kontributi i saj për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, të drejtave të fëmijëve dhe të drejtave të grave dhe veçanërisht kontributi për mbrojtjen e grave, vajzave dhe fëmijëve të dhunuar është i spikatur. *Strehëza për Gra dhe Vajza të Dhunuara në Tiranë* identifikohet me emrin e Edës. Sa jetë ka mbrojtur dhe ka rikthyer në normalitet nëpërmjet *Strehëzës*! Aktivizmi i saj për një shoqëri demokratike, gjithashtu, është i rëndësishëm. Nëpërmjet pozicioneve drejtuese si prefekte e Qarkut të Tiranës dhe si zëvendësministre e arsimit, si zëvendësrektore e Universitetit të Tiranës dhe si drejtuese e Departamentit të Punës dhe Politikës Sociale të Fakultetit të Shkencave Sociale, ajo u përpoq të inicionte dhe të mbështeste ndryshimin. Ajo veproi me idealizëm për të sjellë ndryshimin. Ajo bëri gjithçka mundi për të bërë të njohur Shqipërinë në botë. Në takimet me të huajt e përshkruante Shqipërinë me ngjyra të bukura, e ndonëse kur të huajt vinin këtu dhe e shikonin që nuk ndriçonte aq sa e përshkruante Eda, ata iknin me një dëshirë për t'u kthyer përsëri në Shqipëri.

Eda me plot kuptimin e fjalës mund të quhet një individ shumëkulturor. Ajo mendonte, perceptonte, sillej dhe u përgjigjej çështjeve globale në mënyra më komplekse sesa individët monokulturorë. Ajo i mendonte në një mënyrë më komplekse gjërat se njerëzit e tjerë rreth saj që kishin njohje më të kufizuar të kulturave. Ajo ishte nga ata njerëz që përktheu veçoritë e të qenit shumëkulturor në sukses në karrierë, veçanërisht në transmetimin e kulturës perëndimore.



EDLIRA HAXHIYMERI (28 shkurt 1960 - 14 maj 2022)

Eda studioi në mënyrë të thelluar gjuhën dhe kulturën shqiptare, amerikane dhe angleze, pedagogjinë, psikologjinë dhe punën sociale. Ajo njohu përvojat akademike të rreth 30 vendeve të botës, si të SHBA, të Britanisë së Madhe, Belgjikës, Danimarkës, Francës, Gjermanisë, Hollandës, Austrisë, Izraelit, etj. Pra, formimi dhe përvoja e pajisën atë me dije, aftësi, modele të disa kulturave. Eda përcolli te të huajt gjërat më të veçanta dhe karakteristike të Shqipërisë, ndërsa të njëjtën gjë bëri me përcjelljen e kulturës perëndimore në Shqipëri.

Shumë njerëz janë të hutuar nëse janë shumëkulturorë. Por kjo nuk ndodhte me Edën. Ajo i njihte kulturat dhe dinte veçoritë e tyre dhe nuk hutohej prej kësaj gjëje, por ky shumëkulturalizëm e ndihmonte të prodhonte ide dhe modele të reja. E kështu, duke u identifikuar me më shumë se një kulturë, kur ajo ndodhej në një mjedis ndërkombëtar, njerëzit nuk e identifikonin dot se nga cili vend ishte.

Eda spikati për profesionalizmin e saj. Ajo gërshetoi në një mënyrë unike vokacionin, misionin dhe kompetencat profesionale. Ajo dha mësim me përkushtim maksimal duke iu përgjigjur ndjenjës së fortë për shërbim. Nëpërmjet mësimit dhe kërkimit ajo kontribuoi në mënyrën e saj unike në humanizimin e jetës, në përmirësimin e kësaj bote. Si mësuese dhe pedagoge ajo edukoi dhe formoi breza të tërë nxënësish dhe studentësh të cilët jo vetëm fituan njohuri, por shumë prej tyre e zgjodhën Edën si model për ta ndjekur.

Dhe prandaj, le të shprehim me një duartrokitje të fortë një falenderim të madh për Edën që me personalitetin dhe shembullin e saj ndriçoi dhe ndryshoi jetën e shumë njerëzve dhe fali dashuri pa kushte.

Le ta mbajmë Edën në kujtimet tona përgjithmonë!

Ndahet nga jeta Prof.dr. Edlira Haxhiymeri, një personalitet i spikatur i botës akademike

Më 14 maj 2022 u nda nga jeta prof. dr. Edlira Haxhiymeri. Ajo u lind në Tiranë më 28 shkurt 1960 nga dy prindër dibranë, Tahir dhe Nustrete Haxhiymeri. Tahiri, si një pasardhës i familjes së Iljaz Pashë Dibrës (Qokut) ishte dhe mbeti si pedagogu që bëri më shumë për ato studentë dibranë që u shkolluan në ato vite në Tiranë. Ndërsa nëna e saj, Nustretja, ishte bijë në fisin e njohur të Shehlerëve.

Edlira, si një cucë dibrane, që në fëmijëri e ka ndjerë dhe përjetuar ndjenjën e fortë të dashurisë që vetë prindërit i kanë ushqyer për vendlindjen. Përfytyrimi i saj për Dibrën është si qyteti më i bukur, më i pastër, më mikpritës dhe më me traditë se çdo qytet tjetër. Fati, puna, detyra e saj ia krijuan mundësitë që Edlira të vizitonte qytete vërtet të bukur dhe madhështorë të botës, si në lindje, ashtu edhe në perëndim, por kur kujton Dibrën, rruga e kthimit i bëhej edhe më e shkurtër se sa ajo që kishte vajtur. Ky lloj vlerësimi shkonte deri atje saqë nuk e mendonte që jetonte në kryeqytet, por kryeqendra e vendit për të duhej pa dyshim që të ishte vendlindja e prindërve të saj, Dibra.

Prof. Dr. Edlira Haxhiymeri, njihet si personalitet i spikatur i botës akademike, i politikës dhe i shoqërisë civile shqiptare.

Edlira ishte profesore në Departamentin e Punës dhe Politikës Sociale të Fakultetit të Shkencave Sociale të Universitetit të Tiranës si dhe bashkëpunëtore e jashtme e Universitetit Clemson (SHBA).

U diplomua në fushën e gjuhës angleze në Universitetin e Tiranës, në vitin 1982. Mbrojti doktoratën në fushën e studimeve psiko-sociale në Universitetin e Tiranës, në vitin 1995. Fitoi titullin akademik "profesor i asociuar" në vitin 2003, ndërsa titullin akademik "profesor" në vitin 2016.

Kishte kryer specializime pasuniversitare në fushën e pedagogjisë dhe të psikologjisë në vend dhe në fushën e politikave dhe administrimit të arsimit në SHBA. Pati një përvojë prej 39 vitesh në mësimdhënie dhe kërkim në fushën e pedagogjisë, psikologjisë dhe të punës sociale, e përqendruar në nënfushat: sjellja njerëzore, mirëqenia e fëmijës, zhvillimi i fëmijës, të drejtat e fëmijëve, gjinia dhe barazia, të drejtat e grave, fuqizimi i grave.

Ka kontribuar në themelimin dhe zhvillimin e shkollës së punës sociale në Shqipëri, si dhe në formimin, përgatitjen dhe diplomimin e dhjetëra brezave të punonjësve socialë dhe profesionistëve të tjerë të shërbimeve psikosociale në vend. Kishte përvojë të pasur në planifikimin, organizimin dhe drejtimin e projekteve të kërkimit në fushën e arsimit dhe të shkencave sociale.

Ajo punoi për një vit si pedagoge vizitore në GVSU, Michigan të SHBA. Dha mësim në institucionet e arsimit të lartë në Maqedoninë e Veriut.

Dha një kontribut aktiv në zhvillimin e reformave arsimore të të gjitha niveleve në Shqipëri. Gjatë 22 viteve të fundit ajo ka mbajtur pozicione të rëndësishme drejtuese në arsimin e lartë, si përgjegjëse e Departamentit të Punës Sociale, anëtare e Senatit të Universitetit të Tiranës, zëvendësrektore e Universitetit të Tiranës dhe zëvendësministre e Arsimit.

Kontribuoi për zhvillimin e arsimit të lartë në Kosovë dhe zhvillimin e programeve të studimit në fushën e punës sociale në Universitetin e Evropës Juglindore të Maqedonisë së Veriut. Ishte anëtare e disa shoqatave profesionale ndërkombëtare të fushës së arsimit dhe të punës sociale. Pati një përvojë të pasur në koordinimin dhe realizimin e projekteve të përbashkëta ndërkombëtare në fushën e arsimit.

Edlira Haxhiymeri botoi si autore dhe bashkautore shumë artikuj në revista kombëtare dhe ndërkombëtare, botoi tekste shkollore dhe universitare.

Edlira spikati për aktivizmin e saj për të drejtat e njeriut, të drejtat e fëmijëve dhe të grave. Ajo ishte drejtore ekzekutive e Strehëzës për gra dhe vajza të dhunuara, në Tiranë. Ajo luftoi për kauza të rëndësishme të shoqërisë dhe në veçanti të familjes shqiptare.

Edlira pati një angazhim politik në Partinë Socialiste dhe u pozicionua me një mendim ndryshe. Ajo ishte prefekte e Qarkut të Tiranës.

E gjithë jeta e Edlirës u karakterizua nga humanizmi, aktivizmi dhe profesionalizmi. Me shembullin e saj ajo ndriçoi dhe ndryshoi jetën e shumë njerëzve.

Edlira do të kujtohet si një ndër personalitetet e shquara të botës akademike dhe gratë e suksesshme të Shqipërisë.

Rruga e Arbërit nr. 189

intervistë

Pranvera plot lule e

Kjo është një intervistë që kam realizuar në vitin 2018 me Edën tonë të dashur, kur Albanian Excellence shpalli histori suksesi të lindurit në vitet 60-të! Kur pashë titullin e intervistës, mbas kerkimit ne arshive, "Pranvera plot lule e Edlira Haxhiymerit", u drodha. Mendova me zë: po e vërtetë, lulet për Eden do të jenë gjithnjë të fresketa

Nga **FLORA NIKOLLA**



Do të dëshiroja të udhëtoja në çdo cep të botës, por do të desha të jetoja vetëm në Shqipëri. Ka qenë zgjedhja ime edhe kur bashkëmoshatarët e mi dhe jo vetëm rendën të largoheshin nga ky vend. Natyrisht Shqipëria është më e varfër pa ata, por unë nuk do ta bëja dot.

Brezi ynë ishte brezi i sfidës së madhe. Me formimin tonë para demokracisë, ne treguam se ishim të zotët të përshtateshim, të merrnin njohuri të reja, të sfidonim vështirësitë dhe t'ja dilnim të ndërtonim familje, profesion por edhe emër në Shqipëri dhe në botë. Kjo nuk është pak për një brez si i yni. Të qënit inteligjentë dhe energjik ndihmuan në këtë proces përshtatjeje dhe na mundësuan të quheshim brezi i sfidës së madhe dhe jo brez i humbur.

Edlira Haxhiymeri, është një njeri aktiv, plot energji, e mbushur me dashuri për njerëzit dhe me plot dëshira e qëllime të mira. Nuk lodhet kurrë. Bie gjithnjë në këmbë. Edhe rënien e fundit, beson se të tillë e ka bërë. I pëlqen vetja ashtu si e njeh ajo: një grua e plotësuar që nuk lodhet së punuari e së bëri gjërat që i ka përzemër. Fuqinë e ka të lidhur me personalitetin. Ka besuar dhe vlerësuar atë që ka dhe është. Është mësuar të vlerësojë arritjet e saj dhe kjo i ka dhënë fuqi. Nuk e di se cfarë fuqie do të deshte të kishte, mbase fuqinë për të bërë ndryshime të qënësishme përtej vetes së saj.

F.N:Cila je realisht? Do të ishte mirë të tregoje, nga je, çfarë bën , por veç këtyre, a mund të tregosh thelbin e vërtetë të qënies tënde…?

E.H:Unë jam Edlira, nga Tirana, profesore në Universitetin e Tiranës, grua, nënë, bijë, motër dhe mike e kolege me shumë prej jush dhe jo vetëm. Jam një njeri aktiv, plot energji, e mbushur me dashuri për njerëzit dhe me plot dëshira e qëllime të mira. Nuk lodhem kurrë. Bie gjithnjë në këmbë. Edhe rënien e fundit, besoj të tillë e kam bërë.

F.N: E ke menduar ditën e lindjes sipas perceptimit tënd, apo ke mbetur tek tregimi i njerëzve të afërt?

E.H:Jam përpjekur t'i bashkoj të dyja. Përshkrimin e nënës sime si një ditë pranvere plot diell e lule, dhe perceptimin tim si një ditë kur kësulkuqja kishte hapur dyert e shtëpisë për t'u mbushur me ajër dhe për të hapur flatrat, gati për fluturim.

F.N: Në se do të shkruanit çdo gjë që të ka ndodhur deri më tani, beson se njerëzit do të donin ta lexonin? Cili do të ishte tharmi që do t'i detyronte ta lexonin?

E.H: Nuk di a do të kisha mjaftueshëm material interesant dhe të vecantë, por nëse do ta bëja një gjë të tillë, unë besoj se njerëzit do të gjenin veten në përshkrimin e jetës sime, unë jam një prej jush.

F.N: Çfarë quan ti çmënduri? A kujton ndonjërën prej tyre, e cila, pavarësisht etiketimit, ty vazhdon të duket normale?

E.H: Besoj se brezi ynë nuk e ka patur fatin të jetojë kohën e cmendurirave. Cmenduritë përjetohen kryesisht në adoleshencë dhe adoleshenca jonë ka qenë e ndrydhur.

F.N: A ke ndonjë fjalë sekrete që e përdor në momentet e tua të vështira?

E.H:Ul qepenin! - është shprehja që më ndihmon të ruaj qetësinë edhe kur mjedis përreth është furtunë.

F.N:Si do ta përshkruash veten tënde me tre mbiemra?

E.H:E fortë, e vendosur dhe e dhëmbshur.

F.N:Beson se njeh veten mirë? Si e njeh?

E.H:Besoj se e njoh. Jeta më ka dhënë shumë mundësi për ta njohur veten në të gjitha dimensionet. Më pëlqen vetja ashtu si e njoh unë. Jam grua e plotësuar që nuk lodhet së punuari e së bëri gjërat që i ka për zemër.

F.N: Mund të tregosh historinë më të bukur të jetës në 10 rreshta?

E.H: Momenti më i bukur i jetës mendoj ka qenë momenti kur solla në jetë djalin tim të vetëm. E qara e tij ishte zëri i jetës që më ngriti në këmbë për t'i dhuruar puthjen e parë. Ky moment i mbushur me puthje, të qara, dhimbje, dashuri, përkujdesje dhe përkushtim besoj se i dha ngjyrë gjithë jetës sime. Sytë e tij plot dritë, fytyra e ëmbël, buzët e vogla, duart që drejtoheshin drejt gjirit, koka që lëvizte në kërkim të aromës së nënës, ishin impulset e para të një marrëdhënie që u ndërtua në vite për ta mbushur jetën time e të familjes sonë. Të njëjtën kënaqësi më ka falur në çdo fazë të jetës, madje edhe sot që është burrë i rritur.

F.N:Po më të vështirën?

E.H:Të përballesh me sëmundjen atëhere kur mendon se je njeriu më i lumtur, më i plotësuar, madje më i paprekshëm nga e keqja. Ta sfidosh sëmundjen, ta flakësh tutje dhe t'i tregosh asaj se forca e shpirtit është mbi gjithçka.

F.N:Ke disa hobby, ti mendon se ke shkuar ti tek ato, apo kanë ardhur ata tek ty?

E.H: Po kam disa: udhëtimet, librat, lulet, punët e dorës, notin dhe shëtitjen në natyrë. Mendoj se kam shkuar dalëngadalë drejt tyre. Në kërkim të vetes, kam gjetur hobbet e mia.

F.N:Sa herë je ndjerë i tradhtuar? A e fal ti tradhtinë?

E.H:Shumë herë. Nga njerëz që ju kam falur mbështjetje, dashuri, vëmendje, kohë, besim etj. Tradhëtia e dikujt ndaj meje nuk është çështja ime. Ja lë Zotit në dorë të merret me to...

F.N:Tani, pas dekadash jetë !!!, pse fëmijët shijojnë fëmijërinë ashtu si të rriturit shijojnë rritjen?

E.H: Çdo cikël i jetës ka lezetin e vet. Një i rritur nuk mund të shijojë fëmijërinë. Fëmijëria shijon në moshën e saj ashtu sikurse edhe fëmijët nuk mund të shijojnë moshën e rritur. Nuk munden. Prandaj ne themi shpesh: lërini fëmijët të shijojnë fëmijërinë e tyre. Nëse nuk e shijojnë në kohë, kurrë nuk do të ndihen të plotësuar. Një fazë e rëndësishme e jetës do t'u mungojë përjetësisht.

F.N:Si mund ta përcaktosh brezin tënd, ke besuar tek ai, cilët kanë qenë kushtet që kanë ndikuar në formimin e tij? A mund të quhet brez i humbur?

E.H:Brezi ynë ishte brezi i sfidës së madhe. Me formimin tonë para demokracisë, ne treguam se ishim të zotët të përshtateshim, të merrnin njohuri të reja, të sfidonim vështirësitë dhe t'ja dilnim të ndërtonim familje, profesion por edhe emër në Shqipëri dhe në botë. Kjo nuk është pak për një brez si i yni. Të qënit inteligjentë dhe energjik ndihmuan në këtë proces përshtatjeje dhe na mundësuan të quheshim brezi i sfidës së madhe dhe jo brez i humbur.

F.N: Çfarë nuk duron tek të tjerët dhe si e kapërcen mosdurimin …?

E.H:Gënjeshtrën nuk e duroj dot. Në të tilla momente përpiqem duke i thënë vetes: ul qepenin!

F.N:Mes njeriut më tërheqës, por dhe më të varfër, njeriut më të pasur, por dhe më të shëmtuar, cilin do të zgjidhje?

E.H:Njeriun tërheqës, pavarësisht varfërisë së tij. Një njeri i zoti mund ta kapërcejë gjithnjë varfërinë.

F.N:Cilat janë tre cilësitë që çmon tek një njeri?

E.H:Mencuria, trimëria, besnikëria.

F.N:Si dhe çfarë është për ty është shtëpia jote? Cili është objekti më i çuditshëm që ke në dhomën tënde?

E.H:Vendi i qetësisë, sigurisë dhe ngrohtësisë. Objek i çuditëshëm? Asgjë që të çudit.

F.N:Çfarë vendi zë gënjeshtra në jetën tënde? Në fakt kur gënjën?

E.H: Nuk di të gënjej. Jam lehtësisht e lexueshme. Kur njerëzit me lodhin, gënjej.

F.N:Cili je ti në një bashkëbisedim me një mik?

E.H:Dëgjuesja e mire.

F.N:Çfarë është frika për ty? Cilat janë frikërat më të mëdha që ke dhe si i kontrollon? Çfarë të frikëson ty në këtë botë?

E.H: Përgjithësisht nuk kam frikë. Besoj se kam forcën brenda vetes për të përballuar të gjitha frikërat. I frikësohem vetëm të shëndruarit në njeriun që nuk dua të jem. Në jetë ka gjithnjë një njeri që jam, një që dua të jem dhe lufoj për të dhe njeriu që kam nuk dua të jem. Ky më tremb.

F.N:Si do ta komentoje,"Sa më shumë kalojnë vitet, aq më inteligjentë më duken prindërit"?

E.H: Sipas modelit dhe vlerësimit të Mark Twain, sa më shume rritemi aq më shumë vlerësojmë prindërit. Kjo ka të bëjë me fazat e moshimit. Kalimi në moshën e rritur (pra në rini dhe më pas) njeriu i afrohet normalitetit dhe largohet nga aventurat. Në këtë pikpamje fillon dhe vlerëson me shumë prindërit.

F.N:Cila është fuqia që ju ke? Në fakt çfarë fuqie do të donit të kishe?

cyan magenta yelloë black

I jam gëzuar gjithmonë mundësisë për të qenë e lirë. Kam luftuar për këtë. Them se në pjesën më të mirë të jetës kam qenë njeri i lirë dhe në raporte të mira me lirinë. Nuk kam abuzuar me të, nuk e kam luftuar, por e kam gëzuar.

Edlira Haxhiymerit

Ka qenë ëndërr e imja të kontribuoja për një politikë më të mirë në shërbim të qytetarëve. Por politika shqiptare nuk është për idealistët. Fatkeqësisht politika shqiptare ka provuar që të jetë vendi perfekt për njerëzit e vesit.



E.H:Fuqinë time e kam lidhur gjithmonë me personalitetin. Kam besuar dhe vlerësuar atë që jam dhe kam. Jam mësuar të vlerësoj arritjet e mija. Kjo më ka dhënë fuqi. Nuk e di se çfarë fuqie do të desha të kisha, mbase fuqinë për të bërë ndryshime të qënësishme përtej vetes.

F.N:Në se do të merrje vesh se do të vdisje brenda një viti, si do ta organizoje jetën tënde?

E.H: Paradoksalisht e kam bërë një gjë të tillë. Kam planifikuar të nxjerr nga duart 2-3 libra për studentë që i kam të pambyllur. Asgjë tjetër nuk do ndryshoja. Do vazhdoja ta jetoja çdo ditë me bukurinë dhe kënaqësinë që të jep dita që të fal Zoti!

F.N:Pse ke zgjedhur modele, apo personazhe në jetën tënde, çfarë të ka shtyrë? Në se do të darkoje me të për çfarë do ta pyesje dhe si do të ishte sjellja juaj?

E.H:Në fakt unë nuk kam pasur një model të vetëm në jetën time. Jam përpjekur të modeloj nga shumë personazhe të jetës sime. Ato më kanë shërbyer për të ndërtuar një personalitet të suksesshëm, të fortë, sfidues. Si të kapërcej sfidën e rradhës. Sjellja ime, krejt e zakonshme. Një dëgjuese e mirë dhe një mike e kujdesshme.

F.N:Keni një proverb tuajin të preferuar, po për çfarë ju shërben?

E.H:"Bëj si bën një mirë dhe jo si bën një i keq" dhe "Krimbi te plehu të çon". Janë dy shprehja që i kam dëgjuar shpesh nga gjyshet dhe i ruaj si vlera për të modeluar sjellje dhe qëndrime pozitive.

F.N:Thonë që kur të pëlqen puna që bën, çdo ditë ngjan si të ishte pushim. A është e vërtetë? Si dhe ku i organizon pushimet e tua ideale?

E.H:Në fakt, kjo është e vërtetë për mua. Nuk më ka lodhur kurrë puna. Madje shpesh bëjmë humor me koleget se edhe kur jam e sëmurë, në auditor harrohem. Pushimet e mia ideale, në det, si peshk dhe në mal si adhuruese e lartësive.

F.N:Cilat janë marrëdhëniet e tua me blerjet? Po nëse do mund të blesh vetëm një gjë, çfarë do të zgjidhje të blije?

E.H:Hmmmmm. Me kalimin e viteve, shtoheshka oreksi. Më pëlqen të blej një gjë, por cilësore. Nuk blej sasira. Zgjedh shumë. Nuk jam blerëse e mirë se nuk vendos lehtë. Po kur blej. Blej. Më pëlqen të blej gjëra që i rezistojnë kohës.

F.N:Po raportet tuaja me gjërat e reja…Në se do të mund të mësoje diçka të re, cilën do të zgjidhje?

E.H:Më pëlqejnë gjërat e reja. Guxoj deri diku edhe të provoj. Mbas biçikletës, makinës, mbase të ngas motorrin, por jo anijen.....

F.N:Ndër të tjera libri është një tru që flet, një mik që pret, një shpirt që fal, një zemër që qan. Çfarë lidhje ke me librat dhe cili është vendi qe ka zënë në jetën tënde.

E.H:Libri ka qenë dhe mbetet miku im më i mirë. Më ka shoqëruar në ditë të mira e jo të mira. Për fatin tim të mirë ose të keq, kam lexuar më shumë libra profesionalë, por nuk humbas asnjë minutë kohë të lirë për të lexuar letërsi artistike. Ajo më qetëson, më zbut, më sjell në vete.

F.N:Mund të gjykojmë një njeri nga mënyra se si trajton kafshët? Cilët është lidhja që ke me kafshët?

E.H:Natyrisht që mund të gjykohet. Raporti me kafshët është shumë domethënës për natyrën njerëzore. Unë vetë jam shumë e kujdesshme me kafshët. Por nuk kam arritur deri tek bashkëjetesa me to.

F.N: Po raporti që ke me trupin tënd… Cila është pjesa e trupit të pëlqen më shumë dhe pse?

E.H:Mmmm, më ka pëlqyer gjithmonë trupi im. Jam ndjerë mirë me të pavarësisht se pak e shkurtër, pak e shëndoshë, pak... por kam qenë gjithnjë e kënaqur me veten. Pjesa që më pëlqen më shumë: koka. Prej saj buron gjithë sjellja, reagimi, komunikimi im.

F.N:Bota është një libër, dhe ata që nuk udhëtojnë lexojnë vetëm një faqe. Cili është raporti që keni me udhëtimin?

E.H:Udhëtimet janë oksigjeni im. Ato më japin jetë. Pa udhëtime unë jam askushi. Një udhëtim në muaj, është domosdoshmëri për mua. Kur nuk mundem larg, edhe një udhëtim diku afër, më mjafton.

F.N: Në cilin vend të botës do të pëlqente të jetoje?

E.H: Do të dëshiroja të udhëtoja në çdo cep të botës, por do të desha të jetoja vetëm në Shqipëri. Ka qenë zgjedhja ime edhe kur bashkëmoshatarët e mi dhe jo vetëm rendën të largoheshin nga ky vend. Natyrisht Shqipëria është më e varfër pa ata, por unë nuk do ta bëja dot. E kam provuar, por nuk i kam rezistuar dot mallit.

F.N:Liria … cila është përballja juaj me të, si ka qënë raporti me lirinë në jetë, sa e leni luftuar dhe sa e keni dashur?

E.H:Sa më shumë kalojnë vitet, aq më shumë e vlerësoj dhe dëshiroj atë. I jam gëzuar gjithmonë mundësisë për të qenë e lirë. Kam luftuar për këtë. Them se në pjesën më të mirë të jetës kam qenë njeri i lirë dhe në raporte të mira me lirinë. Nuk kam abuzuar me të, nuk e kam luftuar, por e kam gëzuar.

F.N: Cili është ndryshimi që ka mes bashkëshortes dhe të dashurës? Mendon se ekziston dashuria e përjetshme? Si mund të shpëtohet dashuria?

E.H:Bashkëshorit/bashkëshortja është jë nga të dashurat/të dashurit. Për mendimin tim që të kesh dikë bashkëshort/bashkëshorte duhet ta duash. Por që ta duash, nuk do të thotë që patjetër ta bësh bashkëshort/bashkëshorte. Unë besoj në dashurinë e përjetshme. Dashuria mund të ruhet dhe shpëtohet duke u kujdesur për ditë për të. Ajo nuk vetë ekziston. Duhet të kujdesemi për të si për një fëmijë, një lule apo diçka të çmuar.

F.N:Çfarë është vlerësimi shoqëror dhe familjar për ty? Deri kur do të vazhdojë të ketë vlerë?

E.H:Njeriu merr vlerë në raportet mes shoqërisë dhe njërëzve të tij të afërt. Vlerësimi që merr prejt tyre është karburanti ynë. Pa këtë vlerësim ne do të ishim pa drejtim, pa orientim në jetën tonë. Përsa kohë ne jetojmë në shoqëri, të rrethuar nga miq e të afërm, për aq kohë vlerësimi i tyre do të jetë i rëndësishëm për ne.

F.N:Kur një person hedh argument kundër ideve të tua, preferon të mbetesh i heshtur duke ditur se ke të drejtë, apo mendon së është më mirë të tregosh të "vërtetën"?

E.H:Në fakt, jeta më ka mësuar shumë për një rrethanë të tillë. Por edhe profesioni më ka ndihmuar. Kur kuptoj qe njeriu që kam përballë nuk e njeh debatin, diskutimin, tërhiqem në pozicionin tim pa u lodhur pa fund të argumentoj.

F.N: Thuhet që asgjë nuk është perfekte … Çdo ndodhte sikur të ishte?

E.H:Do ishim të rrethuar nga monotonia. Ne na mban gjallë, na motivon ideja për t'i bërë gjërat më të mira.

F.N:Në të mirë dhe në të keq, një mik i vërtetë, është gjëja më e mirë në këtë botë, çfarë është një mik-mikëshë për ju?

E.H:Një thesar. Viti i fundit, vecanërisht, më ka stërprovuar, se asgjë nuk vlen më shumë se miqtë në këtë jetë. Unë ndjehem e pasur dhe me fat sepse kam shumë miq e mikesha.

F.N:Cila ka qenë detyra më e mërzitshme që të ka takuar të bësh?

E.H:Detyra administrative.

F.N:Një punë juaj më e fundit, cilat qenë arritjet më të rëndësishme?

E.H:I jam gëzuar mësimdhënies, studimeve, botimeve por në mënyrë të vecantë të qënit pjesë e rrjeteve rajonale dhe botërore të fushës sime të studimeve.

F.N:Çfarë projektesh apo ide kanë lindur nga ty dhe sa janë realizuar falë teje?

E.H: Kam luftuar dhe vazhdoj të jem këmbëngukëse në sigurimin dhe mbrojtjen e të drejtave të grave në këtë vend. I kam dhënë jetë shumë nismave në dokumente politike, ligjore dhe shërbime direkte.

F.N:Tranzicioni shqiptar është përballje e vlerave të shoqërisë shqiptare apo e politikës së prodhuar nga qeveritë e saj?

E.H:Tranzicioni është një proces shumë kompleks që i përfshin të tëra, edhe vlerat e shoqërisë, edhe ato të politikës së prodhura nga klasa politike e këtij vendi.

F.N:Jeta jote përballë politikës… cili është vlerësimi yt për politikën shqiptare?

E.H:Ka qenë ëndërr e imja të kontribuoja për një politikë më të mirë në shërbim të qytetarëve. Por politika shqiptare nuk është për idealistët. Fatkeqësisht politika shqiptare ka provuar që të jetë vendi perfekt për njerëzit e vesit.

F.N:Çfarë është Shqipëria për ty?

E.H:Vendi ku më ka rënë koka.... Vendi i të parëve dhe shpresoj edhe i pasardhësve të mi...

F.N:Sa është përputhur profesioni që ke imagjinuar në fëmijëri me profesionin qe ke sot?

E.H:Në mënyrë përfekte. E kam ëndërruar gjithnjë veten që kur isha fëmi si mjeke, mësuese, drejtuese. E kam realizuar plotësisht ëndërrën time.

F.N: Sa e lumtur je sot dhe si e përjeton profesionin tënd?

E.H:Shumë e lumtur. Sikur Zoti të më jepte shëndet, do të vazhdoja ta gëzoja profesionin tim si deri më sot.

F.N:Do të preferoje të udhëtoje në të shkuarën apo në të ardhmen e vendit ku jeton?

E.H:Jo. Më mjafton e tashmja.

F.N:Për ty çfarë do të thotë një jetë perfekte?

E.H:Jeta perfekte për mua është jeta që me jep motiv për të vazhduar e për të jetuar çdo ditë me pasion, energji dhe dashuri.

F.N:Sa e vërtetë, ke qenë në këtë intervistë?

E.H: Edlira dhe vetëm Edlira

cyan magenta yelloë black

Rruga e Arbërit nr. 189

studim

Konferenca shkencore

"Shfrytëzimi i burimeve energjitike dhe minerare në gjeografinë shqiptare në dobi të vendit"

Më 21 maj 2022 në Prishtinë u mbajt Konferenca Shkencore "Shfrytëzimi i burimeve energjitike dhe minerare në gjeografinë shqiptare në dobi të vendit ".

Nisiatorët dhe organizatorët kryesorë të kësaj konference ishin: Inxh. A. Begolli e Inxh. Xh.Murseli (Gjermani), Prof.Asoc.Dr. V.Kici (Canada), Prof. Sh.Këlmendi, Prof. Asoc. Dr. R.Zeqiri, Inxh. I.Macaj (USA), Inxh. A. Thaçi dhe Inxh. N.Berisha.

Në këtë konferencë u referuan disa kumtesa për mineralet energjetike të naftës e gazit dhe qymyreve, për burimet ujore dhe hidroçentralet, për mineralet e plumb-zinkut, kromit, mineraleve të dobishëm metalorë e jo metalorë, etj. si një pasuri e madhe kombëtare, të përhapura në mbarë trojet shqiptare, e cila duhet vënë në shërbim të mirëqenjes dhe begatisë së popullit shqiptar.

Në konferencë u mbajtën disa kumtesa nga studjuesit shqiptarë të Kosovës e Shqipërisë: Prof.Sh.Këlmendi, Prof.R.Zeqiri (Kosovë), Prof.V.Kici e Prof. Ç.Xhufi (Canada), Inxh.A.Begolli e Xh.Murseli (Gjermani), Inxh.I.Begolli, Inxh.R.Osmani (Kosovë), Prof.H.Shehu e Inxh.I.Mancaj (USA), Prof.J.Hanxhari, Prof.A.Serjani, Prof. B.Lleshi, Dr.Inxh. I. Tushe e Inxh. M.Pepkola (Tiranë) dhe Mr.Sci.Xh.Zengo (Maqedoni).

Në konferencë u tërhoq vemendja se megjithëse trojet shqiptare janë shumë të pasura me naftë e gaz dhe minerale të tjerë matalorë e jo metalorë, burime ujore e hidroçentrale,etj. shumica e tyre u janë shitur biznesmenëvë të huaj dhe vendet tona megjithëse kanë pasuri nëntokësore e mbitokësore shumë të pasura vazhdojmë të jenë vendet më të varfëra në Europë. Mjafton të përmendim faktin se deri në fillim të viteve nëntëdhjetë, vetëm nafta dhe kromi jepnin rreth 70% të të ardhurave kombëtare të Shqipërisë, ka vite që në buxhetin e shtetit futen shumë pak ose aspak të ardhura nga këto pasuri.

Në kumtesat e tyre studjuesit shqiptarë të Kosovës dhe Shqipërisë evidentuan këto pasuri dhe bënë propozime konkrete për shfrytëzimin rracional të tyre, për ti vënë në shërbim të rritjes së mirëqenjes, në rradhë të parë të popullit shqiptar të dy vendeve tona.

Në përfundim të konferencës u përpilua një rezolutë ku u propozohet qeverive të Tiranës e Prishtinës që:

"Vendburimet e mineraleve strategjikë: Nafta e gazi (Shqipëri), Mineralet metalorë të Kromit, Bakrit, Ferro-Nikelit e Nikelit silikat, Plumb-Zink-Argjendit, Mineraleve të çmuar e radioaktivë (Shqipëri e Kosovë) dhe Qymyreve (Kosovë), Burimet e Ujit dhe Hidrocentralet (Shqipëri e Kosovë), të kthehen me ligj në pronë shtetërore dhe të shfrytëzohen me kriter për t'i vënë në shërbim të rritjes së mirëqënjes së mbarë popullit shqiptar".

Duke patur parasysh se vendi ynë, nuk është i pasur vetëm me naftë e gaz dhe minerale të dobishëm metalorë por edhe me mineralre të dobishme indistrialë (jo metalorë) që përbëjnë një pasuri të madhe kombëtare me shumë rëndësi për zhvillimin e ekonomisë së tregut, pro. Bashkim Lleshi e vlerësoi si shumë të rëndësishme këtë konferencë shkencore dhe mora pjesë duke paraqitur kumtesën "**Shkëmbinjtë dhe mineralet industrialë (jo metalorë) të Shqipërisë"**, të cilën po e paraqesim edhe për lexuesit të plotë.

Korr.Rr.A.

Në konferencë u tërhoq vemendja se megjithëse trojet shqiptare janë shumë të pasura me naftë e gaz dhe minerale të tjerë matalorë e jo metalorë, burime ujore e hidroçentrale,etj. shumica e tyre u janë shitur biznesmenëvë të huaj dhe vendet tona megjithëse kanë pasuri nëntokësore e mbitokësore shumë të pasura vazhdojmë të jenë vendet më të varfëra në Europë.

Shkëmbinjtë dhe mineralet



Nga Prof. dr. BASHKIM LLESHI

Albanidet bëjnë pjesë në sistemin e rrudhosur alpin në degëzimin e Dinarideve-Albanideve-Helenideve-Taurideve. Në Albanidet nga lindja në perëndim veçohen këto zona gjeotektonike: Zonat e Korabit, Mirditës, Apeve, Krastë-Cukalit, Krujës, Jonike dhe Sazanit.

Mbeshtetur në pozicionin që zenë Albanidet në brezin e rrudhosur Alpin dhe në volumin e madh të punimeve të kërkim-zbulimit të kryera në vitet 1950-2005 janë zbuluar dhjetëra vendburime të mineraleve të dobishme jo metalore (shkëmbinj dhe minerale industrialë) me rezerva të konsiderueshme që së bashku me vendburimet metalore dhe ato energjetike përbëjnë pasurinë minerale natyrore të Shqipërisë.

Krahas mineraleve metalorë, për ekonominë e tregut janë të dobishëm dhe shumë minerale jo metalore e shkëmbinj, të cilët quhen industrialë. Mineralet industrialë të njohur deri tani në Shqipëri arrijnë rreth 50. Me punimet dhe studimet gjeologjike për disa janë përcaktuar rezervat gjeologjike dhe janë kryer studime teknologjike të pasurimit, si për fosforitet, granitet etj.

Studime gjeologjike dhe punime kërkimi janë kryer për shkëmbinjtë dhe mineralet jo metalorë ofiolitikë si: olivinitet, xhamin vullkanik, magnezitet, baritet, feldshpatin, albitofiret, pirofilitet, talkun, fluoritin dhe shkëmbinjtë ofiolitikë bazaltikë, për shkëmbinjtë sedimentarë karbonatikë gëlqerorë, dolomite, mergele e trepele, gurët dekorativë karbonatikë e ofiolitikë, argjilat, kaolinat, gjips anhidritet, squfurin e kripërat, kuarcitet e rërat kuarcore, shkëmbinjtë copëzorë (inertet lumore), etj. (Lleshi B. Vaso P. Leka Gj. Boshnjaku B. Hoxha V. Gjoni V.etj. (2005) Për shumicën e këtyre mineraleve industrialë me punimet e kryera janë llogaritur dhe rezervat gjeologjike dhe industriale duke u bërë të gatëshme për tu vënë në shërbim të ekonomisë së tregut.

I. SHKËMBINJTË DHE MINERALET JO METALORË OFIOLITIKË

I.1 - Olivinitet - Janë të përhapur në masivët ultrabazikë kryesisht të brezit lindor dhe më pak në brezin perëndimor. Më i rëndësishmi është vendburimi (vb) i olivineteve Kalimash, Kukws. Mund të përdoren si materiale refraktare kur janë të freskët dhe MgO është nga 46-48 %, por mund të përdoren dhe si gurë dekorativë kur kanë bllokshmëri të mirë.

I.2 – Xhami vullkanik - Lokalizohet në kompleksin vullkanogjen të Mirditës Qëndrore kryesisht në pjesën perëndimore të malit të Munellës prej Mashtërkorit në jug, deri në Lak Roshi në veri. Në vb e Qafë Barit dhe Lumzi (Pukë) janë zbuluar disa trupa xhami vullkanik me trashësi nga disa metra deri në 20-40 m. Mund të përdoren me sukses si lëndë e parë në industrinë e çimentos dhe në prodhimin e perlitit teknik.

I.3 - Magnezitet- Janë zbuluar në shkëmbinjtë ultrabazikë të lidhura me peridotitet e serpentinizuara në disa masivë të vendit tonë. I vetmi vb me llogaritje rezervash, është ai i Gomsiqes si dhe janë gjetur disa shfaqje në rajonin e Pukës (Lovrushk e Korthpulë), Bulqizës (Shahinaj, Shëngjun e Luçanë), daljet në pellgun e Devollit, në Gramsh etj. të cilat përbëjnë fusha kërkimi për magnezitet.

I.4 - Granitet - Në Shqipëri njihen disa masivë e dalje të vogla graniti (Trokuzë, Lovrushk, Fierzë, Radomirë, Peladhi, etj.) ku deri më sot graniti i masivit të Lovrushkut përfaqëson një lëndë të parë minerale kuarc feldshpatike me fushë përdorimi në industrinë e qelqit dhe qeramikës. Me sukses mund të përdoren dhe si gurë dekorativë nga më të bukrit dhe më të fortit, kur formojnë blloqe të madhësisë mbi 1-2 m^3 dhe kanë rezerva të konsiderueshme, siç janë plagjiogranitet e Lak Roshit të zonës së Pukës. Para vitit 1990 është prodhuar një sasi e vogël graniti si dhe është ngritur një impjant përpunimi në Tiranë, i cili tani nuk funksionon.

I.5- Gurët dekorativë ofiolitikë - Janë të përhapur në zonën e Mirditës duke filluar nga Tropoja e Kukësi në veri, deri në Korçë e Kolonjë në jug (Shkupi D. Lleshi. B.etj. 1995, Lleshi B. 2010). Deri tani janë studjuar vb i oliviniteve Kalimash (Kukës), troktoliteve Shkopet (Mat) e Dragostun (Librazhd) dhe vazhdon puna kërkimore për disa shfaqje gurësh dekorative ofiolitikë të lidhur me shkëmbinjte troktolitë, piroksenitikë, plagjiogranitikë e dunitikë në rajonet e Tropojës, Pukës, Mirditës, Matit, Dibrës, Elbasanit, etj.

Gurët dekorativë ofiolitikë kanë veti dekorative shumë të mira dhe janë shumë të rezistueshëm për veshje e shtrim brenda dhe jashtë objekteve. Me troktolitet e Dragostunit (Librazhd) është veshur pjesa e poshtme e Muzeut Historik Kombëtar etj. Këto gurë dekorativë ofiolitikë të quajtur dhe gurët jeshilë janë shumë të preferuar për tu përdorur në ndërtim në kohën e sotme. Mbështetur në punimet e kërkim-zbulimit të kryera në vitet 1952-1995, në vitin 1995 u krye studimi përgjithësues për Gurët dekorativë të Shqipërisë (Shkupi D.Lleshi B.,etj) ku evidentohen mbi 50 vb gurësh dekorativë të lidhur me shkëmbinjtë karbonatike me afro 300 milion m^3 rezerva dhe mbi 20 vb gurësh dekorativë ofiolitikë me mbi 70 milion m^3 rezerva të cilat përbëjnë një pasuri kolosale që duhet të vihet në dispozicion të ekonomisë së tregut, për të plotësuar jo vetëm të gjitha nevojat e punës ndërtimore në vend, por edhe për eksport, për ti prerë plotësisht rrugën importit.

I.6 - Bazaltet - Janë të përhapur në zonën tektonike Mirdita nga veriu në rajonin e Kukësit (Vauspas-Kostur-Helshan), Pukë (Kabash, Fushë Arrëz, Lumbardhë, Gjegjan), Mirditë (Kaçinar, Spaç, Prosek, Bardhaj, Lëkundë, Rubik-Ungrenj) dhe Korçë e Kolonjë (Vithkuq-Lubonjë-Stratoberdhë). (Dobi A.Lleshi B.2001)

Mbeshtetur në treguesit fiziko-mekanikë e kimikë këto shkëmbinj janë të vetmit që plotësojnë kushtin teknik për t'u përdorur si lëndë inerte ofiolitike për bazamente aeroportesh, portesh, linjash hekurudhore, autostradash etj. duke zevendësuar plotësisht lëndën inerte të lumenjve dhe atë karbonatike që përdoret tani për tani, duke rendur pas fitimit në kurriz të cilësisë së infrastrukturës.

Në shkallë vendi rezervat e bazalteve i kalojnë mbi 1 miliard ton, por rëndësi e veçantë u duhet kushtuar studimit të shkëmbinjve bazaltikë afër rrugëve automobilistike dhe qendrave të mëdha urbane si ato të Rubikut etj. si dhe shkëmbinjve të tjerë magmatikë me karakteristika të ngjashme me bazaltet. Me rezervat e mëdha që kemi me lëndë bazaltike të shpërndara nga veriu në jug plotësohen jo vetëm kërkesat e brendëshme të vendit por shtohet dhe një zë i ri në eksport.

II. SHKËMBINJTË DHE MINERALET JO METALORE SEDIMENTARË

II.1- Gëlqerorët - Përfaqësojnë lëndë të para karbonate dhe magneziale të përhapur nga depozitimet më të vjetra, triasiko-jurasike deri në moshat më të reja, kretake dhe eocenike në formë masivësh, shtresash e brezash që ndiqen në shtrirje për disa kilometra të përhapur pothuajse në gjithë rrethet e vendit tonë nga Tropoja, Kukësi e Shkodra në veri, deri në Korçë, Kolonjë e Gjirokastër në jug. (Ostrosi B.Grazhdani A.Tërshana A.etj.1999)

Gëlqerorët me CaO mbi 50% për të cilët ka rezerva të mëdha në të gjithë Shqipërinë mund të përdoren me sukses në industrinë e çimentos, për prodhimin e gëlqeres si dhe duhet të zgjerohet prodhimi i inerteve karbonatike, prodhim i cili sapo ka filluar me disa impiante të ngritur këto vitet e fundit për nevojat e ndërtimit.

Prodhimi i inerteve karbonatike (rërë e granil karbonatik) duhet të zgjerohet sidomos për tu përdorur si lëndë e parë në ndërtim për llaçe e betone për ti zevendësuar në një perspektivë të afërt inertet lumore, shfrytëzimi intensiv i të cilave, tre dekadat e fundit ka çuar në prishjen e shtrateve të lumenjve, prishjen e pritave, gërryerjen e tokave arë, duke çuar në prishjen e ekuilibrave mjedisore të shtrateve të lumenjve afër qendrave të mëdha urbane, si në rrjedhjen e poshtëme të Drinit, Mat, Tërkuzë, Tiranë, Erzen, Shkumbin, Seman, Vjosë, etj. (Lleshi B.1999,2000,2002,2010).

II.2- Dolomitet - ashtu si gëlqerorët takohen bashkë me to, ose pranë tyre në formë shtresash, pakosh e brezash me përmasa të mëdha. Në vb e Dukatit (Vlorë) trashësia e pakos dolomitike arrin deri 400 m. me përmbajtje të MgO nga 18-21 %. Trupa dolomitike me përmbajtje mbi 18% MgO janë takuar dhe në rajonin e Borshit, Kurbinit (Milot, Gjonëm), Krujës (Kodra e Shulsit, Zall), etj.

Dolomitet kanë vlerë të veçantë si lëndë e parë zjarrduruse, me përdorim në industrinë e qelqit, atë kimike etj. Si gëlqerorët dhe dolomitet, të cilat kanë veti dekorative të mirë dhe bllokshmëri e veti fiziko-mekanike të pranueshme mund të përdoren me sukses dhe si gurë dekorative në fushën e ndërtimit. Në vitet 1950-1990 nga SHGJSH janë zbuluar edhe disa vendburime të vogla mergelesh dhe trepelesh.

Nga viti 1986 deri në vitin 1996 janë prodhuar mbi 25 milion ton gëlqerorë për nevojat e fabrikave të çimentos, për gëlqere, si flus në metalurgji, për themele e bazamente në ndërtim etj. Pas vitit 1991 prodhimi i organizuar u ndërpre dhe ka vazhduar me projekte të rregullta shfrytëzimi në karrierat e vendburimve Letaj, Zall e Picrragë, Kojlikë, Kakarriq, etj. për furnizimin me lëndë të parë të fabrikave të çimentos Elbasan, Fush Krujë, Thumanë, etj.

Vitet e fundit kanë filluar të hapen disa karriera gurësh gëlqerorë me liçensa nga disa firma private të cilat duhet të shtohen, por duhet të disiplinohet shfrytëzimi i këtyre lëndëve të para me projekte shfrytëzimi, për të shtuar sa më shumë prodhimin e tyre duke mos prishur mjedisin ashtu siç është vepruar sidomos në 10-15 vitet e para të demokracisë. (B.Lleshi 2010)

II.3 Gurët dekorative karbonatike – Janë të përhapur kryesisht në zonën e Korabit, në pjesët periferike të zonës Mirdita. Në zonën e Alpeve, Krasta-Cukali, Krujës dhe atë Jonike duke filluar nga Tropoja e Kukësi në veri, duke vazhduar në jug me Dibrën, Bulqizën, Matin, Librazhdin, Pogradecin, Korçën, Kolonjën dhe zonat Lezhë, Krujë, Tiranë, Elbasan, Lushnje, Vlorë, Tepelenë, Gjirokastër e Sarandë në jug.

- Me shkëmbinjtë karbonatikë të Trias-Jurës janë të lidhur shumica e vendburimeve dhe shfaqjeve dekorative të vendit si vendburimet e Muhurit, Gjurasit e Kovashicës në Dibër, Kolesjanit në Kukës, Qaf Shtamës në Mat, Mirakës e Dërstilës në Elbasan, Linit në Pogradec, Malit të Thatë në Devoll, disa shfaqje të rajoneve Shkodër, Malësi e Madhe, Tropojë etj.

- Me shkëmbinjtë karbonatikë të kretakut dhe kretë-paleogenit të përhapur në mbulesën kretake të zonës Mirdita dhe në zonën Kruja, janë të lidhur vendburimet e Lisit, shfaqjet e Qafë Kishës, Linosit e Burgajetit në Mat, Munellës (Pukë), Vithkuqit e Polenës (Korçë), Gërmenjit (Kolonjë), Milotit, Laçit e Gjonëmit (Kurbin) Mamurasit, Lumit të Drojës e Burizanës (Krujë), Zall Dajtit e Qaf Priskës (Tiranë).

pasuritë

Shkëmbinjtë dhe mineralet industrialë të zbuluar nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar përbëjnë një pasuri të madhe kombëtare e cila ka luajtur dhe do të luajë një rol të rëndësishëm për fuqizimin e ekonomisë.

industrialë jo metalorë të Shqipërisë

- Në zonën Krasta takojmë gëlqerorët pllakorë të Rasfikut (Mirditë), Nuajit e Fekenit Krujë e Tiranë, Malit të Rrasës (Elbasan) si dhe gëlqerorët konglomeratikë të Tepës (Shkodër) Treshit, Spitenit e Monatisë (Lezhë).

- Në zonën Jonike kemi gëlqerorët pllakorë të Zhitomit (Berat), Lazaratit, Derviçanit e Jergucatit (Gjirokastër), Muzinës, Shkallës e Sarandës (Sarandë), gëlqerorët porozë të Kosovës (Lushnje), Karaburunit (Vlorë), dolomitet e Borshit (Sarandë) etj. Me veti dekorative shumë të mira janë dhe gurët dekorativë konglomeratikë të Munellës (Pukë), Pretushës (Pogradec), Bitinckës e Trenit (Bilisht), etj.

Në vitet 1950-1990 janë bërë përpjekje relativisht të vogla në krahasim me pasuritë që ka vendi ynë me gurë dekorativë, duke përdorur gurët dekorativë të vendit për veshjen dhe shtrimin e disa ndërtesave kapitale, si Pallatit të Kulturës, Muzeut Historik, Hotel Tiranës, Muzeut të "Skenderbeut" në Krujë etj.


Për punën e pakët të kryer në vitet 1950-1990 për përdorimin e gurëve dekorativë të vendit mjafton të përmendim faktin që gjatë këtyre viteve ka funksionuar vetëm një minierë, ajo e Gurit te Kuq (Peshkopi), ndërsa karrierat e tjera si në Sarandë, Lushnje, Qafë Shtamë, Qafë Priskë, Kosovë të Lushnjes, etj. hapeshin vetëm kur ndërtohej ndonjë objekt i rëndësishëm dhe mbylleshin përsëri. Në vitin 1991 edhe e vetmja minierë që prodhonte blloqe mermeri, ajo e Gurit të kuq Muhur (Peshkopi) u mbyll, ndërsa sot funksionojnë disa karriera gurësh dekorativë karbonatikë masivë e pllakorë, gurësh ranorë masivë e pllakorë dhe gurësh dekorativë ofiolitikë në disa zona të vendit. *(Shkupi D.Lleshi B.etj.1995, Lleshi B.1996-2000,2010)*

II.4 - Argjilat - Janë ndër mineralet më të përhapur dhe me shumë vlerë për ekonominë e tregut, në disa degë të saj. Me punimet e kryera janë zbuluar dhe njihen disa lloje argjilash që sipas përbërjes, fushave të përdorimit etj. janë quajtur: argjilat bentonite (tip Prenjasi) me fushë përdorimi në naftë, argjilat e gresifikueshme (tip Alarupi) me fushë përdorimi në qeramikë, argjilat e bardha kaliumore (tip Tamare) me fusha përdorimi në porcelan, argjilat ngjyrosëse me fushë përdorimi në industrinë kimike dhe argjilat për qeramikën e trashë me përhapje sidomos në zonat fushore, bregdetare nga Shkodra, Lezha, Tirana, Durrësi, Kavaja, Lushnja, Fieri deri në Vlorë dhe në gropat e brendëshme, në Korçë, Burrel, Peshkopi etj. për t'u përdorur si lëndë e parë për prodhimin e tullave dhe tjegullave. *(Deda T.Vaso P.Serjani A. etj. 2000)*

Mbi bazën e rezervave të zbuluara në shumë objekte të vendit të cilat kalojnë mbi 260 milion ton, në shumë rrethe të vendit janë ngritur dhe kanë funksionuar disa fabrika për prodhimin e tullave në Tiranë, Vorë, Lushnje, Dibër, Korçë etj. të cilat pas vitit 1991 u mbyllën dhe kohët e fundit kanë filluar të ringrihen ashtu siç kanë funksionuar në Lushnje dhe në Vorë, me teknologji të përparuar për të plotësuar jo vetëm të gjitha nevojat e vendit për tulla e tjegulla, por dhe për të eksportuar, për t'i prerë rrugën importit.

II.5 - Fosforitet - Përhapjen më të madhe e kanë në shkëmbinjtë karbonatikë të zonës Jonike, në rajonet e Tepelenës (Gusmarit), Gjirokastrës (Fushë Bardha), Sarandës etj. duke zbuluar disa vendburime fosforitesh me një sasi të konsiderueshme rezervash, të cilat me pasurim mund të vihen në shërbim të ekonomisë së tregut kryesisht për prodhimin e plehrave fosfatikë. Para vitit 1990 janë shfrytëzuar sasira të vogla fosforitesh, kryesisht në vendburimet e Fushë Bardhës dhe Gusmarit, të cilat përpunoheshin në fabriken e pasurimit të fosforiteve Memaliaj dhe përdoreshin për prodhimin e plehrave fosfatike në Uzinën e superfosfatit Laç. Pas vitit 1991 prodhimi dhe përpunimi i tyre u ndërpre, por duhet të rifillojë në të ardhmen.

1I.6 - Gjipset dhe Anhidritet - Përfaqësojnë



Harta Tektonike e Shqipërisë

minerale me rëndësi të radhës së parë, si për rezervat e mëdha dhe për fushat e shumta të përdorimit ne vend dhe për eksport. Takohen në zonën tektonike të Korabit nga Ilixhat e Peshkopisë deri në Radomirë, në Ultësirën bregdetare nga Durrësi e Kavaja, në Fier e Vlorë, në zonën e Dumresë dhe në zonën Jonike (Kurvelesh etj.), gjatë disa prishjeve tërthore e gjatësore.

Në Mengaj, Sarandë dhe Korab takohet dhe lloji strukturor alabastër i punueshëm si gurë zbukurimi, ndërsa në Korab anhidridet, mbështetur në vetitë dekorative dhe vetitë fiziko-mekanike të mira duhet të vihen në perdorim si gurë dekorativë.

Në Korab dhe Dumre, Gjipset formojnë masivë të mëdhenj në të cilët duhet të ngrihet industria e përpunimit të tyre, për t'u vënë në shërbim të ekonomise së tregut, si për nevojat e vendit ashtu dhe për eksport.

Rezervat e zbuluara deri tani i kalojnë 85 milion ton me $CaSO_4 2H_2O$ = 88-98% ku deri tani janë shfrytezuar vetëm një sasi e vogël në afërsi të Vlorës për prodhimin e allçisë dhe çimentos dhe në afersi të Dumresë e Kavajës për çimento. Punime të kërkimit janë kryer edhe për Squfurin e Kërçishtit (Dibër) dhe bojrat e dheut në Dibër, Bulqizë, Shkodër, Pukë, Vlorë, Korçë, etj. *(Hoxha V.2005, Lleshi B.2010)*

II.7 - Kripa e Gurit - Takohet në rajonet e Kavajës (Mengaj, Tilje) dhe Sarandës (Dhrovjan). Me punimet e kryera janë zbuluar mbi 300 milion ton kripë guri me NaCl = 76-82%. Në Mengaj e Tilje (Kavajë), deri në vitin 1991 është shfrytëzuar një sasi e vogël nga këto rezerva, por pas vitit 1991 u ndërprenë punimet. Rezerva të mëdha janë llogaritur dhe në Dhrovjan (Sarandë) e diapirët e Dumresë e Kardhiqit që i kalojnë miliarda ton. Nevojat për kripë guri plotësohen dhe nga kriporet e detit sidomos ajo e Vlorës.

II.8 –Ranorët kuarcorë dhe kuarcitet - I takojmë kryesisht në pellgjet ë Tiranës dhe Devollit duke formuar shtresa me trashësi mbi 10 m. gjatësi qindra m. deri disa km., ndërsa në rajonet e Tropojës dhe Kukësit janë zbuluar dy vendburime kuarcitesh, Kërnajës dhe Kallabakut, etj. Përmbajtja e rërave kuarcore është mbi 80 % SiO_2, rreth 10 % Al_2O_3 dhe deri 1.5% Fe_2O_3, ku me një pasurim të thjeshtë mund të përdoren si lëndë e parë ndërtimi dhe në industrinë e qelqit, kurse kurcitet me përmbajtje mbi 95 % SiO_2 përdoren me sukses në industrine e qelqit, atë abrazive, fonderi etj.

II.9 – Inertet lumore – Janë studjuar pothuajse në të gjithë lumenjtë e Shqipërisë, duke llogaritur mbi 242 milion m^3 rezerva rëre dhe zhavori, të cilët duhen shfrytëzuar me projekte të rregullta e me kriter, për t'u përdorur në dobi të ekonomisë. (Lleshi B. Dhimitri A. 2004)

II.10-Shkëmbinjtë magmatikë, sedimentarë e metamorfikë, si lëndë e parë ndërtimi.

Gurët natyrorë të ndërtimit, të përhapur nga veriu në jug të Shqipërisë, Gurët natyror mbulesor (rrasat e gurit), të përhapur më shumë në Kukës, Dibër, Mirditë, Krujë, Tiranë, Elbasan, Skrapar, Gramsh, Korçë, Kolonjë, Përmet, Gjirokastër Delvinë, etj. Gurët natyrorë ranorë e gëlqerorë pllakorë, sidomos në rajonine Mokrës Pogradec, Berat, Skrapar, Tepelenë, Përmet, Gjirokastër, etj. Gurët natyrorë acid durues në ku hyjnë albitofiret e tufet në Juban e Gur të Zi Shkodër,ortofiri i Mirditës dhe kuarci i Çeravës Pogradec.

III. PËRFUNDIME

Shkëmbinjtë dhe mineralet industrialë të zbuluar nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar përbëjnë një pasuri të madhe kombëtare e cila ka luajtur dhe do të luajë një rol të rëndësishëm për fuqizimin e ekonomisë. Deri tani me studimet e punimet gjeologjike të kryera në shkallë vendi janë zbuluar:

Për lëndë të para industriale mbi 50 objekte oliviniti, magneziti, bariti, feldshpatesh, albitofiresh, xhami vullkanik, azbesti, pirofiliti, guri i talkut dhe fluorite, të cilat nuk janë vënë sa duhet në shërbim të ekonomisë.

Për lëndët e para kimike, mbi 12 vb fosforitesh, mbi 41 vb gjipsesh, anhidritesh, alabastri, kripërash e squfuri, mbi 23 objekte dhe shfaqje ngjyruesish mineralë (bojra dheu) me perspektivë të hapur, për shtimin e rezervave të tyre, të cilat deri tani ja në vënë shumë pak në shërbim të ekonomisë.

Për lëndë të para ndërimi, mbi 50 vb e shfaqje argjilash, kaolinash e tufesh të disa tipeve kaolinore, porcelanike, argjila për qeramikë, bentonite, mikore, hidromikore, karbonatike për çimento, tufe vullkanike etj. Një pjesë e tyre kanë gjetur përdorim në 27 fabrika tullash e tjegullash, tuba gres, në fabrika çimentosh për prodhim tullash refraktare (shamot), në porcelanikën artistike dhe komunitare, etj.

Mbi 190 vb dhe objekte gëlqerorësh, dolomitesh, mergelesh e trepelesh, travertinash dhe rërash e zhavoresh karbonatikë, të cilat janë përdorur në ndërtim dhe në degë të tjerë të industrisë e bujqësisë.

Rreth 90 vb dhe objekte gurësh dekorativë karbonatikë dhe ofiolitikë me perspektivë të hapur për shtimin e rezervave të tyre, të cilat nuk janë vënë sa duhet në shërbim të ekonomisë së tregut në sektorët e ndërtimit, etj. si dhe janë llogaritur mbi 1 miliard resurse bazaltesh e shkëmbinjsh bazaltikë në shumë rajone të vendit nga veriu në jug, dhe megjithëse janë lënda më e mirë cilësore në infrastrukturë për shtrime të autostradave, aeroporteve, porteve, etj. pak kanë filluar të futen në përdorim.

Mbi 30 vb dhe objekte kuarci, kuarcitesh, ranorësh dhe rërash kuarcore, të cilat janë përdorur në industrinë e qelqit dhe atë abrazive, mbi 52 objekte inertesh lumore (rërë e zhavore) dhe rërë e çakëll karbonatik, në lumejt afër qendrave të mëdha urbane, të cilat deri tani në shumë raste janë shfrytëzuar pa kriter, duke u shoqëruar me dëme të mëdha në mjedis dhe ekonomi.

Janë zbuluar qindra objekte shkëmbinjsh magmatikë, sedimentarë e metamorfikë, që përdoren si gurë natyrorë ndërtimi, gurë natyrorë mbulesorë (rrasa guri), kryesisht për mbulime çatishë, ranorë pllakorë e masivë, për ndërtime dhe si gurë dekorativë, gurë natyror acid durues, etj.

Me pasuritë e mëdha që kemi, me gëlqerorë e dolomite, gjipse e anhidrite, argjila e kaolina, gurë dekorativë karbonatikë, ranorë e ofiolitikë, bazalte, e shkëmbinj bazaltikë,etj. në çdo rreh duhet të hapen karriera për prodhimin e lëndëve të para për ndërtim e infrastrukturë, duke filluar nga inertet karbonatike, deri tek gurët dekorativë, duke ngritur fabrika të reja çimentosh, tullash e tjegullash, kombinate për përpunimin e gjipseve e anhidriteve për prodhimin e allçisë dhe çimentos së bardhë, etj. për të plotësuar jo vetëm nevojat e mëdha të sektorëve të ndërtimit, infrastrukturës dhe industrisë për këto lëndë të para minerale, por edhe për të dalë në eksport.

(Referimet e këtij studimi i gjeni në botimin online në: rrugaearberit.com)

Rruga e Arbërit nr. 189

përjetim

Dibra gjithnjë ka pasur mjekë të mirë.

A ka **heronj** dhe **heroizëm** sot **në jetën tonë?**

Nga **XHAFER MARTINI**



Heronjt i kemi të shpatës dhe të pushkës, të penës dhe të kulturës. Por, brezi im, kur shqipton fjalën "hero", ka parasysh vetëm të parët, se qemë mësuar dhe edukuar me ta, se jeta nën diktaturë e presupozonte flijimin. Mbas Luftës së Dytë Botërore, që shkaktoi kaq shumë vuajtje dhe fatkeqësi, humbje në njerëz, qëndrimi ndaj heronjve dhe heroizmit ka ndryshuar. Në antipod me patriotizmin e zhurmshëm, në disa qarqe intelektuale, nuk flitej më për heronj, por për njeriun e zakonshëm që don ta jetojë jetën dhe nuk e jep atë për asnjë ideal. Kjo është filozofia e ekzistencializmit, përfaqësuesi kryesor i të cilit ishte filozofi francez Zhan Pol Sartër (1905-1980). Por kur e pyetën Sartrin se ç'ishte ekzistencializmi, ai tha se nuk e dinte, se nuk ishte një filozofi që shpjegohej, por që jetohej. Kuptimi i kësaj përgjigjeje është pak a shumë ky: rëndësi ka të ekzistosh, të pohohesh si qenie dhe ta jetosh jetën sido që të të vijë. Kjo filozofi bie në kundërshtim me filozofinë totalitariste që e zëvendësonte individin me turmën amorfe. Kamy, një tjetër filozof ekzistencialist, në një bisedë me me Simonë de Bovuar, shkrimtare franceze, i tha asaj: "Ti dhe unë kemi të përbashkët faktin se, për ne, individët kanë më shumë rëndësi se çdo gjë tjetër. Preferojmë konkreten para abstraktes, njerëzit para doktrinave. Dhe miqësinë e vemë para politikës". Më thellë dhe më qartë këtë ide Kamy e shtjellon tek romani "Murtaja": "Unë jam ngopur duke parë njerëz që flijohen për idetë. Unë nuk i besoj më heroizmit, tani e di që heroizmi është diçka e lehtë, madje mësova se ishte një gjë vdekjeprurëse. Unë kërkoj që njerëzit të rrojnë dhe të vdesin për diçka që e duan me gjithë shpirt". Edhe Niçe i përbuzte sakrifikcat për kauzat: "Si?!- klithën i dëshpëruar ai. - Ia rritka vlerën një kauze fakti që dikush heq dorë nga jeta për të!?". Kjo është, si të thuash, pamja historike e çështjes së heronjve dhe heroizimit.

Sot në vendin tonë, shtypi dhe televizioni, fjalët dhe fjalimet, diskutimet dhe analizat, gjithçka që flitet e shkruhet, e godet njeriun me negativen, me atë që nuk duhet të ndodh, por që në jetën tonë është bërë përditshmëri. Njeriu i sotëm shqiptar nuk mendon më për heroizmin. Ai ka rënë aq poshtë moralisht sa kjo fjalë mund t'i duket poshtëruese, sepse kudo që nga kupola e shtetit e deri tek vjedhësi i pusetave, shikon vetëm hajdutë, kriminelë, të korruptuar, të degjeneruar, banda dhe banditë, shikon një kaos dhe neveri që ta bëjnë shpirtin katran të zi, shikon një varfëri ekstreme që e ul dhe e poshtron njeriun. Burimi i deheroizmit është varfëria.

Tani në vendin tonë e ka humbur kuptimin edhe fjala Atdhe. Kjo për faktin se atdheun na e poshtruan, na e vodhën. Ata që duhet ta mbronin, në rast nevoje, dhe ta ndërtonin e ta lulëzonin atë, po ikin jashtë atdheut. Po ikën brezi i ri se ka mbetur pa atdhe. Armiqtë më të egër të vendit tonë, këtë kanë dashur- zbrazjen e Shqipërisë dhe të Kosovës. Shkencëtarët dhe akademikët serbë kanë hartuar platforma afatgjata për t'ia arritur këtij qëllimi. Në kohën e jugosllavizmit të parët që pajiseshin me pasaporta dhe inkurajoheshin të largoheshin prej vendit të tyre, ishin kosovarët. Tito ishte arkitekti i zbrazjes së Kosovës nga banorët vendas.

Por, edhe pse ndodh kështu, jeta nuk zmbrapset, ajo ecën në rrjedhat e saj të zakonshme, zhvillohet dhe përtëritet, si një pemë në degët dhe trungun e të cilës sopata ka bërë kërdinë, por prapë ajo treshon filiza të rinj, mbyll plagët dhe bën përpjetë "për të pohuar qenien e saj".

Unë them që edhe sot, ka heronj dhe heroizma, por ato janë të pabujshëm, të një natyre tjetër, jo me krisma dhe me "urra", ku mes plumbave dhe flakëve prinin në ballë të shqiptarëve prijësit popullorë. Unë në këtë shkrim do të bëj fjalë për dy heronj dhe heroizmin të tyre, që përdorin një armë tjetër, të vogël, por shumë të efektshme siç është bisturia që shpëton jetën e njeriut. Ky shkrim është për dy mjekë të shquar, kardiokirurgë, në QSUT, Selman Dumani dhe Ermal Lika. Heroizmi i tyre është në përditshmëri, prandaj edhe nuk vihet re. Që në fillim dua të them se ata në jetën time të tanishme kanë dhënë një kontribut të barabartë; të barabarta i kanë nderimet dhe mirënjohjen. Nëse do të përmend pak më shumë Selman Dumanin, këtë do ta bëj se ai është dibran, dhe bën pjesë në krenarinë e popullit të kësaj krahine, të cilit i përkas edhe unë.

Kisha shumë vite që vuaja nga një sëmundje zemre: valvula e aortës nuk funksiononte mirë dhe për këtë arsye zemra nuk furnizohej me gjak. Nuk mund të mbushesha me frymë. Koronografia zbuloi që veç mosfunksionimit të valvulës kisha edhe bllokim të enëve të tjera të gjakut. Nuk kishte rrugë tjetër, veç ndërhyrjes kirurgjikale. Nuk desha të pajtohesha me këtë mendim. A kisha frikë? Patjetër që kisha. Mosha më detyronte të mendohesha mirë "për të hyrë nën thikë", siç shprehet populli. Vendosa të jetoja ashtu: të ecja fare pak, sa me dalë jashtë me këmbët e mia... Po laku në fyt vinte duke m'u shtrënguar. Unë, një tip shoqëror, që nuk mund të rrija pa shokë dhe pa miq, u mbylla në një lagje të veçuar, në "Astir", madje në një "oaz" të kësaj lagjeje ku nuk ka (sot për sot), më shumë se dhjetë pallate... Puna që bëja m'u mërzit, nuk më bëhej ta hapja laptopin. Madje nuk kisha dëshirë as të lexoja. Erdhi një çast që edhe nëpër shtëpi nuk mund të ecja pa m'u marrë fryma.

Kur u vendos që të operohesha, kjo gjë tani duhej bërë sa më shpejt. Sa më shumë kalonin ditët, aq më tepër stresohesha dhe dobësohesha, shpirtërisht dhe fizikisht, duke u bërë i papërshtashëm për t'u operuar. Tani duhej menduar për mjekun. Nuk mund ta lija veten në dorën e cilitdo. Na rekomanduan kardiokirurgun Ermal Lika. Unë e familjarët e mi u takuam me të në klinikën gjermane. Ermali ishte një burrë me shtat mesatar që po i afrohej gjysmës së moshës. Mjekra e zezë dhe e gjatë e tregonte pak më të moshuar. Vështrimin e kishte të butë dhe si ledhatar. Mjekrën nuk e kishte për modë, besonte në Zot dhe falej e lutej. Kjo më bëri t'i besoja atij njeriu. Por kërkimet për mjekë të tjerë vazhdonin. Në internet hasa në lajmin se mjeku i QSUT, Qendra Universitare "Nënë Tereza", kardiokirurgu Selman Dumani, kishte kryer një ndërhyrje kirurgjikale që bëhej për herë të parë në vendin tonë: ndërhyrje në valvulën e aortës së zemrës, në të cilën vendosi një protezë pa qepje. Operacioni u krye tek një 77 vjeçar dhe doli me sukses. Dija gjithashtu se ishte dibran. Kisha dëgjuar për të edhe nga burime të tjera, por operacioni tepër i vështirë që kishte kryer, sigurisht e rriste reputacionin e tij dhe e bënte shumë të kërkueshëm nga pacientët dhe familjarët e tyre. Organizuam një takim me të. Më priti para kabinetit të tij, kur ende nuk kisha zbritur nga karroca.

-Ah, profesor, profesor,- më tha duke mos e plotësuar fjalinë. Por unë e plotësova me mendjen time: "qenke katandisur në ditë të hallit...". I treguam se kishim pasur një pjekje edhe me kardiokirurgun Ermal Lika. Keni bërë shumë mirë, tha. Ne jemi shokë dhe miq dhe punojmë bashkë.

Doli që më njihte mirë: kur unë isha mësues në gjimnazin e Peshkopisë, ai ishte nxënës. Më tha se më njihte edhe si shkrimtar, disa libra të mi i kishte lexuar. Mbase kjo ishte thënie për politesë, sepse ai karakterizohej nga ëmbëlsia në të folur, por jo nga një ëmbëlsi veleritëse, e pasinqertë, por e zbuluar përmes strukturash morale të seriozitetit. Zbrita nga karroca dhe u futëm në kabinetin e tij. Me modesti dhe art më vuri në qendër të bisedës duke treguar jo vetëm respekt, por edhe përkushtim për të bërë ç'ishte e mundur për të më nxjerrë nga honi ku shpeshherë na lëshon sëmundja. Sytë e tij jashtëzakonisht shprehës më kontrollonin sikur po më vizitonin. Një mjek si ai më shumë se nga të gjitha aparaturat e analizat mëson nga pamja klinike e pacientit. Për disa çaste shikimin e

Dibra gjithnjë ka pasur mjekë të mirë. Meritojnë t'i përmendish të gjithë, por mjafton të kujtojmë disa prej tyre: Rrahim Gjika, Basri Neziri, Qemal Çadri, Ali Tonuzi, Tahir Alku, Ahmet Alliu, Ahmet Kamberi, Mehdi Cani, Irfan Jashari, Hysen Pasha, Vehbi Keta, Ramazan Buci, Ahmet Shahinaj, Filip Cfarku, Selami Nazifi, Sashenka Nazifi, Shpresa Topuzi, Bajram Ndreu, Haziz Ndregjoni e të tjerë e të tjerë.

ndalte tek barku im. Po të mos ishte i pajisur me taktin e nevojshëm, fryrjen e barkut, që, veç të tjerave, është një veprim kundërintelektual, do ta nxirrte si pengesë në operacion, se vërtet i tillë është. Ai këtë ma tha me shikimin e tij qortues. Me gojë tha tjetër gjë: "Profesor, të gjithave mund t'ua gjejmë anën, vetëm moshës nuk kemi çfarë t'i bëjmë". Kjo e lehtëson procesin, thashë unë, se, në fakt, e kam jetuar jetën. Tani luaj me qarin. Me atë mprehtësinë që e karakterizon e kuptoi se kisha dhënë aprovimin për operim jo vetëm me shkuarjen aty, por edhe me fjalët që thashë. Kuptonte hollë. Nuk u bisedua për garancira, për përqindje suksesesh e dështimesh, sepse këto dihen. Ka edhe prej atyre njerëzve, që, edhe pse i drejtohen kardiokirurgut, bëjnë fjalë për sigurira dhe garancira. Organizmi i njeriut është tepër i çuditshëm; edhe në një operacion fare të lehtë, përfundimi mund të jetë fatal, siç mund të jetë i suksesshëm në një operacion tepër të vështirë. Zoti para e kirurgu mbrapa, kjo ishte deviza e Selman Dumanit dhe e Ermal Likës. Kjo ishte edhe deviza ime dhe njerëzve të mi. Puna ishte të bëhej më e mira e mundshme.

Nuk më harrohet ajo natë kur u nisa për në sallën e urgjencave të kirurgjisë në spitalin "Nënë Tereza" . Aty më përgatitën për në sallën e reaminacionit (terapi intensive). Bënte një vapë e madhe, kishte shumë njerëz në sallë, kurse përjashta ishte mizëri. Mbas një ore u ndava me njerëzit e mi të dashur, dhe, hipur në karrocë, më çuan në reaminacion. E kisha përfytyruar ndryshe atë sallë, por ishte mjaft e zakonshme, me shumë të sëmurë. Më mbajtën tri ditë për të më bërë analizat që të "vinin në parametrat" e nevojshëm. Duhej të rrije vetëm në kokërr të shpinës. Mbas tri ditësh më zbritën në spitalin e kirurigjisë së përgjithshme, pas dy netësh aty, më çuan në spitalin e kirurgjisë së zemrës. Kushtet nuk ishin ato që duhej të ishin. Personeli shëndetësor, në krahasim me të shtruarit, ishte mjaft i kufizuar. Doktor Selmani dhe doktor Ermali e ndiqnin "ecurinë" time. Më në fund më caktuan ditën kur do të operohesha. Do të isha i pari në listën e asaj dite...

Në shtëpinë botuese M&B kisha dërguar qysh një muaj më parë librin "Pasqyra e thyer" me kujtimet që kisha nga disa personalitete të politikës, artit dhe të kulturës. I thashë Shaqir Skarrës që erdhi të më shikonte, t'i thoshte Bujarit që ta botonte para se të hyja në sallën e operacionit. Kjo ngutje kuptohej. Doja ta shikoja librin të botuar para se t'i nënshtrohesha ndërhyrjes. Frika nga vdekja na shtyn të nxitojmë. Po të mos ishte vdekja, punët do të zvarriteshin me sot, me nesër. Kur shkon në sallën e operacionit, qoftë edhe për një rast më të lehtë, nuk je i sigurtë se do "të ngjallesh" prapë. Procesi u përshpejtua dhe pesë kopje të librit më erdhën në kohë. Ishte botim me cilësi si të gjitha botimet e Bujarit.

Me shtatë shkurt, në mëngjes, aty rreth orës tetë, më vunë në karrocë për në sallën e operacionit. Ndërsa unë shkoja kat më kat me karrocë, nëpër ashensorë, dy doktorët, Selman Dumani dhe Ermal Lika, ia mbajtën shkallëve. U pamë në korridor, kur ata po ngjisnin shkallët. Më vështruan me një lloj ndjenje që ishte midis keqardhjes, shpresës dhe mallëngjimit njerëzor. Po vimë për ty, thonin shikmet e tyre dhe ashtu ishte...Kur jam nisur për në sallë, nuk e kisha aspak ndjenjën e frikës. Jo se jam trim, por ma hoqi "Zoti frikën", sikur thuhet. Vetëm kisha ftohtë...



Hë, se do të ngrohesh, më thanë infermieret dhe më hodhën sipër diçka si pelerinë të kaltër me të cilët mbulohen ata që do të operohen... Ajo linte zbuluar vetëm gjoksin...

Siç me thanë njerëzit e mi më vonë, operacioni kishte zgjatur pak më shumë se dy orë. Mobilizmi ishte total "që të mos u ngelesha në dorë". Çdo vonesë e panevojshme, mund të ishte fatale. Kur më doli narkoza, e pashë veten edhe një herë në sallën e reaminacionit...Tani e kisha dhjetë herë më vështirë sesa kur nuk isha i operuar...Se ç'kam hequr ato katër ditë që më kanë mbajtur aty, nuk dua as ta kujtoj...

Kur nga reaminacioni rashë në mjediset e spitalit kirurgjikal të zemrës, pashë se poshtë, në përfundim të shtyllës kurrizore, më ishte hapur një plagë. Qëndrimi në shpinë, se çdo qëndrim tjetër është i pamundur, ishte një gjë tepër e rëndë, me shumë dhimbje dhe lëngime. Në atë gjendje që isha, erdhën dhe më panë shokët, miqtë, kushërinjtë, si: Dilaver Laçi, Sali Koltraka, Ramazan Buci, Bujar Karoshi, Shaqir Skarra e të tjerë.

Kishte prej atyre që kishin ardhur për të më parë, por që qëndronin pas dere se nuk i lejonin. Kishte plot të tjerë që më merrnin në telefon. Osman Miha më ka marrë dhjetra herë. Shokët dhe miqtë ma lehtësonin gjendjen, megjithatë, vuajta shumë. Këtë e dinë vetëm ata që e kanë provuar...

Por unë nuk e kam qëllim të shkruaj për ato vuajtje që i kanë provuar të gjithë ata që janë operuar. Unë dua të tregoj për punën e mjekëve të shkëlqyer që kemi, sidomos për kardiokirurgë të mrekullueshëm, si Selman Dumani dhe Ermal Lika. Për Ermalin nuk e di, por Selman Dumani sikur ecte sipas asaj thënies. "Bëmë baba, të të ngjaj". Dibra gjithnjë ka pasur mjekë të mirë. Meritojnë t'i përmendish të gjithë, por mjafton të kujtojmë disa prej tyre: Rrahim Gjika, Basri Neziri, Qemal Çadri, Ali Tonuzi, Tahir Alku, Ahmet Alliu, Ahmet Kamberi, Mehdi Cani, Irfan Jashari, Hysen Pasha, Vehbi Keta, Ramazan Buci, Ahmet Shahinaj, Filip Cfarku, Selami Nazifi, Sashenka Nazifi, Shpresa Topuzi, Bajram Ndreu, Haziz Ndregjoni e të tjerë e të tjerë. Tani është Selman Dumani që ka bërë emër dhe është dalluar në Tiranë, ku ka "ujqër të mëdhenj". Selmani është elita. Atë e dalloi dhe e veçoi vetëm talenti dhe puna e përkushtuar dhe e jashtëzakonshme. Nuk kishte suport tjetër. Nëse një shekull e ca më parë Dibra kishte burra të përmedur si Elez Isufi, Selman Alia, Mersim Dema, strategë të luftërave popullore, tani Dibra ka një strateg të një lufte tjetër, të luftës me bisturi– Selman Dumanin. Ky nuk është më pak i lavdishëm se sa burrat e mëdhenj të Dibrës para një shekulli. Përmendja për cilësi të larta intelektuale është shumë më e rëndësishme se përmendja për trimëri...

Unë u jam shumë mirënjohës këtyre mjekëve që më kthyen prapë në jetë, tashmë me një shëndet të përmirësuar. Për mua kjo jetë pas operacionit është "Behari i vogël i një Forsajti" nëse dikush nga ju e ka lexuar Sagën e Forsajtëve të Gollsuorthit. Pushtetarët më të lartë të Dibrës, për shumë e shumë vjet, jo vetëm nuk më kanë vlerësuar, por më kanë luftuar, siç kam treguar me fakte tek libri im më i fundit: "Pasqyra e thyer". Por ja që del Selman Dumani që ua heq "vrugun" të gjithëve dhe kthen jetën jo vetëm njeriun, por edhe shkrimtarin duke

recensë

Rreth librit “Katër-Grykët e Dibrës: Vendlindja jonë” të autorit Qazim Prejsi

Gjurmë në ardhmëri


Nga **LLESH NDOJ**

Kur lexon librin e të nderuarit Qazim Prejsi, titulluar “Katër-Grykët e Dibrës, Vendlindja jonë” (vëllimi i parë dhe i dytë) vetvetiu lexuesit i lind pyetja: Ku e gjenë ky njeri gjithë këtë vullnet e përkushtim për të dokumentuar historinë e një zone që nga lashtësia e deri në ditët e sotme dhe cila është shtysa që e nxit në këtë ndërmarrje, satë vështirë, po aq edhe me përgjegjësi. Po të shtosh këtu edhe faktin se ai tashmë i ka kaluar të tetëdhjetë e gjashtat e se jeton me shumëhalle shëndetësore e familjare, pyetja e mësipërme merr përmasa akoma më të mëdha dhe bëhet një shtysë më tepër e nxitje qët’i lexosh librat e tij. Pa qenë dibranë e as katërgrykas, në përfundim të leximit të librit, them se ndjehesh plotësisht i tillë, po aq edhe krenar për atë vend me histori e ngjarje të lavdishme dhe më i plotësuar në vetvete, pasi ke njohur një pjesë të rëndësishme të atdheut. Mund të them me plot gojën se leximi i këtij libri në dy vëllime, personalisht më ka dhuruar kënaqësi e më ka shtuar respektin për autorin e tyre, po e po, por edhe për të gjithë atë zonë krenare, dhe gjatë këtij leximi kam arritur edhe të kem një përgjigje lidhur me pyetjen e sipërshtruar: Një njeri i përgjegjshëm e që ka kryer në jetë detyra të rëndësishme, nuk mund të qëndrojë pasiv e ta mbyll jetën e tij pa lenë gjurmë për vendin e vet. Ai është produkt edhe i asaj historie e duhet t’i kthejë asaj një pjesëtë detyrimit që i ka, në atë formë e mundësi që secili mund ta bëj.

Kur po përgatisja librin tim “Domgjoni-Në dokumente, gojëdhëna e histori” e ndjeva thellë mungesën e dokumenteve të shkruara për atëfshat, gjithashtu me histori të lashtë, e kjo ma përforcoi besimin e vetdetyrimin për të hedhur “hapin e parë”. Edhe nga libri i Qazimit (pjesa e parë) mësova shumë.Aty me fakte e me rreshtim breznish, disa fise, sipas Qazimit, vinin nga Domgjoni im.Përgjegjshmëria për të lenë gjurmë në ardhmëri, është edhe sforcoja që studjuesi Qazim ka bërë dhe ka arritur në materialin që ne kemi në dorë, mjaft voluminoz, cilësor e i argumentuar logjikisht, me njohje personale, gojëdhëna e dokumente. Shumë nga ato që pasqyrohen në pjesën e dytë të librit, e cila përfshinë periudhën 1939-1990, janë ngjarje të jetuara nga vetë autori, gjë që ua shton atyre peshën e rëndësinë. Shtuar këtu edhe faktin se Qazimi ka një rrëfim të kandshëm, të thjeshtë e shumë realist, pa zbukurime e dredhime tëkota, i gjithë materiali merr vlera autentike.

Pa synuar të bëj një përshkrim të plotë të librit të Qazimit, mund të rendis disa nga vlerat e tij, vlera që janë për t’u çmuar sot, por që në një të ardhme do të konsiderohen shumëmë të çmueshme e me to do të ndodh si me venën:Sa më e vjetër, aq më e kandshme bëhet!

- Libri “Katër-Grykët e Dibrës, Vendlindja jonë” sjell thuajse të plotë e në mënyrë shteruese historinë e kësaj zone që nga lashtësia e deri në ditët e sotme (viti 1990). Pesha e një libri të tillë shtohet edhe për faktin se historia po përsëritet, fatkeqësisht në kahjen e dhimbshme ku shumë nga këto zona, përfshirë edhe Katër Grykët e Dibrës, po boshatisen e në një ditë jo fort të largë, me këtë trend të kohës, do të mbeten pa frymë. Ndërsa për popullimin e tyre Qazimi nuk gjeti thuajse asgjë të shkruar, por mblodhi gjithshka të vyer e të trashëguar gojarisht apo të treguar si histori, brezat e ardhshëm e gjejnë atë



Dibra njihet si vendi i kuvendeve, e autori ka sjellë në vëmendje të lexuesve disa prej tyre si Kuvendi i Bruçit që e cilëson “si më unikali i asaj kohe në shkallë kombëtare”, i cili u bajt me 26 korrik 1943 dhe ku katërgrykasit kishin kontribute të qënësishme; trajtohet mbledhja e Lurës e 23 gushtit 1943, roli i saj dhe lista me 61 pjesmarrës; po ashtu vihet në vëmendje pjesmarrja e katërgrykasve në luftë dhe heronjtë e saj, ku spikat një listë prej 107 partizanësh, ndarë sipas fshatrave; vend të veçantë zë përplasja mes forcave partizane dhe forcave kundërshtare në zonën e Katër Grykëve me 22 korrik 1944;

të shkruar bukur në pjesën e parë të librit; ndërsa pjesa e historisë së re (volume i dytë), natyrisht që ka shkrime të tjera (disa janë përdor edhe si referencë nga autori), por materiali i Qazimit, pa asnjë dyshim, është më i ploti e më i sistemuari i kësaj periudhe. Pemët gjenealogjike të mjaft familjeve të njohura të kësaj zone, hartuar nga vetë këto familje e të pasqyruara nga autori në libër, ndonëse siç e thekson edhe vetë autori nuk janë të plota e për të gjitha fiset, konsiderohen vlerë e kontribut i rëndësishëm.

- Nuk ka asnjë aspekt të jetës shoqërore, ekonomike, historike, arsimore e kulturore të kësaj zone që të mos e ketë rrok mendja dhe pena e autorit dhe ajo qëështë më e rëndësishmja, ai ka sjellë zhvillimet e kësaj zone pa u hallakatur në zhvillimet e përgjithshme lokale e kombëtare, pa i përjashtuar ato dhe duke bërë një raport mes tyre që lexuesi të mund të konkludoje më lehtë e më saktë rreth tyre. Në libër trajtohet pushtimi i vendit e largimi i Ahmet Zogut, çeta partizane e Dibrës, lufta çlirimtare e gjithë evenimentet e rëndësishme të saj në Dibër e Katër Grykët, duke u dhënë vendin e merituar edhe personazheve të kohës. Po ashtu, në libër gjejnë trajtim periudha pas çlirimit, kolektivizimi, ekonomia, lufta e klasave, arsimi, kultura, shëndetësia, e deri tek emigrimi i katërgrykasve në vitet nëntëdhjetë.I gjithë materiali voluminoz i këtij libri karakterizohet nga proporcionaliteti dhe rracionaliteti, i dukshëm ky së paku në dy aspekte thelbësore: Së pari, në raportin e përshkrimit të historisë e ngjarjeve të zonës e atyre rajonale e kombëtare. Autori i trajton historinë e ngjarjet e Katër Grykëve, pa asnjë dyshim në kuadër të ngjarjeve krahinore të Dibrës e Matit, por edhe të atyre kombëtare, duke u dhënë atyre përparësi në raport me to. Kjo e ka shmangur rrezikun që haset rëndom në libra të tillë kushtuar zonave apo fshatrave të veçantë kunë dhjetra apo qindra faqe historia e tyre, më së shumti, gjendet në kopertinë! Dhe aspekti i dytë: raporti autor-personazh-familje me të tërën. Autori është edhe pjesmarrës aktiv në ato që rrëfehen në libër; familja e tij është familje e njohur e me kontribute të vlerësueshme, por autori i ka trajtuar këto në proporcion me personazhet, familjet e kontributet e të gjithë zonës, duke shmangur rrezikun e shëndrrimit të librit në një libër autobiografik apo familjar.

- Autori mundohet dhe e arrinë të jetë “asnjanës” në trajtimin e materialit, duke synuar që ai të jetë plotësisht afër realitetit dhe i pranueshëm për të gjithë. Megjithëse vetë ka kryer detyra të rëndësishme gjatë jetës në atë zonë dhe jo vetëm, si agronom, kryetar kooperative, kuadër i rëndësishëm në Drejtorinë e Postë-Telekomunikacioneve Dibër, apo në Drejtorinë e Ujërave e Komitetin Ekzekutiv, autori trajton me objektivitet edhe gabimet e kohës e politikës që shkoi. Janë me shumë interes disa rrëfime origjinale në këtë libër (pjesa e dytë) si takimi me ish-kulakun e Lurës, Ternim Mena, rrëfimi se si i shpëtoi arrestimit Dali Gjoci, biseda me Ksenofon Nushin, asokohe zëvendësministër i jashtëm, në Lurë në vitin 1972; rasti kur vetë autori rrezikoi shumë vetëm pse u kishte dhënë bukë (jashtë rregullave të kohës, por me pagesë) disa banorëve të fshatit Lajthizë (tashmë me Oroshin e Mirditës) të cilët izoloheshin plotësisht nga dimri e nuk mund të komunikonin me pjesët e tjera të vendit për periudha të gjata, dhe mbrojtja që ata i bënë atij etj, janë jo vetëm origjinale, por edhe të rrëfyera bukur e me nje gjykim drejtpeshues të autorit. Autori nuk pajtohet me luftën klasore e cila goditi edhe zonën e tij, ashtu si edhe pjesët e tjera të Dibrës e të gjithë Shqipërisë. Ai e tipizon atë si “llava e luftës klasore”, duke bërë paralelizëm me llavën e një vullkani në zhvillim që fshin gjithshka i del përpara. Po ashtu, dënimet pa gjyq, sidomos në kohën e luftës, marrin vëmendjen e autorit dhe vijnë me një rrëfim të dhimshëm e realist. Përmend këtu rastin e Llesh Doçit, torturuar me urdhër të Hito Çakos e nxjerjen e tij para popullit pas 2-3 orësh, i cili, ashtu i dërmuar u len amanet atyre “...që do të mbeten gjallë... që të marrin hak”. Vend të posaçëm zë familja “Ndregjoni” apo dhe një rrëfim për “Hebrenjtë në fisin Ndregjoni të Lukanit”etj.

- Dibra njihet si vendi i kuvendeve, e autori ka sjellë në vëmendje të lexuesve disa prej tyre si Kuvendi i Bruçit që e cilëson “si më unikali i asaj kohe në shkallë kombëtare”, i cili u bajt me 26 korrik 1943 dhe ku katërgrykasit kishin kontribute të qënësishme; trajtohet mbledhja e Lurës e 23 gushtit 1943, roli i saj dhe lista me 61 pjesmarrës; po ashtu vihet në vëmendje pjesmarrja e katërgrykasve në luftë dhe heronjtë e saj, ku spikat një listë prej 107 partizanësh, ndarë sipas fshatrave; vend të veçantë zë përplasja mes forcave partizane dhe forcave kundërshtare në zonën e Katër Grykëve me 22 korrik 1944; trajtohet roli i posaçëm i Haxhi Lleshit në atë zonë dhe heronjtë e dëshmorët e saj; ashtu siç zenë vend më së miri edhe ngritja e pushtetit të ri në fund të luftës, roli i katërgrykasve e personazhet e periudhës që lanë gjurmët e tyre.

- Librit në fjalë, thuajse nuk i shpëton asgjë nga zhvillimet e personazhet e kësaj zone. Aty trajtohen me kujdes, me realizëm e me shumë respekt, por edhe me dashuri, thuajse çdo person që ka bërë emër e ka lenë gjurmë në përditshmërinë e zones apo ka kontribuar jashtë saj në fusha të ndryshme të zhvillimit ekonomiko-shoqëror që nga lashtësia e deri në ditët tona. Janë një numër i madh personazhesh të trajtuar nga autori në formën e portretit të veçantë, mbi 100 të tillë, krahas përmendjes së emrave e përshkrimeve të tyre në kapitujt përkatës, ku autori ndalet në veçantitë e kontributeve të secilit. Thuajse nuk ka familje katërgrykase që nuk përmendet në këtë libër.

- Autori nuk mungon t’u vej ngjarjeve emrin që kanë, duke mos anashkaluar asgjë. Kështu ai flet për përplasjen mes forcave partizane dhe fiseve Ndregjoni e Dervishi të Lukanit dhe e quan, as më pak e as më shumë se “genocid” veprimin e tyre ndaj fisit Dervishi, duke përshkruar torturat çnjerëzore ndaj disa prej pjestarëve tësaj, si Mal Dervishi të cilin, sipas autorit, e lidhën “me tela me gjemba dhe e tërhoqën zvarrë gjatë gjithë fshatit, për dy orë rresht, duke mbjell në popull tmerr e panik...”. Janë shumë burra me emër të kësaj zone, torturuar e pushkatuar pa gjyq, që vijnë në librin e Qazimit për të mos u harruar kurrë, por edhe si një “kujtesë kolektive” për eksperimentin e dështuar social të kohës së socializmit. Janë këto rrëfime e qëndrime edhe një vrasje ndërgjegje e thirrje për të gjithë ata që kanë punuar e drejtuar në atë kohë, ta rrëfejnë historinë e saj me realizëm, ashtu siç ishte, se kështu i bëjnë shërbim të sotmes e të nesërmes. Jo rrallë dëgjojmë nga personazhe të tillë se rrëfimete historisë nga ish të persekutuarit janë me mllef e ndonjë herë të tepruara! E si mundet të pritet një rrëfim i ekulibruar prej atyre që kanë vuajtur mbi kurriz peshën e një persekutimi deri në genocid ndaj vetes e familjes, kur një gjë të tillë nuk e bëjnë ata që kanë qenë kuadro e drejtues të kohës, të cilët, në shumicën e tyre absolute, nuk kanë ngjyer duart por i kanë shërbyer kohës duke besuar në të e duke kontribuar për t’i zbutur plagët e saj, siç ka bërëedhe autori i këtij libri në jo pak raste.

Mund të rreshtoja sa e sa momente kulmore nga libri i Qazimit, por nuk është qëllimi im një analizë shteruese e tij, analizë që jam i bindur do e bëjnë intelektual të tjerë të asaj zone, por thjesht të paraqes disa veçanti të autorit e të librit, si një nxitje për ta lexuar librin e si një falenderim për autorin që ka sakrifikuar kaq shumë për të na dhuruar ne një njohje e çasje realiste ndaj ngjarjeve historike në një zonë po ashtu historike.

Ky libër duhet të jetë pjesë e bibliotekës së çdo familje katërgrykase, duke e konsideruar atë “pasuri me vlerë” për t’ua trashëguar brezave. Sjell në këtë kontekst dy fjalë të një intelektuali të mirënjohur nga zona ime e Fanit në promovimin e librit tim “Fani dhe fanasit: Kështjellë e pamposhtur”, ku theksoi (perifrazoj): Kurrë s’u kam imponuar bijve të mi çfarë të lexojnë e çfarë të bëjnë, por këtë libër do t’ua imponoj!

Jetë të gjatë e shumë suksese autorit Qazim Prejsi.

A ka **heronj** dhe **heroizëm** sot **në jetën tonë?**

ia shtuar “lejen e krijimtarisë”. Se sa do të jetë kjo “leje”, e di vetëm Zoti. Por, meqë Selmani është dibran, unë mendoj se vendlindja e gjen mënyrën për të ndihmuar dhe për të vlerësuar atë që e meriton. Unë jam i gëzuar që këtë gjë e bëri për mua Selman Dumani. Partiakët dhe pushtetarët e Dibrës nuk do të më gëzonin me asgjë. Asgjë të mirë nuk prisja prej tyre. Në këtë gjendje të përmirësuar që jam sot, është lumturi të jetosh qoftë edhe pak muaj.

Përpara se të operohesha, jeta më ishte bërë tepër e vështirë dhe nuk më dhimbsej aq shumë. Ju flas me sinqeritet. Selmani dhe Ermali më dhanë një jetë të dytë dhe këtë nuk kam asnjë të drejtë ta shpërdoroj. Përpiqem të zbatoj çdo këshillë të tyre. Pothuaj jam bërë njeri tamam normal, duke humbur disa kile të tepërta. Normaliteti në këtë moshë qenka gjë shumë e bukur. Xholioni i Ri tek “Behari i një Forsajti”, ishte shumë më i ri se unë dhe ra në dashuri me Irenën. Jeta e tij mori kuptim nga lartësi të tjera. Unë për moshën që kam, duhet të kënaqem kur shikoj qoftë edhe një gjethe dafine kur e dridhën era. (Në lagjen time ka shumë dafina). Mua tani më gëzojnë më shumë takimet me shokë dhe me miq dhe, mbi të gjitha,më jep kënaqësi një mënyrë e re komunikimi, më e bukur, më njerëzore, pa asnjë fodullëk dhe mendjemadhësi. Jam krejt i zhveshur nga egoizmi i cili, sipas meje, është fatkeqësia e njeriut, pengesë e madhe për lumturinë e tij. Dëshira për të punuar më ka ardhur prapë. Në kompjuter ndosha rri më shumë se sa duhet. Pa shkuar një herë në grykë të varrit dhe pa kthyer prapë, nuk mund t’i kuptosh këto gjëra si duhet.

Janë me mijra njerëz si unë që duan t’u shprehin mirënjohje këtyre mjekëve të mrekullueshëm që kanë ardhur si një bekim dhe uratë nga Zoti për këtë popull të vuajtur dhe të braktisur në fatin e vet të keq...Operacioni im jashtë shtetit do të kryhej për mijëra dhe mijëra euro. Selmani dhe Ermali janë mjekët e të varfërve. Prandaj këtë shkrim nuk e bëj vetëm për vete- të shpreh nderimin dhe respektin tim,- por për të gjithë ata që nuk e kanë këtë mundësi. Do të kalojnë vite dhe këta mjekë brezat e ardhshëm do t’ingjisin në Panteonin e Lavdisë dhe të Dashurisë njerëzore...Nuk është përmendore prej mermeri, as prej ari, por prej një materiali më të çmuar: përmendore nga zemrat njerëzore, nga ato zemra që Selman Dumani e Ermal Lika kanë bërë që të mos e pushojnë rrahjen...Në këtë përmendore do të jetë dhe zemra ime...

(Vijon nga numri i kaluar)

Arsimi dibran “ç’ka qenë, ç’është dhe ç’do të bëhet”

Nga **MEZIN SHEHI**

Gjatë kësaj periudhe qeveria e Vlorës fillimisht u përpoq që të vendos baza ligjore për arsimin në gjuhën shqipe, duke e shpallur atë gjuhë zyrtare të shtetit shqipëtar, shkollës iu dha karakter shtetëror, gjithashtu bëri përpjekje për ta bërë arsimin fillor të detyrueshëm.

Është pikërisht kjo faze e cila spikat për hapjen e shkollave shqipe në Dibër tani më e ndarë në dy pjes. Me 14 prill 1914 Haki Sharofi ky veprimtar e patriot i pa lodhur hapi të parën shkollë shqipe në Peshkopi, një ditë më von u hap ajo e Trebishtit. Edhe gjat luftës së pare botrore shkollat dhe mësimi shqip në Dibër vazhdonte mes vështirësive të shumta e para nga gjendja e rëndë ekonomike e banorëve dhe e dyta nga lufta me pushtuesin serb që do zgjaste një dekad. Në këtë periudhë kemi shkollat shqipe në Dohoshisht 1915-1916, në Trojak e Sohodoll 1916-1917, Alllajbegi, Homesh e Sopot 1918, Okshtun, Sllovë, Lurë, Kala e Dodës Luzni 1922-1923, Internati i Kastrioti 1923, Herbel 1924, etj. Kemi kështu mbi 15 shkolla të hapura në këtë periudhë të dytë të zhvillimit të arsimit në Dibër edhe pse mes vështirësive të mëdha.

Faza apo periudha e tretë e zhvillimit të arsimit në Dibër përfshin vitet 1924-1944.

Në këtë periudh shkollat shqipe vazhdojn te hapen në menyrë progresive tani më me vendime ligjore dhe me parametrat qe duhet te ket një shkollë. Forcimi i shtetit shqiptar dhe ngritja ekonomike e vendit pas vitit 1925 ndikuan drejtpërdrejt në zhvillimin e mëtejshëm të jetës kulturore shqiptare si pas shembullit të vendeve europiane, ku ndikuan edhe proceset politike – shoqërore të diasporës shqiptare.

Gjatë viteve 1925 – 1939 u rrit më tej numri i shkollave, u forcua shkolla fillore, u krijua sistemi i plotë i arsimit (Internati Dibra dhe shkolla femërore plotësuan kuadrin e arsimit në Dibër). Rol të rëndësishëm luajtën figurat e shquara të shkollës shqipe në Dibër si: Haki Sharofi, Abdulla Çanga, Ferid Jegeni, Rifat Spahiu etj.

Në 1925 u hap Shkolla femërore po nga Haki Sharofi. 1927 u hap shkolla e Grevës dhe ajo 7-vjeçare e Peshkopisë. Pavarsisht hapjes së shkollave shqipe në vitet e Republikës dhe të mbretëris numri apo përqindja e të arsimuarve ngelet e ulët Mbi 80% e popullsisë ishte e pashkolluar dhe gjendja më e keqe ishte në fshatra ku mbizotëronte analfabetizmi. Edhe gjat luftës së dytë botërore arsimimi shqip vazhdoj pa ndërprerë mes vështirësive të skajshme deri në vitin 1944. Sipas statstikave pas luftës përqindja e popullsis që dinte shkrim e këndim ishte tepër i ulët rreth 20% , kjo është koha kur fillon edhe faza tjetër e zhvillimit të arsimit.

Faza apo periudha e katërt e zhvillimit të arsimit në Dibër janë vitet 1944-1990, (faza e përparimit dhe zhvillimit)

Pas përfundimit të Luftës së dytë botërore, në Shqipëri u bë «Reforma Arsimore e vitit 1946» e cila përcaktoi kohzëgjatjen e arsimit të përgjithshëm në 11 vite; arsimi fillor 4 vite, arsimi unik 3 vite dhe i mesëm 4 vite. Arsimi fillor dhe ai unik u bënë të detyrueshme. Prej vitit 1963, arsimi i detyrueshëm u ngrit nga 7 në 8 vjeçar dhe arsimi i mesëm nga 11 në 12 vjet. Kjo faze ka dy karakteristika kryesore:

1. Heqja e analfabetizmit.
2. Masivizimi i Arsimit.

FUSHATA KUNDER ANAFALBETIZMIT

Sipas regjistrimit të 30 shtatorit 1945, në një popullsi prej 1. 122. 044 banorë, numri i analfabetëve ishte 911. 410 banorë, ose 81. 22% e popullsisë. Në vitin 1945 ishin hapur 566 kurse ku mësonin për herë të parë shkrim e këndim 10. 243 vetë. Për këtë fushatë kundër analfabetizmit u punua kryesisht në rrugë vullnetare. Në vitin 1949 miratohet ligji për arsimin, sipas të cilit detyroheshin moshat deri në 40 vjeç të merrnin bazat e shkrimit dhe këndimit. Nga një regjistrim i këtij vitit (1949) rezultoi se pas 5 vjetësh kishin mësuar shkrim e këndim rreth 130. 000 vetë dhe kishin mbetur ende 420. 000 analfabetë. Në vitin 1955 u shpall publikisht se në Shqipëri ishte likuiduar analfabetizmi deri në moshën 40-vjeç. Por në bazë të të dhënave arkivore faktohet se një pjesë e popullsisë nuk arriti të mësonte shkrim e këndim, sidomos moshat e mëdha. Ky problem ka vazhduar edhe në vitet e mëvonshme, por lufta vijoi, në heshtje, jo e shpallur si fushatë.

Reformat thelbësore në arsimin fillor, përforcimi i shkollave të mesme profesionale, përmirësimi i notave në testimet ndërkombëtare, si dhe rikthimi i dinjitetit të mësuesit dhe motivimi i tyre personal. Këto janë parakushtet për një të ardhme të sigurt të arsimit.

NGRITJA E SHKOLLAVE

Arsimi fillor dhe 7 vjeçar

Në Shqipërinë e pas luftës, siç ndodhi në fusha të tjera, edhe në arsim u ndërmorën disa reforma. Hapi i parë në fushën e arsimit ishin kurset kundër analfabetizmit të cilat njohën një përhapje të gjerë në çdo cep të Shqipërisë nga 1945 deri ne 1949. Hallka më e zhvilluar në vitet e para të pasluftës ishte arsimi fillor. Në vitet ‘50 hapen shkollat e para 7-vjeçare. Prej vitit 1963, arsimi i detyrueshëm u ngrit nga 7 në 8 vjeçar.

Arsimi i mesëm

Sa i takon arsimit të mesëm ai u ngrit nga 11 në 12 vite. Në Dibër krahas të tjerave spikasin mbi të gjitha hapja e disa shkollave të mesme, Shkolla profesionale Nazmi Rushiti e cila u hap menjëherë pas lufte në 1945, dhe gjimnazi i Peshkopisë i cili çeli dyert ne 1962-1963. Jo më pak e rëndësishme ishte edhe shkolla Pedagogjike në 1948 nga ku dolën breza të tërë arsimtarësh dhe jo vetëm. Këto ishin simbole të zhvillimit të arsimit në Dibër që shënjuan këtë faze krahas hapjes së shkollave të tjera dhe shtrirjes së arsimit kudo, nga Lura në Maqellar dhe nga Selishta në Kala të Dodës.

REFORMAT DHE IDEOLOGJIZIMI I SHKOLLAVE

Pas Luftës, me vendosjen e regjimit komunist në Shqipëri, arsimi shqiptar mori një formë të re. Tashmë shkolla ishte e tipit socialist, që mbronte dhe brumoste një shoqëri socialiste. Si model, sidomos pas 1948-s, me prishjen e marrëdhënieve me Jugosllavinë, shkolla shqiptare u orientua nga shkolla ruse. Në vitet ‘60 shënohet reforma e dytë dhe në vitin 1963 del ligji i ri mbi riorganizimin e sistemit arsimor. Ligji parashikonte kalimin nga sistemi 7-vjeçar në sistemin 8-vjeçar. Kulmi arrin me reformën e tretë që u quajt “Revolucionarizimi i mëtejshëm i shkollës”, e nxitur që nga viti 1967 nën ndikimin e revolucionit kulturor kinez, pas një fjalimi të Enver Hoxhës për revolucionarizimin e shkollës. Ligji doli në fund të vitit 1969 dhe zbatimi filloi në vitin 1970 dhe vijoi deri me rënien e regjimit. Kjo reformë e tretë pati një ndikim të thellë në shkollë, e cila u ideologjizua në mënyrë të tejskajshme. U rrit shumë dhënia e lëndëve të drejtpërdrejta politike, si historia e Partisë, Marksizmi etj. Por ideologjizimi u thellua edhe në të gjithë lëndët e tjera duke depërtuar në çdo qelizë të shkollës. Letërsia dhe historia ishin dy nga lëndët ku ideologjia arriti kulmin. Veprimtaria e shkollës u organizua mbi bazën e atij parimi që u quajt trekëndëshi revolucionar që ishte: mësim, punë prodhuese dhe edukim fizik e ushtarak. Të gjithë programet dhe tekstet u realizuan mbi këtë trekëndësh. Kjo e dëmtoi shkollën sidomos ideoligjizimi i tejskajshëm sepse përgatiti një brez sipas modelit që regjimi e quante “Krijimi i njeriut të ri”.

Arsimi ç’është sot.

Realiteti i këtyre 30 e kusur viteve për fat të keq është disi i dhimbshëm, në se dikur kishte njerëz për t’u mësur por s’kishte shkolla, s’kishte mësues dhe nuk u lejohej të mësonin gjuhën amtare, sot ka shkolla dhe mësues por godinat e shkollave janë të zbrazura nga nxënësit, ka mësues por nuk kanë se kë të mësojnë. Lëvizjet demografike e kanë shpopulluar zonën e mrekullueshme të Dibrës. Numri i shkollave ka ardhur çdo vit duke u tkurrur. Kjo panoram është një trishtim i madh për zbrazëtin e zonës tonë jo vetëm nga nxënësit dhe nga të rijntë por nga vetë jeta. Këto vite tranzicioni të shoqëris shqiptare pa dyshm që kanë qenë edhe tranzicion për arsimin në përgjithësi dhe për atë dibran në veçanti, ku gjat viteve 1992-2006 janë mbyllur për shkak të rënies së nxënësve 12 shkolla të mesme. Tranzicioni kaotik i këtyre viteve është shoqëruar her pas here me hapjen dhe mbylljen e disa shkollave, ajo pedagogjike, profesionale në të cilën her pas her hapeshin e mbylleshin degë të ndryshme, apo deri tek hapja e një filiali të Universitetit të Durrësit dhe mbyllja e tijë që funksionoj nga 2009-2014. Akoma më e rëndë bëhet situata kur ndërkoh që eksodi i popullsisë vazhdon me ritme maramendëse, në disa zona periferike të Dibrës hapen disa gjimnaze pa asnjë lloj kriteri, të cilët u mbyllën shpejt për fat të mire. Në 2017 pati edhe një ndarje të gjimnazit historik të Peshkopis në mënyr absurde duke krijuar dy të tillë pa asnjë kriter.

Arsimi ç›do të bëhet

Për sa i përket të ardhmes është si të përpiqesh të shohësh një panoramë, një piktur që akoma nuk është nisur por mund ta imagjinosh, megjithëse shpesh është e panjohur. Gjithsesi e ardhmja që mund dhe duhet të projektojmë, supozimet, besimet, dijet e nënkuptuara dhe të heshtura, vlerat, shpresat dhe frikërat tona aktuale mund të na bëjnë të kemi më shumë pikëpyetje në lidhje me arsimin. Shumë ndër ne mund të paramendojmë se edhe pse akoma nuk jetojmë në një botë fluturake, zhvillimi i teknologjisë po e ndryshon thelbësisht jetën tonë dhe ska dyshym se ky zhvillim do vazhdoj me patjetër me ritme akoma më të shpejta, Ndaj në këtë kuptim krijimi i dijeve dhe njohurive të reja nuk ka qenë kurr më pare kaq premtues. Na del ne si detyrë t’u mësojmë brezave të rinj modelin e përshtatshmërisë dhe madje akoma më shumë të mësojnë të kuptojnë atë që do sjellë e ardhmja. Por nuk duhet asesi ti lëmë që të harojnë qëndrimet dhe vlerat kombëtare që na vijnë si shembull kuptimplotë në këto 108-vite të hapjes së shkollës së parë shqipe në Dibër e cila njëherazi na vjen si një zë nga e kaluara, si thirrje në kontekstet e reja kohore duke ushtruar presion dhe trysni mbi zhvillimin e arsimit në mënyrë që ai t’i pregatis si duhet brezat e rinj për botën reale dhe pse jo për të ardhmen, edhe pse hasim vazhdimisht në një rrezistencë të madhe ndaj ndryshimit që na vjen si inerci e të shkuarës.

E megjithatë brezat duhet dhe e kanë domosdoshmëri që të kenë sukses, për ta aritur këtë duhet të kemi një qasje krejt të re për arsimin një qasje dhe një zgjidhje që të jetë nga ana shkencore e qëndrueshme dhe e besueshme, nga ana praktike e kuptueshme dhe e zbatueshme, nga shoqëria e dëshirueshme dhe pranueshme.

Të gjithë jemi para një sfide të madhe çdo vit, dhe kjo është se si do të evuoloj arsimi i gjeneratës së ardhshme. Çdo mësimëdhënës, nxënës, student ka dëshira dhe mendime të veta personale se si duhet të jet e ardhmja e tijë dhe kjo është e kuptueshme dhe e arsyeshme por gjithashtu vështirë se ekziston një model ideal që garanton të ardhmen e sigurt. Përkundër faktit se ne punojmë në kushte të një krize të madhe, vëmendja jonë duhet të mbetet e përqendruar në ndërtimin e një sistemi modern arsimor. Sistem që do të krijojë gjenerata progresive në të ardhmen me qëllim për ta çuar vendin përpara. Prandaj, ata që janë në vijën e pare të arsimit mund dhe duhet të japin maksimumin në transferimin e njohurive të nxënësve.

Arsimimi ndryshon jetën e çdo personi, është baza për krijimin e mundësive dhe zhvillimit personal. Është e rëndësishme që fëmijët të shkojnë në shkollë në mënyrë që të marrin arsim e duhur, por njëkohësishtë është e rëndësishme që ata të mësojnë vlerat themelore të jetës. Fëmijët kanë nevojë për arsim cilësor që do t` i ndihmojë ata të arrijnë potencialin e tyre të plotë dhe të rrisin mundësitë për tu bërë të lumtur, të shëndetshëm, të suksesshëm dhe anëtarë të dobishëm të shoqërisë.

E ardhmja e çdo shoqërie varet nga fëmijët. Ata janë punëtorët e ardhshëm, prindërit, mësimëdhënësit, mjekët dhe politikanët. Nëse ne nuk u sigurojmë atyre bazë për jetë të shëndetshme dhe produktive sot, atëherë ne vëmë në rrezik të ardhmen, prosperitetin dhe sigurinë tonë. Kjo është arsyeja pse nuk duhet të presim. Ne nuk duhet ta lejojmë të humbim kot, asnjë orë të kohës së punës kushtuar arsimimit dhe edukimit të fëmijëve.

Unë besoj në barazi arsimore të çdo kujt pa asnjë dallim race, feje gjinie, të çdo vajze dhe djali kudo që jetojnë dhe mendoj që duhet të kenë të drejta të barabarat dhe qasje në arsim cilësor njëlloj. Reformat thelbësore në arsimin fillor, përforcimi i shkollave të mesme profesionale, përmirësimi i notave në testimet ndërkombëtare, si dhe rikthimi i dinjitetit të mësuesit dhe motivimi i tyre personal. Këto janë parakushtet për një të ardhme të sigurt të arsimit.

Literatura

1. Prof. asc. M. Kamberi: “Zhvillimet arsimore në Dibër”, revista Zani i Naltë, Tiranë 2014.
2. Xhemal Domi: “Dibra në hulli të Historisë”, Botimet M&B, Tiranë 2012
3. Moisi Murra: “Dibra nga antikiteti në monarki”, Botimet M&B, Tiranë 2017.
4. Fatos Daci: “Historia e arsimit shqip në Dibër”, Tiranë 2010
5. Historia e Shqipërisë: Akademia e Shkencave. Vëllimi II, Tiranë, 2002 (f. 173) dhe III
6. Kristo Frashëri: “Historia e Dibrës”, Botimet M&B, Tiranë 2012
7. Ilias Goga: ”Haki Sharofi, mësues atdhetar, veteran i shkollës shqipe”, grup autorësh “Haki. Sharofi dhe vepra e tij”, Tiranë 2000.
8. Haki Sharofi, “Historia e Dibrës”, vëll. II. Tiranë 2008.
9. Akte të Rilindjes Kombëtare Shqipëtare, 1878-1912, Tiranë, 1978.



Veçanti në ndarjet kanunore në Dibër

Nga **HAKI PËRNEZHA**
vijon

Lënda kanunore: *Një djalosh nga fshati G. N. kish marrë për nuse një vajzë nga një fshat fqinj. Disa muaj pas martesës, nusja e re, ikën me një djalosh tjetër nga zona me të cilën kufizohej Çidhna. Djaloshi nga Gryka po vëzhgonte situatën, nëse babai i ish gruas do ta bënte për bijë vajzën e tij apo jo. Për këtë arsye ai disa kohë po ruante nga larg lëvizjet tek shtëpia e ish mikut. Një pasdite ai dalloi nga larg një burrë e një grua që udhëtonin drejt shtëpisë së ish mikut. Ai njohu ish gruan e tij së cilës i printe një tjetër burrë. Shpejtë e shpejtë zgjodhi pozicionin dhe priti deri sa u afruan të dy, burri dhe gruaja. Ngadalë e me qetësi tërhoqi këmbëzën e armës. Gruaja ra e vdekur në tokë. Shpejt u kuptua që këtë vrasje e kish bërë gryknokasi. Babai i vajzës e mendoi gjatë këtë punë dhe vendosi të nxisë burrin e ri të vajzës të kërkonte gjak tek vrasësi. Pas pak ditësh një plak i dërguar nga familja e dëmtuar trokiti në shtëpinë e gryknokasit duke i thënë: " Kam një fjalë prej filanit nga fshati...-Më ke gjakun e fëmijës se gruaja ka qenë shtatzënë." Nuk shkoi shumë dhe një tjetër plak drejtohet shtëpisë që iu vra gruaja e cila ndodhej dy fshatra përtej krahinës së Çidhnës i cili i thotë: " Ke fjalë nga XY (djaloshi grykënokas) unë të kam vra por të vij në një të drejtë, kur dhe ku të duash ti." Ashtu u bë, secili zgjodhi plakun e vet. Pala e dëmtuar zgjodhi Lushën ndërsa gryknokasi mori Nokën. Lusha dhe Noka ishin të sprovuar në situata të tilla kanunore. Noka i dërgoi fjalë Lushës që këtë kanun do e ndajmë në kalë...Lusha menjëherë pranoi pasi, sipas së drejtës, ai duhej të fliste i pari dhe besonte se do ta "gozhdonte" Nokën. U caktua vendi, data dhe ora zhvillimit të "gjyqit".Tek Kroji i Madh në Çidhën do të mblidheshin dhjetra burra që do të ndiqnin "ndeshjen" në mes galdiatorve të së drejtës zakonore.* ***Stërpleqtë*** *(ndihmës gjyqtarët) e të dy pleqve ndërkohë filluan të merreshin me organizimin. Në çdo mexhelis nëpër gjithë krahinën filluan debatet, njerëzit hamendsonin se cili do të fitonte. Dikush thoshte Noka e kush Lusha. Interesi u rrit më shumë kur u muar vesh se ky kanun do të "ndahej" në kalë(!)... Dita e "gjyqit" erdhi shpejt. Në sheshin tek Kroi i Madh ishin ulur mbi 100 burra të cilët kishin ardhë nga të gjithë fshatrat e Çidhnës por edhe nga fshati fqinj i krahinës nga vinte personi që i ishte vrarë gruaja. Stërpleqtë u kujdesen që palët në konflikt të vendoseshin larg njëra tjetrës dhe të prisnin përfundimin e "gjyqit". Nga ana Shëmërtajthit në kodër dukej kali mbi të cilin qëndronte rëndë-* rëndë plaku i fisit Noka ndërsa në anën tjetër ndodhej plaku i Lushës në kalë. Që të dy përballë njëri tjetrit pas një shenje filluan të ecnin ngadalë - ngadalë dhe në kokë secili bluante zgjidhjen. Plaku i Lushës sipas së drejtës ishte në avantazh pasi i pari do të shtronte problemin. Ai prej kohësh e kishte përgatitur fjalinë «gozhduese» ndaj dhe priste momentin kur kuajt do ishin «kokë më kokë», përballë njëri tjetrit. Plaku i Nokës ishte mjaft i shqetësuar pasi duhej t›i përgjigjej kundërshtarit në një kohë mjaft të shkurtër. Mijëra variante i kishte çuar në mendje plaku i Nokës, por cila do të ishte «fjalia» e Lushës. Në raste të tilla, në «kanunin në kalë» koha e shkurtër të mundëson vetëm një fjali, nuk ka debate. Me një fjalë a fjali fiton ose humbet «gjyqin». Ndërkohë kuajt po afroheshin dhe plaku i Lushës me solemnitet i drejtohet Nokës: ***"-Pse ma derdhe drithin?"*** *Plaku i Nokës sapo iu përmend fjala "drith" menjëherë dhe falë përvojës së madhe në punët e kanunit i erdhi përgjigja e shumënjohur:* ***"-Mos e futje në thes tim."*** *Të dy kuajt ecën edhe për pak metra në drejtime të kundërta pastaj të dy pleqtë ndaluan, kthyen kuajt dhe bashkërisht u nisën drejt gjithë atyre burrave të cilët prisnin me ankth se cili do të ishte përfundimi. Fjalitë e pleqve edhe pse ishin thënë me zë të lartë, jo të gjithë i kishin dëgjuar mirë ndaj dhe ata u ulën përballë pjesëmarrësve dhe filluan të japin "vendimin". Fjalën, i pari e mori Lusha i cili iu drejtua djaloshit që i ishte vrarë gruaja:* ***"- Dëgjo oj shpia e X, ne e humbëm kanunin. Unë kërkova drithin (fëmijën e vrarë) por e kishim pasë shti në thes të huaj."*** *Pas Lushës e mori Noka i cili iu drejtua djaloshit dhe gjithë pjesëmarrësve:* ***"-Ti or XY, nuk i ke gjak askuj. Çdo grua ku hyn me duvak, del me qefin. Dhe kush nuk është dakord me këtë zgjidhje le të grejë pleq të tjerë se unë këtu jam."***

Gjyqi mbaroi dhe palët nuk mbetën në gjak. Në fund të fundit ky është edhe misioni i çdo pleqërimi: të mos keqësojë situatën dhe të synojë të zbusë zemrat e ndezura të palëve në konflik. Pleqërimi i bërë në Çidhën nga Noka e Lusha shpejt u bë objekt i bisedave në Dibër dhe më gjërë. Pleqërimi "në kalë" u shndërrua shpejt në "motër-kazus-precedent" edhe për raste të tjera të ngjashme deri në krahinat përreth si Mati, Elbasani etj.

II. Kanun me …shekë të kosit (!)

Këtu bëhet fjalë për një konflikt të ashpër mes fisesh për zgjidhjen e të cilit pleqtë e kanunit bënë një eksperiment fizik në prezencë të palëve të konfliktuara.

Lënda kanunore: *Rreth viteve 1870, në fshatin X të Çidhnës dy gra, njëra nusja e tjetra vjehrra, po mbushnin ujë me bucela tek një krua që ndodhej larg nga shtëpitë e fshatit, d.m.th.,* në një pyll afër. Gjatë *kohës që gratë ishin te kroi dhe po mbushnin ujë, një krismë arme dëgjohet dhe të dyja gratë tremben. Ishte krisma e armës së një fshatari i cili gjuante aty afër. Gratë mbushën bucelat dhe drejtohen nga shtëpia. Porsa shkoi në shtëpi, nusja filloi të ndihej keq dhe shtrihet në krevat. Të nesërmen nusja dështon barrën. Pas kësaj ngjarjeje situata u bë serioze. I shoqi i gruas së dëmtuar e akuzoi gjahtarin se krisma e pushkës së tij ishte shkaku i vdekjes së fëmijës në bark (!) ndaj dhe i kërkon gjakun. Lajmi mori dhenë dhe njerëzit, të afërmit e dy shtëpive në konflikt, filluan të lëviznin për t'i pajtuar. Pasi nuk qe i mundur pajtimi, palët shkuan në të drejtë. Familja e gjahtarit i deklaroi familjes së dëmtuar se "… unë të vij në të drejtë dhe pranoj atë plak që do zgjedhësh ti. " Kjo ishte një shenjë e fortë dhe tregonte se gjahtari ishte i bindur në pafajsinë e tij. Familja e dëmtuar mori plak Nokën por edhe familja e gjahtarit atë mori. Plaku i kanunit, Noka, e pranoi sfidën edhe pse i njihte shumë mirë të dy palët në konflikt . Situata kanunore nuk ishte aq e lehtë pasi duke i njohur ato fise, përplasja me armë ishte shumë pranë. Stërplaku i konakut të Nokës, i propozoi Plakut* të merrej mendimi i *esnafit* të bagëtive KM nga Fushë Alia. *Meqenëse problemi, (konflikti) kishte marrë vëmendje të madhe në opinion, Plaku i kanunit Noka vendosi që ky gjyq të ndahej larg fshatit dhe pikërisht te Gurra e Gjyqit në Prat. Aty përveç se ndodhej një fushë ku mund të uleshin njerëzit, kishte edhe ujë për të pirë por mbi të gjitha ishte emri Gurra e Gjyqit, i cili për shkak të ndodhive të mëparshme, kishte ndikim në psikologjinë e opinionit. Ishte caktuar data dhe ora e zhvillimit të gjyqit. Koha e tij ishte vendos në mëngjes rreth orës 10. Stërplaku, i porositur nga Plaku kishte siguruar një shekë*[17] *me kos të xanun një natë më parë si dhe një armë të njëllojtë me armën e përdorur nga gjahtari. Dita erdhi dhe shumë njerëz varg e varg shkonin drejt Gurrës Gjyq. Afër kroit ulet Noka dhe në krahë të tij dhe stërplaku me shekën e kosit. U zgjodh, nga pjesëmarrësit dëgjues të rastit, edhe* çekiçi për të formuar numrin tre të gjyqtarëve apo për të bërë kourumin e "trupës" gjykuese. *Plaku i drejtohet me solemnitet gjahtarit: -largoju nga këtu, aq sa ke qenë larg kroit atë ditë që ke qëlluar me armë… Gjahtari ngrihet më këmbë dhe duke e mat vendin me sy, zë vend diku përtej. Plaku i kanunit merr miratimin e palës së gruas së dëmtuar për largësinë ku u vendos gjahtari dhe i jep stërplakut armën e njëllojtë me të gjahtarit duke i thënë të qëndrojë pranë gjahtarit. Stërplaku* bëhet gati të qëllojë në ajër ndërsa Noka ngrihet më këmbë e ngadalë i afrohet *shekës* së kosit. Pas shenjës me dorë të *Plakut, krisi pushka. Plumbi çau ajrin duke lënë kumbimin në veshtë e pjesëmarrësve. Stërplaku* rëndë-rëndë afrohet te grumbulli i fshatarëve *dhe i dorëzon armën Plakut* të kanunit i cili thërret burrin e gruas së dëmtuar, *stërplakun dhe* çekiçin të cilët afrohen pranë shekës së kosit. Ngadalë, Plaku ia hoqi kapakun asaj dhe i ftoi ato të shohin nëse është " çarë cipa, mbulesa" e kosit apo jo. Burri i gruas së dëmtuar, e vërejti mirë e mirë cipën e kosit në shekë dhe tha:- Jo nuk është çarë, nuk ka krisë. U ftuan edhe disa të tjerë për ta parë. Përfundimi ishte i njëjtë: "cipa e kosit në shekë nuk është çarë…" Pas kësaj Plaku i kanunit, Noka iu drejtua burrit të dëmtuar: *"- Fëmija n'bark të nanës është si kosi në shekë. Gjahtari nuk është fajtor për vdekjen e fëmijës. Përmas k'tij shteku çdo gjahtar do i qëndrojë larg kroit sa rref pushka. Kush s'asht dakord të grejë pleqë tjerë e të hahen me mu…"*Kanuni u nda. Gjahtari mori frymë i lehtësuar. Shumica e njerëzve bashkë me Nokën por edhe burri i gruas së dëmtuar, u nisën për te shpia e gjahtarit ku do hahej buka, e cila do ishte edhe *buka e pajtimit.* Nga ajo kohë e deri në ditët tona, kjo praktikë kanunore është thirrë kanuni i *"shekës së kosit".*

III. Kanun me …kmesë(!)

Në Dibër janë të njohura dy variante të kësaj ndarjeje kanunore. Them dy variante duke marrë parasysh mënyrën e "ekzekutimit" të vendimit të Plakut. Ne Çidhën, Plaku i thirrur për të ndarë kanunin, ka përdorë kmesën (objekt prerës si satër) për të "ndarë" përgjysmë një fëmijë që e pretendonin dy gra (!). Kjo ndarje kanuni, e çuditshme, pasi ishte bërë objekt diskutimesh nëpër odat e Maleve të Dibrës, aty këtu, pësoi ndryshime. P.sh.: në Krahinën e Luznisë, për ti dhënë ngarkesa emocionale më të forta palëve në konflikt, në vend të prerjes së fëmijës me kmesë, tregohet për "shqyerjen e fëmijës me thonj nga dy gratë"(!)[18]

Lënda kanunore: *Ngjarja ka ndodhë para viteve 1850, në fshatin X të Dibrës së Poshtëme. Një banor i këtij fshati kish shumë vite martesë por nuk kishte fëmijë. Gruaja ishte "vizituar" në sa e sa plaka për tu kthye mbarë, por kishte qenë e pamundur. Burri i bindur se gruaja nuk po lindte, vendosi të marrë një grua tjetër për të mos e mbyllë derën edhe pse gruaja nuk ishte fare dakord. Ajo, i përsëriste atij prit dhe pak se dhe unë do të lind...Por kur? Pas shumë përpjekjeve nga rrethi miqësor, u arrit të gjendej një grua edhe pse ajo ishte,"copë mishi me dy sy" dhe gra të tilla quheshin "grua halli". Gruaja e parë filloi të shqetësohet dhe të grindet por që në ditët e para e kuptoi se nuk do ta kish të vështirë, pasi e reja ishte shumë e urtë. Kështu, autoriteti i së vjetrës në shtëpi ishte i padiskutueshëm edhe mbi gruan e re, e cila ishte e detyruar ta pyeste të vjetrën, apo ti tregonte asaj , për gjithçka. Pas njëfarë kohe, e reja filloi të ndjente shqetësimet e shtatzanisë dhe këtë ia tregoi së vjetrës. Shpejt e vjetra filloi realizimin e planit të cilin kishte kohë që e kish përgatit. Ajo, ia mbushi mendjen gruas së re se "është turp me i tregue burrit për këtë punë..." dhe e reja mbylli gojën para burrit. E vjetra mori situatën në dorë dhe një natë i deklaroi të shoqit se kishte mbetë "shtatzënë"(!!!). Burri u çudit, megjithatë e besoi dhe u gëzua shumë. E vjetra e këshilloi të shoqin që këtë muhabet të mos ia tregonte as gruas së re pasi ajo është e trashë dhe budalle. Veç* kësaj, e vjetra e këshilloi burrin që të marrë udhën e kurbetit pasi pas lindjes së fëmijës familja bëhet e madhe dhe duhet shpi e re, duhet me ble tokë, bagëti etj,etj. Burri nuk kish si ta kundërshtonte këtë ide, përkundrazi iu shtua më shumë admirimi për gruan e tij të vjetër e cila pas shtatzanisë(!) kishte ndryshuar shumë. Ai, ishte shprehur se po të kish mbetë gruaja shtatzënë para një viti nuk do e kish marrë edhe këtë tjetrën, të renë...Nuk shkoi shumë dhe burri u nis për kurbet i cili aso kohe ishte i gjatë në kohë dhe askush nuk kthehej pa bërë 5-6vite.

Gruaja e vjetër filloi të dalë nëpër lagje, takonte shoqet dhe deklaronte se burri iku në kurbet se duhet me ba shpi të re, pasi kam mbetë shtatzanë dhe na duhet me ble tokë, bagëti ... etj., etj. Gruaja e re, që në fakt ishte shtatzënë, qëndronte gjithnjë në shtëpi dhe ndërsa barku i saj rritej ajo i fshihej syrit të grave. E vjetra filloi të ngjishte lecka në pjesën e barkut duke dhënë pamjen e një barku që çdo ditë fryhej. Pas pak kohësh gruaja e re lindi në shtëpi, siç lindnin aso kohe gratë por në shtrat u shtri e vjetra me djalin e porsalindur në gji, ndërsa e reja shërbente. Filluan të vinin gratë e fshatit dhe uronin. Gruaja e re, i quante për mirë këto veprime të së vjetrës, i dukej normale që djalin e saj po e rriste e vjetra. Kështu jeta vazhdoi në këtë familje dhe djali rritej çdo ditë. E vjetra gjatë gjithë kohës e ushqente djalin me urrejtje ndaj së ëmës biologjike. Situata në familje gjithnjë po vështirësohej për gruan e re. Pas gjashtë vitesh burri u kthye nga kurbeti dhe gëzimi qe i madh kur pa djalin e tij që luante në oborr. Gruaja e vjetër po i fliste të shoqit, pa pushim, për vështirësitë gjatë shtatzanisë dhe sakrificat që kishte bërë për rritjen e djalit. Burri vërejti se gruaja e dytë, e reja, ishte mjaft e dobësuar, ndaj dhe një natë ai ia kërkoi me këmbëngulje arsyen. Gruaja e re merr guximin dhe i tregoi gjithçka. Burri u habit nga ajo që dëgjoi dhe kuptoi cfar kish ndodhë. Gruaja e vjetër kishte bërë hak të largohej menjëherë nga shtëpia...

Në lojë hynë edhe vëllezërit e gruas së vjetër dhe njerëzit e së resë. Situata u ngatërrua shumë. Shumë veta në fshat, edhe pse të çuditur, thonin se djalin e lindi e vjetra, ndërsa kish të tjerë që thonin të kundërtën, duke e quajtur të vjetrën grua të keqe. Një ditë ai e pyeti të vjetrën se kush e ka lindë djalin. Gruaja u bë si e xhindosur dhe filloi të bërtasë- Ti mos dëgjo atë budallenj, se ajo nuk di çfarë thotë, po pyet gratë e katundit se ato e dinë... Burri i zënë ngushtë, kërkoi ndihmë për zgjidhjen e kësaj situate.

vijon

Në kuadrin e 80 vjetorit të krijimit 20 qershor 1942.

Çeta partizane e Dibrës

Nga **Zabit LLESHI**
Xhevat JELLA*

Pushtimi i Shqipërisë nga Italia me 7 prill ishte një akt agresiv ndaj një vendi të vogël, të lirë dhe paqedashës. Ky pushtim ishte përgatitur dalëngadalë gjatë regjimit të Zogut, me anë të marrëveshjeve politike dhe ekonomike, që e kishin kthyer vendin në një gjysmë koloni. Si gjithë shqiptarët, dibranët duhet të përballonin jo vetëm prapambetjen që kish ardhur nga luftërat e gjata me pushtuesit osmanë, serbë (1912-1921), bullgarë, austriakë në vitet 1916-1918, por edhe nga masat represive të qeverisë Zogut që shpejtuan pushtimin e skllavërimin e Shqipërisë.

Me gjithë politikën për shtypjen e çdo lëvizje antiqeveritare, prapë te popullsia e thjeshtë dibrane, ndjenjat e sajë patriotike ishin gjithnjë të zgjuara. Nuk mund të harrohej gjaku i derdhur për liri e pavarësi, prandaj u orientua drejt në situatat, që kalonte vendi ynë në këtë periudhë të historisë.

Dy patriotë dibranë, Ramiz Varvarica e Urfi Agolli dhanë jetën për mbrojtjen e Republikës së Spanjës. Antifashistët dibranë që morën pjesë në kryengritjen e Fierit, kundër qeverisë së Zogut ishin Hysen Ramadan Sula nga Godvia, Ismail Teta nga Gjurasi dhe Sinan Beqir Mera nga Luznia. Ata u arrestuan dhe u pushkatuan nga Zogu si shumë patriotë të tjerë që morën pjesë në lëvizjen demokratike të marsit 1922.

Me 7 prill 1939 në Durrës Isak Metalia dhe Dan Velia dhanë jetën për mbrojtjen e Durrësit. Dibranë të tjerë u nisën drejt Durrësit me e pa organizim. Vullnetarë nga Greva, Peladhia etj., shkuan në Burrel për të marrë armë, por nuk ju dhanë. Ata u kthyen nga shkalla e Tujanit mbasi morën vesh që Italia kish hyrë në Tiranë, ndërsa Zogu ish arratisur në Greqi bashkë me oborrin mbretëror.

Zemërimi popullor sa vinte e shtohej. Filluan manifestimet në Dibër të Madhe e Peshkopi kundër fashizmit. Punëtorët dibranë që hapnin rrugën Zerqan-Klos-Burrel në vitin 1940-1941 përplaseshin çdo ditë me sipërmarrësit italianë dhe bënin thirrje që të mos paguanin taksat etj.

Operacioni fashist për çarmatosjen e popullsisë u shndërrua në një konflikt të hapur sidomos në Dardhë (Kodër-Kace). Populli u ngrit pa armë me mjete rrethanore, vegla pune, sopata, kmesa e drunj i përzunë fashistët me Xhafer Balin komandantin e tyre.

Me 7, 8, 9 prill 1939 shumë studentë nga gjimnazet e Tiranës, Shkollës Teknike Shkodër, Intelektualë nga e gjithë Shqipëria për të organizuar më mirë qëndresën kundër fashizmit erdhën në kufi për të kaluar në Jugosllavi. Forcat kufitare Jugosllave e mbyllën kufirin. Haxhi Lleshi me shumë përpjekje mundi të zhbllokojë situatën. Grumbullimi i emigrantëve u bë në Gostivar, një pjesë në Strugë e Ohër. Ishin ajka e luftëtarëve antifashistë si: Hamit Shijaku, Abedin Çiçi, Nazmi Shehu, Jashar Bunguri, Vasil Shanto, Gaqo Mosko, Sadri Drini, Mustafa Gjinishi, Stavri Bojaxhiu, Kadri Vasili, Stefo Grabocka, Halil Vasjari, Fuat Bino, Veip Demi, Islam Spahiu, Mehdi Bushi, Mehmet Stringa, Myslim Shehi, Gani Shehi etj.1

Gjatë atyre ditëve kaluan kufirin Abas Kupi me familjen, Murat Basha, Sali Llani, Xhemal Herri, major Dine Salceni dhe oficerë të tjerë zogistë, pjesëtarë të parisë Dibrës; Shaqir Dema, Murat Kaloshi, Dan e Miftar Kaloshi. Si bashkëpunëtorë të Zogut ato u lanë të lirë nga autoritetet jugosllave të dalin nëpër qytete, disa u financuan prej vetë administratës së Zogut në mërgim sidomos ata që dëshironin të largoheshin për Turqi apo gjetkë.

Jeta në Gostivar dhe në qytete të tjera u gjallërua prej të rinjve dhe emigrantëve, duke zhvilluar një propagandë mjaft efikase kundër fashizmit e pushtimit të Shqipërisë, Ahmet Zogut si dezertor duke e lënë popullin pa armë e mundësi për të luftuar. Kudo bëhej thirrje për rezistencë kundër pushtuesve dhe veglave të tyre.

Haxhi Lleshi ishte ndër antizogistët e antifashistët më aktiv në Dibër të Madhe. Rridhte nga një familje me të kaluar patriotike prej disa brezash e njohur për ndjenjat atdhedashëse . Në moshë të re përcolli vrasjen e babait prej Ahmet Zogut me një urrejtje që la mbresa në ndërgjegjen e këtij luftëtari të ardhshëm.

Haxhi Lleshi përqafon idetë përparimtare të kohës dhe i futet rrugës revolucionare për të ndryshuar realitetin dhe për ta fut vendin në rrugën e progresit.2

Shtëpia e Lleshajve u bë një strehë e emigrantëve, patriotëve që largoheshin nga Shqipëria për shkak të ndjekjeve e persekutimeve që u bëheshin si kundërshtarë të Zogut. Midis tyre ishin Myslym Peza, Kajo Karafili etj. Babë Myslymi bashkë me Lam Lekën vranë Osman Balin(njëri prej feudalëve dhe armiqve të popullit) dhe u arratis në Jugosllavi më 1930. Qëndroi atje për 9 vjet. Erdhën me Kajon pas pushtimit të



Jashar Bunguri me shokët në Gostivar, qershor 1939.

Italisë, filluan organizimin e qëndresës me luftë ndaj Italisë fashiste, pa i ndërprerë kontaktet me Haxhi Lleshin në Dibër të Madhe dhe emigrantët në Gostivar. Gjallërimi i propagandës kundër fashizmit për demaskimin " e të mirave" që bënte Italia, bashkë me veprimet bamirëse, gjoja në dobi të popullit shqiptar. Ky demaskim filloi të bëhej me anë të trakteve i shqetësoi autoritetet fashiste.

Abedin Çiçi me një grup shokësh, shtypën traktet e para që u shpërndanë në qytetet dhe fshatrat e Maqedonisë. Aktivistët besnikë; Nuz Majtara, Shefki R. Lleshi, Kadri Demiri, Sul Muça sipas porosive të Haxhi Lleshit i çonin ato në Tiranë, Elbasan, Durrës,

Kavajë, Lushnje, Fier e deri në Gjirokastër nëpërmjet miqve.3

Nëpërmjet trakteve u bëhej thirrje të rinjve shqiptarë të mos shkonin ushtarë, mos visheshin milicë. Ata që ishin mobilizuar ushtarë e milicë u bëhej thirje që të dezertonin, të mos paguanin taksat etj. Në fund të vitit 1939 qeveria e Beogradit i shpërndau emigrantët politik të Gostivarit në: Vershac disa në Bella Cerka, Valevo e Sarajevë në kushte të vështira e të papërshtatshme për jetesë. Haxhi Lleshin e internuan në Stari Beçaj afër kufirit me Hungarinë për shkak të lidhjeve që mbante me emigrantët, me Shqipërinë, bashkë me ndihmat, që kish dërguar për luftëtarët që luftonin me armë kundër Italisë. Pas shumë kërkesave për t'u afruar , qeveria Jugosllave e transferoi në Vranjë e prej aty në Shkup. Internuan familjen e tij si shumë familje të tjera të Dibrës së Madhe, Grykës së Vogël etj. Në mars 1941 merr një leje nga autoritetet e Shkupit, gjoja se kish nënën të sëmurë dhe nuk kthehet në vendin e internimit, në Shkup sepse zhurmë e madhe bëhej për përgatitjet e Italisë për të sulmuar Jugosllavinë. Në mënyrë ilegale filloi të organizojë takime e tu bëjë thirrje njerëzve të ngriheshin në luftë kundër agresionit. Gjeti mbështetjen e mjaft njerëzve për të marrë armët. Autoritetet civile dhe ushtarake nuk ju dhanë armë, por pas shumë presioneve u dhanë disa armë trofe italiane. Me një thirrje popullit brenda një kohe të shkurtër erdhën vullnetarë nga fshatrat: Bafmal, Kojnarë, Spas, Hame, Banisht, Reshan etj.

Trupat Italiane ishin vendosur përballë kufirit në dy skalione. Skaloni parë: Maqellarë-Shupenzë-Miresh-Klenjë, Librazhd, divizioni "Firence". Skalioni dytë: Smollik-Strikçan-Zerqan-Bulqizë-Bllacë- Katër Grykë, divizioni "Brenero".

Në mbrëmjen e 4 prillit 1941 Haxhi Lleshi me Ymer Lleshin me afër 200 vullnetarë dolën në krahun e majtë të rrjedhjes së Drinit, Ura e Spiles-Miresh-Sepetovë-Tërbaç-Çerenec.

Aqif Lleshi me Hamdi Lleshin zunë vijën Bllatë-Reshan-Majtarë-Maqellarë.

Duke zbardhur 6 prilli, Haxhi Lleshi sulmoi dhe mori postat kufitare të Ostrenit Vogël, Mireshit e Viçishtit dhe dolën në kodrat e Gjoricës. Vullnetarët e krahut tjetër morën; postën e Bllatës, luftimet u përqendruan në fushën e Shehrit dhe Maqellarës. U vranë shumë italianë të cilët lanë në fushën e betejës shumë armë trofe. Ushtria Jugosllave kur mori vesh se trupat gjermane kishin avancuar drejt Gostivarit dhe po i afroheshin Dibrës Madhe, hodhën armët për të mos u gjendur mes dy zjarreve. Trupat italiane u gozhduan për disa ditë, vetëm kur gjermanët pushtuan Dibrën erdhën dhe i morën në Maqellarë.

Kundër Dibrës ishte përgatitur një mësymje e gjermanëve meqë ajo ishte pushtuar nga partizanët e LNÇ nën komandën e Haxhi Lleshit. 4

Dëshmorët e parë ishin: Abdurahim Lleshi, Vehbi Jashari në Bllatë, Fasli Cami në Çerenec, Musa Cami, Mexhit Lezi, Ejup Cami në Viçisht. Brenda pak ditëve kapitulloi Jugosllavia. Italia solli përforcime të mëdha për tu hakmarrë ndaj luftëtarëve dibranë. Filluan reprezaljet, largimet, internimet, arrestimet.

Haxhi Lleshi i shpërndau luftëtarët pranë familjeve të tyre, nëpër baza të sigurta, për të qenë të gatshëm për beteja të tjera.

Italianët arrestuan: Murrat Bashën, Sali Llanin, Jashar Zelën, Ahmet Camin me Dilaver Camin, Sul Camin, Izet Camin e disa të tjerë nga fisi i Camëve i dërguan në Tiranë e në burgun famëkeq të Burrelit. Pëllumb e Lutfi Lleshin, Shaqir Skukën, Nuz Majtarën e të tjerë i internuan në Peqin, Kavajë e deri në Itali.

Çeta nuk qëndroi në një vend. Ajo filloi lëvizjen në disa fshatra të Strugës si: Mislloбezhë, Novoselë, Dollogozhdë, në lagjen Toskë etj.

Këto zona i kishim shkelur që para lufte me Myslym Pezën e Kajo Karafilin dhe emigrantë të tjerë politikë. Fashistët italianë na ndiqnin, por populli na mbronte. Njerëzit na prisnin me dashuri e respekt dhe na premtonin se do bashkoheshin me ne vullnetarë në luftën antifashiste.5

Haxhi Lleshi me grupin e luftëtarëve që e shoqëronin, lanë fshatrat e Strugës dhe erdhën në Zhupë e Sfetigrad, në fund të muajit prill dolën në: Banisht-Allajbegi-Dovolan. Kudo ku kalonin njerëzit shprehnin dëshirën për tu bashkuar me partizanët illegal por që i ruante dhe i mbronte vetë populli. Nga Dovolani në Çerenec me Sadik Koçin tek Sibe Gjurra, në Grykën e Madhe tek Cen Destan Puca familje patrioti brez pas brezi. Këtu erdhën Lym Zeneli i Sopotit, Elmaz Tonçi, Hysen Çakalli, Dull Gjini, Hajdar Shehu i Bulqizës. Prej Bulqize në Zogje, Bllacë, Katër Grykët. Për një kohë të shkurtër kaloi gjithë fshatrat e Dibrës Epërme. Mbështetje e përkrahje, gadishmëri e solidarizim për të luftuar kundër fashizmit. Për dy muaj këta vullnetarë antifashistë zhvilluan një propagandë e veprimtari të gjërë në favor e dobi të luftës. Në Mat, çeta u ndal në Patin tek Seit Çela, mik i familjes Lleshi, në Lis, në Burgajet, në Shlli e deri në Macukullin malor në familjen e Vatdodajve. Pas themelimit të PKSH në Dibër erdhën Nazmi Rushiti, Irfan Hajrullai, Demir Gashi, Xhavit Hatibi, Ahmet Jegeni, etj. Në takimin me Haxhi Lleshin ata vendosën bashkëpunimin, përcaktuan detyrat e luftës, tërheqjen e parisë së Dibrës në luftën për çlirim, lidhjet me Shqiptarët në Dibrër të Madhe, Tetovë, Kërçovë e Kosovë. U përcaktuan njerëzit që do të shoqëronin Haxhi Lleshin për në Pezë në shkurt të vitit 1942. Takimet në Pezë zgjatën disa ditë, ku u shkëmbyen eksperiencat e luftimeve me Myslym Pezën, u morën udhëzime në takimet me Enver Hoxhën e Qemal Stafën. Premtuan organizimin e luftës nacionalçlirimtare në Dibër.

Me kthimin e Haxhi Lleshit nga Peza, në Dibër erdhën kuadro të rinj si: Qazim Prishtina nga Kosova, Zoi Themeli nga Korça, u ofruan dibranët fisnikë: Musa Lala, Ali Pepa, Rahman Dervishi, Bajram Buci, Sul Muça etj. Gjatë rrugës Haxhiu bëri një takim në teqen e Martaneshit me Baba Fajën.

Haxhi Lleshi ishte pinjoll i një familje të madhe me miqësi të vjetra e të reja në Dibrën e Epërme, të Poshtme, Mat, Lumë, Tropojë, Kosovë, Shkup, Ohër, Elbasan etj. Në shtëpinë e tyre hynin e dilnin me dhjetëra mysafirë në ditë, miq, njerëz të thjeshtë, patriotë, luftëtarë, emigrantë. Ai kishte autoritet dhe një komunikim të thjeshtë me njerëzit, luftëtarët, simpatizantët e lëvizjes, veti dhe dhunti që i vuri në shërbim të luftës për liri e përparim shoqëror. Ishin pjekur kushtet për pagëzimin e çetës sepse në të vërtetë kishte kohë që njësiti qysh me 6 prill kishte vepruar si i tillë. Lufta kishte fituar simpati e popullaritet. Kudo në qytet e fshat rritej gjithnjë e më shumë ndërgjegje e besimi ndaj lëvizjes nacionalçlirimtare, prandaj kërkohej të organizoheshin njësitë partizane luftarake.

Me 20 qershor 1942 në Zogje me orientim të PKSH u krijua celula e Partisë Komuniste për Dibrën. I deleguar i KQ të PKSH ishte Ramadan Çitaku. Celula vendosi të krijohej Çeta partizane e Dibrës. Komandant u zgjodh Haxhi Lleshi, ndërsa komisar Qazim Prishtina. 20 partizanë ishin në mbledhjen themeluese. Pa u tharë boja e firmave për krijimin e çetës, u vendos menjëherë të hidheshin në aksione luftarake. Shumë shpejt çeta do të kthehej në një tmerr për armiqtë e fashistët italianë.

Aksioni i parë ishte ai i pritës së postës ushtarake me datë 26 qershor 1942 te "Gurët e Skënderbeut", kamionit të postës ushtarake që vinte nga Tirana për në Dibër të Madhe.

Në këtë përpjekje u vranë 3 ushtarë dhe u plagosën disa të tjerë. Ky aksion bëri bujë të madhe. Dengu i gazetës fashiste "Tomori" u shpua nga plumbat, ndaj u detyruan që ta asgjësojnë. Autoritetet fashiste tentuan të ndërrojnë destinacionin e postës; Lis-Qafë Murrë-Peshkopi, por edhe në këtë drejtim dështuan.

Prerja e linjës telefonike; Dibër e Madhe-Maqellarë-Zerqan-Bulqizë, aksion në shkallë kombëtare u realizua me sukses me 24 korrik 1942.

Me 26 gusht 1942 u bë përpjekja e çetës me forcat italiane te ura e Topajanit. Gjatë luftimeve u plagos komandanti çetës Haxhi Lleshi. Pas mbarimit të aksionit çeta u nda në dy grupe. Me grupin që shkoi në Shpukth ishte Haxhi Lleshi i cili i'u nënshtrua mjekimit te baza e luftës, Bajram Skarra, ndërsa pjesa tjetër e çetës shkoi në Allajbegi te Kadri Demiri.

Me 16 shtator për të përshëndetur Konferencën e Pezës, Nazmi Rushiti me një pjesë të çetës sulmoi minierën e kromit në Bulqizë. Mblodhi punëtorët italianë, i porositi që të largoheshin. U mori armët që përdoreshin për ruajtjen e minierës. Pas aksionit drejtuesit e shoqërisë fashiste "AMMI" u detyruan dhe zëvendësuan punëtorët me ushtarë të rregullt për të shfrytëzuar minierën.

Me 27 shtator Nazmi Rushiti dhe Demir Gashi organizuan dhe realizuan në Zerqan atentatin ndaj kapitenit fashist Stavri Jaho. Gjatë largimit prej vendit të ngjarjes Nazmiut i doli përpara një oficer, ndaj u detyrua që të ndërrojë drejtimin nga rruga e planifikuar për tu larguar ku e prisnin shokët. U hodh nga një mur i lartë, pësoi tronditje, dhe bije pa ndjenja. Kapet nga fashistët, torturohet gjatë gjithë rrugës për në Peshkopi. Pa mbërritur në burgun e Peshkopisë ndërron jetë.

Kjo ishte një humbje e madhe për çetën dhe luftën nacionalçlirimtare në Dibër.

Aksioni në rrugën Dibër-Strugë, 15 km nga Dibra e Madhe kundër një autokolone ushtarake ishte ai i 19 tetorit 1942. U vranë 4 oficerë, u plagosën disa të tjerë, 6 makina transporti dolën jashtë funksionit. Material i konsiderueshëm ra në duart e partizanëve të çetës, e cila u largua pa pësuar asnjë dëm. Gjatë muajve nëntor-dhjetor çeta lëvizi në: Katër Grykët, Mat, Reç e Dardhë. Kudo ajo pritej me ngrohtësi e dashuri të veçantë. Kjo shprehte përkrahjen që i bënte populli lëvizjes nacionalçlirimtare dhe vendimeve të Konferencës Pezës. Numri i partizanëve në çetë shtohej çdo ditë , gjë që u konkretizua më pas me krijimin e çetave të reja të: Grykës Madhe, Sllovës dhe asaj të Gollobordës.

Me 5 prill 1943 çeta partizane në Smollik hapi depot e drithi. Në Ostren të Madh rezervat e krijuara nga të dhjetat(taksat) që i merrej fshatarsisë nga pasanikët që shfrytëzonin djersën e tij u shpërndanë popullit. Ditën e 7 prillit të vitit 1943 u sulmua posta e rojes së financës në Ostren të Vogël si dhe u prenë linjat telefonike;Dibër-Zerqan , Zerqan-Peshkopi tek ura e Çerenecit.

Aksioni tek Hani i Trebishtit në rrugën Dibër-Strugë me 22 qershor 1943 u asgjësua një patrullë karabinierie, pastaj hyri në pritë një autokolonë ushtarake. Pas një gjysmë ore luftimi u vranë 2 karabinier e u zunë rob 5 të tjerë. Me këtë rast u pajisën me armë e municion partizanët dhe shumë vullnetarë nga Gryka e Madhe.

Në Manstirec u organizua një aksion tjetër për asgjësimin e pushtuesvë fashistë. Këto veprime tregonin se lufta nacionalçlirimtare po rritej e zgjerohej çdo ditë e më shumë. Kish ardhur koha për formimin e njësive më të mëdha luftarake siç ishin; batalionet, për pak ditë do të bëhej realitet.

Është për të ardhur keq që gazetarë të shitur, apo të keqinformuar u atribojnë aksione formacioneve partizane në kohën kur ato nuk ishin krijuar, duke falsifikuar historinë e mashtruar opinionin.

Historia shkruhet me fakte e dokumente, që për fat të mirë, sot kanë mundësi të gjithë ti gjejnë e ti hulumtojnë në arkivat që ka shteti ynë. Shtrembërimi i ngjarjeve duke u dhënë merita, personave që nuk ju takojnë, nuk u bëjnë nder, përkundrazi ju bëjnë dëm. Kjo nuk ju shërben as individëve, as pasardhësve të tyre e aq më tepër historisë, që kërkon gjithnjë të vërtetën.

Në këtë përvjetor jubilar të 80 vjetorit të çetës partizane të Dibrës, çdo dibran e bën krenar për faktin se "Dibra dhe luftëtarët e sajë u bënë një faktor i rëndësishëm në fitoren e Shqipërisë në luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare".6

** Kryetar i Komitetit të veteranëve të luftës NAÇL Bulqizë.*


1 Agolli E. 1996 Grup autorësh f. 35
2 Gjeçovi, Xh. 30. 04. 2003. Fjala në 90 vjetorin e lindjes së H. Lleshit.
3 H. Lleshi, 1996 f. 32-33
4 Hibbert 2014, Ribotim i 1991 f. 133.
5 Lleshi H., 1996 f. 43
6 Zotaj Bernard, Gazeta "Sot" 29 dhjetor 2019.

histori

Mulla Gafurri është një ndër themeluesit e shkollës së parë shqipe në Ploshtan.

Mësuesi Mulla Gafurri

Nga **ISMEN BRIKA**



Mulla Gafurr Brika lindi në fshatin Ploshtan të nën/ Prefekturës së Bice më 15.04.1875 nga prindër Rrahman Brika Emine Brika (Hafuzi).

Rrjedh nga një familje atdhetare klerikane prandaj ai gëzonte veti si njeri me karakter të fortë e me shumë dhunti, kishte vetitë e një udhëheqësi shpirtëror, kishte kulturë fetare me dije të thella të filozofisë Islame. Ishte një organizator i zoti në punët e fshatit e të xhamisë e më gjerë të zonës, ishte besimtar i përkushtuar ndaj fesë, zotit, atdheut, burrë trim e besnik i dashur me nxënësit, por dhe me xhematin. Ai zotëronte shumë mirë gjuhën shqipe, osmanishte dhe arabisht.

Mësimet fetare i mori në familje pasi ishte me origjinë prej tre brezave si hoxhallarë. Në mejtepin e fshatit Ploshtan tek Xhamia pati mësues gjyshin e tij Ismailin, Mulla Sadik Danin e Mulla Sefllahin (Sefa) nga Careni.

Në Ploshtan kishte bërë dhe 4 klasë në shkollën turke Ruzhdije me rezultate shumë të mira. Duke parë aftësitë e tij si nxënës i dalluar administrata e komunës Turke në Ploshtan e dergoje per studime ne Shkupe në shkollën "Durualumin" me profil mësues feje, shkollë të cilën e mbaroi shumë mirë. Vitet në Shkup e burrëruan, ju rritë ndjenja për atdhetari nën parimin një fetar i mirë një atdhetar i mirë".

Në këtë shkolle u njoh edhe me figura atdhetare e fetare që shërbenin në Shkup por dhe në Prizren. Aty u njoh me Sulejman Lacin, Bedri Pejanin, Sali Xhukën që ishin pedagogë në Medrese.

Njohja me këto figura të fesë në Shkup dhe me të tjerë në Lumë si Sheh Rremin e Kalisë, hoxhë Mehmetin e Shtiqnit e Mulla Jenuzin e Bice të cilët kishin shërbyer si Mifteri në nën/ prefekturën e Bice por edhe përgatitja shumë e mirë në shkollë influencuan në ecjen e tij në rrugën e fesë si mësues, por edhe si hoxhë në disa fshatra të Lumës.

Duke parë përgatitjen e tij të mirë Mifteria e Bice e dërgoi në shkollën Normale të Shkupit ku bëri një kurs të veçantë mësimdhënie në gjuhën shqipe. Në vitin 1897 caktohet mësues në shkollën Ruzhdije të Ploshtanit. Pas një periudhe njëvjeçare dërgohet për studime në Stamboll ku u kualifikua me titullin mësues feje në "Universitetin Fatih" shkollë me famë në botën Islame.

Njohuritë në këtë shkollë nuk fokusoheshin vetëm në rritjen e aftësive e njohurive në fenë islame, por kandidati që mbaronte këtë shkollë i nënshtrohej një komisioni i cili në bazë të aftësive i pajiste me një dokument që kish mbaruar këtë Universitet. Ky student fitonte të drejtën që të ishte anëtar i "Ulemas" të vëndit nga ku kishte ardhë. Ai në këtë universitet mori njohuri për teologji, pedagogji, psikologji, histori e letërsi.

Në vitin 1902 caktohet drejtues i shkollës Rruzhdije ne Ploshtan ku bashkë me Mulla Tafikin e Mulla Sadik Poten jepnin mësim në këtë shkollë.

Kjo shkollë qëndroi hapur deri ne vitin 1912, vit kur u largua Turqia. Por sipas Qamil Hoxhës kjo shkollë është mbajtur hapur nga Mulla Gafurri deri në vitin 1920 me mundësit ekonomike që kishte.

Mulla Gafurri gëzonte zgjuarsi oratorike. Kishte respektin e dashurinë e nxënësve e kolegëve por dhe të bashkëfshatarëve.

Kishte kulturë në komunikimi, urtësi e sjellje shembullore, ishte njeri me vullnet e me dëshirë për profesionin e mësuesit, kishte autoritet dhe ishte i nderuar mes kolegëve, ishte komentator i kuranit në gjuhën shqipe.

Sa herë që fatet e atdheut ishin në rrezik, Mulla Gafurri frymëzohej nga porosia e profetit Muhamet (a.s) Dashuria për atdheun është pjesë e besimit.

Ka qenë anëtar i Klubit Bashkimi të krijuar me 1908 në Ploshtan pas Kongresit të Manastirit.

-Mulla Gafurri ka marrë pjesë në luftën kundër serbit në qafë të Kolesjanit nga 14-17 nëntor. Ky qe dhe shkaku që u mor peng nga serbët në Prizren bashkë me Mulla Tafik Gjorllakun, Hasan Hidrin, Vehap Brikën. Këto u mbajtën 6 muaj në Prizren dhe më pas i lëshuan. Mbasi u kthye në Prizreni është emëruar vajzë shëtitës në fshatrat e rrafshës së Lumës.

-Më 30 nëntor 1915 deri më 16.03.1916 në Lumë qëndruan Bullgarët.

Ata si pushtues që ishin mbyllën ato pak shkolla fetare Turke, filluan çarmatosjen e popullatës, ndaluan çdo aktivitet që kishte mbi 30 persona, luftonin cdo gjë që kishte të bënte me nacionalizmin.

Kjo qe dhe shkaku që arrestuan Mulla Gafurrin. Me 6 dhjetor Mulla Gafurri duke kënduar një mevlud (të dyzetët) në Hanin e Qazim Bakallit (kafe) në fshatin Nangë arrestohet për veprimtari kundra regjimit Bullgar bashkë me disa pjesëmarrës në këtë event.

Pasi marrin në pyetje në zyrat e Bice, disa pjesëmarrës i lëshojnë dhe mbajnë të zotin e shtëpisë dhe Mulla Gafurrin që këndonte mevludin.

Ata dërgohen në Prizren dhe me gjyq të shpejtë dënohet me 6 muaj burg të cilin do ta kryej në Shkup.

-Lirohet me 6 qershor të vitit 1917 kur vendi ishte pushtuar nga austro-hungarezët. Mulla Gafurri emërohet imam në Shulla, Bejshe, Dode nga kryemifteria i Prizrenit për një vit dhe pastaj emërohet imam në Shtiqën në vend të Hoxhë Mehmetit.

- Në luftimet e shtatorit të vitit 1920 në Carakol kanë marrë pjesë Mulla Gafurri bashkë me Mulla Tafikin, Hisen Brikën, Hasan Hidrin, Malik Shabanin, Rexhep Cala, Garip Mislimi, Imer Sula, Mulla Halili, Mustaf Ademi, Hetem Heredini, Mehdi Lusha. Në këto luftime ngeli i vrarë Hisen Meta, u plagos Hasan Hidri dhe u tërhoqën në drejtim të Gramës e më vonë në malet e Shtaravicës duke mos shkuar Muhaxhirë.

Me 8 dhjetor 1921, Alush Aga hapi shkollën fetare "Mejtep" në shtëpinë e Shaban Sadikut me mësues Mulla Gafurrin.

Qamil Hoxha shkruan se shkolla u hap në shtëpinë e Shaban Sadikut, pasi xhamia e Alush Agës ishte bërë depo për forcat mercenare sërbe. Pagesën për mësimdhënien në këtë mejtep e bënte Alush Aga.

-Në vitet 1920-1922 Mulla Gafurri ishte caktuar antar i komisionit të Vakufeve në Bice ku kryetar ishte Neib efendiu nga Shtiqeni.

-Në tetor të vitit 1922 në Ploshtan vjen deputeti i Prefekturës së Kosovës Hasan Prishtina. Ai qëndroi dy netë tek Kryetari i Komunës Osman Lita, një natë ndejti tek Sheh Hajra në Caren dhe një natë tek Rufat Maliki. Ploshtan. Qëllimi i ardhjes në Ploshtan ishte hapja e shkollës Shqipe në zbatim të vendimeve të Kongresit Kombëtar të Arsimit që kishte vendos: a) Arsimi fillor i detyrueshëm

b) Në cdo komunë të hapen shkolla fillore

c) Të krijohet edukimi parashkollor

d) T'i jepet rëndësi mësimit të gjuhës shqipe e të tjerë.

-Hasan Prishtina thirri në takim kryetarin e Komunës, Sekretarin e Komunës dhe punonjësit e administratës njëkohësisht dhe Imamin e fshatit Ploshtan Tafik Gjorllaku, kryeplakun dhe pleqësinë e fshatit Ploshtan Mehdi Brika, Mulla Gafurr Brika me të cilin kishte pasur takime e njohje më parë në Bice. Në takim morën pjesë Mulla Hasan Përzhilla, Mulla Halil Skeja, Malik Shabani, Hasan Hidri, GAni Hoxhë Careni, e Sheh Hajra. Hasan Prishtina gjeti mbështetjen e pjesëmarrësve duke i përgëzuar e falenderuar. Ai u premtoi se:

a) shkolla do të financohej nga shteti

b) mësuesin do ta emërojë shteti dhe do të jetë Besim Dalliu nga Tirana, me arsim në Normalen e Elbasanit.

c) do të ketë mësues besimi, që do të jetë Mulla Gafur Brika

d) do të ndërtohet shkolla e re me shpenzimet e shtetit

e) shkolla do të hapet tek shtëpia e Daut Calës.

Shkolla u hap me 15 nëntor në shtëpitë e Daut Calës me 35 nxënës nga Ploshtani, Careni, Bushtrica e Çaj – Matranxhi. Në muajin prill 1923, mësimi është zhvilluar në "Mejtepin" e fshatit pasi kishte kandidatë më të mirë. Shkolla kishte në program: Gjuhë shqipe, këndim histori, Gjeografi, matematikë, dhe rëndësi të veçantë kishte bukurshkrimi. Në pranverë 1923 filloi ndërtimi i shkollës në Tokat e fisit Zholi dhe në shtator filloi mësimi në shkollë të re. Pajisjet e shkollës si: stola, banka, tavolina, dërrasë të zezë, lapsa, fletore, libra u siguruan nga Bicet të punuara nga mjeshtri dhe mësuesi Ndrek Cukala nga Shkodra.

Një ndihmë të madhe në mbarëvajtjen e mësimit në shkollë ka dhënë dhe përgjegjësi i arsimit në Bice Kel Vila. Nxënësit që mbaruan shkollën fillore nga Ploshtani qenë: Riza Ferati, Isak Perzhilla, Nuhi Brika, Xhelal Skeja, Muharrem Gjorllaku, Mislim Gjorllaku, Qerim Skeja, Hajredin Gjorllaku, Sheqir Lamallari, Xhafer Shira, Hasan Gjorllaku, Imer Ferati.

Pas Besim Dalliut që qëndroj dy vjet kanë ardhur mësues Gjon Kabashi, Riza Riza, Ibrahim Riza, Zeqir Zeka, Mahmut Josufi, Tef Kuqani, Ali Sadik Ndreu, Ali Neza dhe Riza Rama.

Që nga nëntori i vitit 1922 deri në maj të vitit 1939 në shkollën e Ploshtanit ka qenë mësues besimi Mulla Gafurr Brika, ku sipas listë pagesave që ndodhen në arkiva paguhej me pagë mujore 128 franga e pas vitit 1933 me lekë shqiptare. Mulla Gafurri jepte Teologji, gjeografi, këndim.

Mulla Gafurri kryente krahas detyrës së mësuesit dhe aktivitete të tjera si:

Anëtar i komisionit të zgjedhjeve për deputet në vitin 1923, ku deputet doli Avni Rustemi, ku kryetar për gjithë zonën e Kalasë Dodës ka qënë Dragodin Radiqi, e sekretar Qamil Hoxha.

Ka qenë anëtar i Kuvendit të Bashkësisë Islame me qendër në Prizren.

Ka qenë përfaqësuesi i Anës Epër në Mifterinë e Bice për vakufet e për ruajtjen e mirëmbajtjen e objekteve të kultit dhe të investimeve nga viti 1922 deri në vitin 1940.

Mulla Gafurri nga maji i vitit 1939 deri në vitin 1950 kë dhënë mësim në Mejtepin e Ploshtanit e të Carenit dhe në kohën e Ramazanit falte travin në lagjen Dode.

Mulla Gafurri është një ndër themeluesit e shkollës së parë shqipe në Ploshtan, ai do të kujtohet si njeri arsimdashës e kontribues në zhvillimin e arsimit si njeri trim, patriot e atdhetar, si njeri me edukatë e kulturë, si njeri i besës, si predikues, zbatues i riteve fetare në Ploshtan e në gjithë zonën e Kalasë së Dodës.

Tiranë 2022

Rruga e Arbërit nr. 189

profil

Beshir Laçi, fisniku i fisëm dibran

Nga **SHAQIR ÇERPJA**

Janë të rrallë dhe shumë rrallë mund të njohësh apo të takosh njerëz aq të devotshëm, aq vizionar dhe të përkushtuar, aq dashamirës, të thjeshtë, modest dhe human si Beshir Laçi, fisnikun e fisëm dibran. Poeti, shkrimtari dhe historiani i mirënjohur, Moikom Zeqo, duke kujtuar Beshir Laçin, shkruan e thotë: "... Beshir Laçi qe një shqiptar i mirë, në kuptimin më të dlirë dhe më të pastër të kësaj fjale. Beshir Laçi qe një atdhetar i mrekullueshëm. Ai qe një partizan me merita të mëdha të luftës, por përherë i heshtur dhe modest. ... Ajo që më ka bërë më shumë përshtypje tek Beshir Laçi, ishte heshtja e tij. Por ai fliste, duke heshtur. Kishte një karakter të fortë prej shqiptari dhe malësori. Nuk ishte mburravec dhe nuk kërkonte t'i njiheshin meritat që kishte. ..."


Beshir Laçi u lind në vitin 1918, në fshatin Gjurrë-Reç të Dibrës. Beshirin dhe Reçin nuk i lidhte vetëm ADN-ja biologjike, por i lidhte dhe krenaria. Beshiri krenohej për Reçin e tij dhe Reçi krenohej dhe krenohet për Beshir Laçin. Merrnin dhe i jepnin krenari njëri tjetrit. Ai lindi në truallin dhe në trojet me histori të lavdishme shumë shekullore. Ai lindi dhe ishte biri i një fisi të shquar, me tradita patriotike, trimërie, qëndrese, bese dhe bujari. Ai lindi atje, ku historia është shkruar me gjak dhe këngë. Lindi në një truall, troje dhe fis me shumë zë dhe emër, jo vetëm në Reç e Dibër, por edhe në Lumë, Mat, Mirditë, etj. Beshir Laçi jetoi, punoi e veproi në disa periudha historike të vendit tonë dhe, gjithmonë, kurdo dhe kudo krijoi dhe ka lënë gjurmë të çmuara në udhët e jetës së tij.

Që në vogëli, ai ishte një djalë i qetë, por shumë i zgjuar dhe inteligjent, me shumë dashuri për dije dhe dituri. Ai ishte i vetëdijshëm dhe e dinte se çdo dashuri ka nevojë për ushqim dhe dashuria për dije dhe dituri duhej ushqyer me vullnet, pasion, përkushtim dhe këmbëngulje. Dhe, ndonëse shumë i ri, vetëm trembëdhjetë vjeç, u nis e mori udhën e shkoi tek Myftar Kaloshi, që t'i kërkonte ndihmë për t'a regjistruar në shkollë në Internetin e Kastriotit. Shkoi, por vetëm se shkoi, se nuk gjeti e nuk mori ndihmën që kërkonte dhe nuk mundi të regjistrohej në shkollë. Dhe u kthye zemërthyer, por jo dhe shpresë humbur e besim humbur për t'u arsimuar. Një vit më vonë, hapet shkolla shqipe në Zall-Reç dhe Beshiri shkon i gëzuar për t'u regjistruar. Por mësuesi Selim Qyshka i thotë se regjistrimet kanë mbaruar, klasa është mbush dhe ka shumë nxënës e nuk ka vend më. Por megjithëse shumë i ri, Beshiri i thotë mësuesit:

-Zotni mësues! Dasma nuk prishet as pse mungon një dasmor dhe as pse shtohet një dasmor.

I befasuar nga përgjigja inteligjente e Beshirit të vogël, mësuesi Selim Qyshka e regjistron menjëherë dhe të parit nxënës në klasë, i dha librat Beshirit.

Pasi kreu e mbaroi një vit shkollë në Zall-Reç, Beshiri u nis për Tiranë, për tek një i afërm i tij, që të vazhdonte shkollën në Tiranë. Atë ditë që u nis rrugës për në Tiranë, në mbrëmje u ndal për të bujtur e pushuar tek Isuf Bej Sulejmani në Lis të Matit. Zgjuarësia e Beshirit i bëri shumë përshtypje beut të Lisit dhe ai i tha Beshirit që të mos shkonte në Tiranë, por të rrinte në shtëpinë e tij dhe të mësonte e të vazhdonte shkollën bashkë me fëmijët tij. Beshiri nuk shkoi në Tiranë dhe tri vjet qëndroi, jetoi, mësoi e vazhdoi shkollën në Lis të Matit. Pas tri vjetësh me kujdesin, interesimin dhe



Beshir Laçi
(1919-1998)

ndihmën e Isuf Bej Sulejmanit, i jepet bursë Beshirit për të vazhduar klasën e pestë në Internetin e Burrelit. Dhe pas një viti, po me ndihmën e Isuf Bej Selmanit, i jepet bursa për të vazhduar mësimet në gjimnazin e Shkodrës, ku Beshiri u njoh dhe u lidh me Qemal Stafën, Nazmi Rushiti, Vasil Shanto, Hajdar Dushin, Tomë Kolën, Haki Fejzon, etj. Të rinjët gjimnazistë të Shkodrës e pritën me indinjatë dhe zemërim pushtimin fashist të vendit tonë. Me 28 nëntor, Beshir Laçi, Nazmi Rushiti, Haki Fejton, etj., duke hedhur parulla "Poshtë fashizmi", "Jashtë pushtuesit", etj., prishën mitingun profashisht në qytetin e Shkodrës. Dhe Beshiri përjashtohet nga gjimnazi. Për veprimtari të pandërprerë antifashiste, gjykata e Shkodrës vendos që Beshiri të largohet nga qyteti i Shkodrës dhe të shoqërohet me xhandarë dhe të dërgohet në fshat, pranë familjes së tij, ku të mbahet nën vëzhgimin e komandës së vendit. Beshir Laçi nuk u kthye më në gjimnazin e Shkodrës, por filloi punë në Muhurr, magazinier në shoqërinë italiane ABC, e cila punonte për hapjen e rrugës Muhurr-Burrel dhe për ndërtimin e urës së Muhurrit, mbi Drinin e Zi. Beshir Laçi e vazhdoi veprimtarinë e tij antifashiste, jo vetëm në Muhurr e Dibër, por edhe në Tiranë, ku u njoh edhe me Gogo Nushin, Haxhi Lleshin, Dali Ndreun, Esat Ndreun, e të tjerë. Me porosi të Gogo Nushit vjen në Dibër për organizimin dhe zgjerimin e lëvizjes antifashiste. Gjatë aktivitetit të tij antifashist, u takua edhe me Nazmi Rushitin, Zejnulla Ukën etj. Gjatë gjithë periudhës Nacionalçlirimtare, Beshir Laçi zhvilloi veprimtari të dendur politike, mobilizuese dhe organizuese dhe dha kontribut shumë të çmuar në zgjerimin e lëvizjes Nacionalçlirimtare. Me krijimin e Brigadës së 18-të Sulmuese, Beshir Laçi u radhit në radhët e kësaj brigade.

Pas çlirimit të vendit, Beshirit iu ngarkuan detyra të rëndësishme. Për disa vite kreu detyrën e kryetarit të komitetit ekzekutiv të rrethit të Dibrës. Ishte njeri ëndërrimtar dhe drejtues e pushtetar vizionar dhe punoi me vullnet, përkushtim dhe këmbëngulje për zhvillimin dhe përparimin e vendit. Ishte i ndjeshëm ndaj problemeve, nevojave dhe halleve të popullit dhe punonte maksimalisht për t'u shërbyer njerëzve, për të zgjidhur dhe lehtësuar hallet e tyre. Njerëzit kujtojnë e tregojnë shumë episode nga përkushtimi i tij njerëzor, shpirtëror dhe fizik, shoqëror dhe institucional ndaj njerëzve. Liman Tanushi nga Reçi tregon se mbi shtatëdhjetë vjet më parë, pasi Limani kishte mbaruar shkollën fillore në Zall-Reç, bashkë me vëllain e tij, Qazimin kishin shkuar në seksionin e arsimit në Peshkopi për të kërkuar një bursë për Limanin, që të vazhdonte një shkollë të mesme (në atë kohë, shkolla e mesme bëhej menjëherë pas arsimit fillor). Por shefi i seksionit të arsimit u thotë se keni ardhë vonë, bursat janë shpërndarë dhe mësimi në shkolla ka filluar e nuk ka bursa më. Pasi dalin nga seksioni i arsimit, rastësisht takojnë në rrugë kryetarin e komitetit, Beshir Laçin. Pas përshëndetjes, ai i pyet se përse kishin ardhur në Peshkopi dhe ata i tregojnë se kishin ardhur të kërkonin një bursë për Limanin, që të vazhdonte shkollën e mesme, por bursë nuk gjetën e nuk morën, sepse ishin shpërndarë dhe nuk kishte më. Në moment, Beshir Laçi nxjerr një bllok, shkruan diçka dhe u jep letrën e u thotë: Nisuni për Durrës, takoni drejtorin e shkollës së mesme pedagogjike të Durrësit, Iliaz Bego, jepni letrën dhe Limani do të vazhdoj shkollën pedagogjike e do të bëhet mësues. Pastaj Beshiri i shoqëron deri tek agjensia e udhëtarëve dhe nga biletat rezervë për komitetin ekzekutiv, u jep dhe dy bileta udhëtimi për Tiranë. Me të arritur në Durrës, ata shkojnë tek shkolla pedagogjike e Durrësit, takojnë drejtorin e shkollës Iliaz Bego dhe i japin letrën e Beshir Laçit. Me të marrë dhe me të lexuar letrën e Beshirit, drejtori ishte përlotur dhe u thotë: -Me këtë letër të Beshir Laçit, jo vetëm njëri, por po të doni, të dy mund të vazhdoni shkollën pedagogjike me bursë të plotë.

Pasi punoi disa vite në Dibër, në vitin 1952, Beshir Laçi transferohet e shkon në Durrës. Fillimisht kreu detyrën e kryetarit të qarkut të Durrësit. Më pas ka kryer edhe detyra të tjera të rëndësishme, drejtor i hidrokarbureve, drejtor i NISH tullës, ka punuar edhe në portin e Durrësit, kryetar kooperative në Shkallnur të Durrësit dhe në Lurë. Kreu dhe studimet e larta në degën e agronomisë. Një periudhë kohe ka punuar edhe në ministrinë e transportit dhe vitet e fundit, në prag të daljes në pension ishte nëndrejtor i NTSH-së Durrës. Edhe në Durrës, siç shkruan e tregon edhe Moikom Zeqo, Beshir Laçi punoi me ndërgjegje e ndershmëri, me përkushtim dhe këmbëngulje, duke krijuar e lënë gjurmë të çmuara, duke fituar respektin

> Beshir Laçin ishte njeri i rrallë dhe i veçantë, njeri i drejtë dhe i ndershëm, vizionar dhe i përkushtuar, modest dhe human. Jam i sigurt se sikur politikanët dhe pushtetarët tanë të kishin cilësitë, vlerat dhe virtytet e Beshir Laçit, atëherë socializmi nuk do të kishte qënë diktaturë dhe demokracia e sotme nuk do të ishte kështu siç është anarshi

dhe mirënjohjen, jo vetëm të e qytetarëve, por të gjithë Durrësit. Para disa vitesh, për arsye pune, unë u ndodha në një familje durrësake. Duke pirë kafen e duke biseduar, muhabeti doli dhe fjala shkoi tek emri i Beshir Laçit. I zoti i shtëpisë, një burrë i moshuar, ish instruktor në komitetin e partisë të Durrësit, i emocionuar tha: -Eh, mor bir! Kush nuk e njihte Beshir Laçin!! Beshir Laçin e njihnin të gjithë, jo vetëm në qytet, por gjithë Durrësi, se ai ishte njeri i veçantë ishte burrë i rrallë. Edhe pishat e bregdetit të Durrësit, që tani po i presin pa mëshirë, janë mbjellë nga Beshir Laçi. Beshir Laçi ishte ideatori, insistuesi, projektuesi dhe këmbëngulësi për pyllëzimi e bregdetit të Durrësit. Sa episode përkushtimi dhe humanizmi tregohen për Beshir Laçin. Tregojnë se një burrë nga Skrapari, të cilit i kishte vdek gruaja, i vetëm, vetëm me një fëmijë të vogël jetonte në Durrës në kushte shumë të vështira, i pastrehë dhe i papunë. Një qytetar durrësak i thotë të shkoj të takoj kryetarin e qarkut të Durrësit, Beshir Laçin, se vetëm ai të ndihmon dhe t'a zgjidh hallin. I ndrojtur dhe mosbesues, burri i pastrehë, bashkë me fëmijën e vogël shkon në zyrën e Beshir Laçit dhe i tregon hallin e tij. Në moment, Beshir Laçi i telefonon drejtorit të portit të Durrësit dhe drejtorit të një shkollë në qytet dhe me mirësjellje u thotë se ka nevojë urgjente për ndihmën e tyre. Dhe pasi ata erdhën në zyrën e Beshirit, në prani të burrit të pastrehë diskutojnë dhe po atë ditë në zyrën e Beshir Laçit u zgjidh hallin i tij. Drejtori i portit të Durrësit e punësoi dhe i siguroi një dhomë për banim, ndërsa drejtori i shkollës mori djalin e vogël, e çoi tek shkolla dhe e sistemi në një klasë.

Në mesin e viteve '80 isha për vizitë në familjen e Beshir Laçit në Durrës. Banonte në një apartament të thjeshtë, ku biblioteka e tij e madhe zinte më shumë hapësirë se sa gjithë objektet mobiluese të shtëpisë.

Beshir Laçi jetonte dhe punonte në Durrës, por asnjëherë nuk e hoqi mendjen dhe nuk e shkëputi mendimin dhe interesimin e tij për Dibrën dhe dibranët. Mbahet dhe do të mbahet mend, jo vetëm dëshira, por kujdesi, interesimi dhe thirrja e Beshir Laçit për popullin e Reç e Dardhës, që të shkonin masivisht dhe të vendoseshin në zonën bregdetare Durrës-Kavajë, duke u garantuar mbështetje institucionale shtetërore për tokë, strehim e punësim.

Të shkruash për Beshir Laçin nuk mjafton një faqe gazeta, as disa faqe dhe disa gazeta. Ai ishte njeri i rrallë dhe i veçantë, njeri i drejtë dhe i ndershëm, vizionar dhe i përkushtuar, modest dhe human. Jam i sigurt se sikur politikanët dhe pushtetarët tanë të kishin cilësitë, vlerat dhe virtytet e Beshir Laçit, atëherë socializmi nuk do të kishte qënë diktaturë dhe demokracia e sotme nuk do të ishte kështu siç është anarshi

homazh

Hysni Bruçi, mësuesi që dha kontribut në arsim, letërsi, art dhe kulturë në Dibër

Të enjten e 2 qershorit 2022 ndërroi jetë Hysni Bruçi, një nga personalitetet dibrane, i njohur për kontributin e tij real në zhvillimin e arsimit, letërsisë, artit dhe kulturës në Dibër.

Ai lindi në Lukan të katër Grykëve më 17 gusht 1941, por rrethanat e sollën që të rritej te gjyshja e tij nga e nëna në Muhurr. Këtu kaloi fëmijërinë dhe mori shkollimin bazë, duke bërë dallimin nga bashkëmoshatarët si nxënës shembullor. Me të njëjtin nivel dijesh dhe zelli për të mësuar Ai do të ndiqte dhe mbaronte me rezultate të shkëlqyera Shkollën e Mesme Pedagogjike "Ndrec Ndue Gjoka" në Tiranë (e më pas edhe Shkollën e Lartë dy vjeçare pa shkëputje nga puna) për t'u kthyer si mësues në shkollat e vendlindjes së tij.

Ndërkohë, mësuesi i lëndëve gjuhë shqipe – histori në shkollën 8-vjeçare "Nexhat Agolli" Muhurr, në vitet 1960-1961, që kishte shërbyer edhe në shkollat e zonave Luzni e Kastriot si dhe me klasë kolektive në Rreth-Kale e Shqath, do të shpërthente si një talent i rrallë në krijimtarinë poetike të asaj kohe. Kështu, në vitet '60-'70-të të shekullit të kaluar, në faqet e gazetave e revistave, të përditshme, javore e të përmuajshme periodike që botoheshin në Tiranë, do të tërhiqte vëmendjen firma e mësuesit Hysni Bruçi nga Muhurri i Dibrës. Publicistika e tij po zinte vend të rëndësishëm në gazetat "Zëri i Popullit", "Mësuesi", "Bashkimi" etj. Po ashtu në rubrikat letrare-artistike të gazetave "Drita", "Zëri i Rinisë" e "Puna" si dhe të revistave "Nëntori" e "Ylli" ai do të shfaqej, jo vetëm me reportazhe e skica letrare, por edhe me vjersha e poema.

Ai, qe ndërkohë nga të parët që u angazhua me Lëvizjen Amatore në fshat. Pasi kishte spikatur për talentin e tij si poet me vjershat e poemat e botuara në shtypin qendror, Hysni Bruçi mori pjesë edhe në përgatitjen e Almanakëve të parë letrarë "Dibra".

Që me fillimin e botimit të gazetës lokale "Ushtima e Maleve" nisi të punojë aty, një vit si korrektor letrar e pastaj për disa vite si redaktor për kulturën e punën me talentet e reja letrare.

Në gjysmën e dytë të viteve ''70-të, në Dibër po bëhej një hop përpara për gjallërimin e jetës artistike dhe kulturore dhe gazeta "Ushtima e Maleve", sektorin e kulturës të së cilës e drejtonte Hysni Bruçi pati ndikim të dukshëm në nxitjen e promovimin e talenteve të reja. Madje, që këtu u evidentuan dhe u tërhoqën në institucione njerëz të pasionuar e të përkushtuar.

Në mars të vitit 1978 fillon punën në sektorin e kulturës të Komitetit Ekzekutiv, ku dha një kontribut të çmuar për organizimin dhe masivizimin e artit e kulturës në rrethin e Dibrës. Ishte koha kur u arrit që Estrada e Peshkopisë të klasifikohej "profesioniste" dhe të krahasohej me të Korçës, Sarandës dhe të Fierit. Ajo arriti të realizonte katër premiera në vit dhe të përfaqësohej denjësisht edhe në eventet kombëtare. Pasurimi i orkestrës së saj me instrumentistë të shkolluar të oboes, flautit, trombës, violinçelit etj, është padyshim edhe meritë e Hysni Bruçit që drejtonte sektorin e kulturës në Komitetin Ekzekutiv të rrethit. Ai inkurajoi dhe mbështeti muzikantë të talentuar që të krijonin e drejtonin grupe të ndryshme artistike. Në Lëvizjen Artistike u përfshinë këngëtarë që bënë emër brenda e jashtë vendit. U rrit profesionalizmi në trupën e aktorëve e të regjive të shfaqjeve; u rrit niveli artistik edhe me skenografinë e shfaqjeve. Gjatë kohës që Hysni Bruçi drejtonte Sektorin e Kulturës në Komitetin Ekzekutiv të rrethit u krijua edhe Trupa e Teatrit Dramatik Amator që realizonte dy deri në tri premiera në vit. Vatër e argëtimit të fëmijëve u bë Teatri i Kukullave. Orkestra Frymore e qytetit të Peshkopisë arriti të marrë çmimin e dytë në takimin kombëtar të Korçës. Shtëpia e Pionierit po bëhej shkollë për përgatitjen e talenteve të reja. Dega e Librit, me çeljen e 16 librarive në fshat e në qytetet Peshkopi e Bulqizë përmirësoi dukshëm punën me librin. U krijua edhe Dega e Monumenteve të Kulturës. U ngrit edhe Ansambli Artistik "DIBRA" (që fatmirësisht e ruan edhe sot këtë emër), i cili arriti të japë shfaqje të suksesshme edhe jashtë vendit, si në Turqi, Prishtinë, Shkup etj. Hysni Bruçi pati rol parësor edhe në formimin e Shoqatës së Historianëve si dhe të Bërthamës Arkeologjike të rrethit të Dibrës. Puna studimore solli edhe riorganizimin e Muzeut Historik dhe ngritjen për herë të parë të Muzeut Etnografik të rrethit. Sipas një programi të posaçëm pune të Sektorit të Kulturës në Komitetin Ekzekutiv që drejtohej nga Hysni Bruçi, u ngritën Muze Tematikë në Dovalan, Sinjë, Okshtun, Bulqizë, Ostren, Lurë, Zerqan, Zogje e Kastriot. Po bëhej praktikë pune që çdo vit të organizoheshin sesione shkencore në zona.

Në ato vite, Rrethi Letrar i Dibrës fitoi statusin e Degës së Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të rrethit. Dhjetëra krijues dibranë që tanimë kanë botuar edhe librat e parë me poezi e tregime, debutimin e parë e patën në gazetën lokale "Ushtima e Maleve", në kohën kur sektorin e artit, kulturës e letërsisë e drejtonte redaktori i talentuar Hysni Bruçi.

Për piktorët e skulptorët u dhanë 9 studio. Sektori i Artit Figurativ arriti që çdo vit të çelë ekspozitë. Punët e disa piktorëve dibranë zinin vend në ekspozitat vjetore kombëtare. Masivizimi solli që disa qendra pune e shkollat të ngrenë grupet artistike.

Të 26 shtëpitë e kulturës në zona arritën të ngrenë grupet folklorike me 50-60 pjesëmarrës. Në orkestrat e tyre hynë edhe instrumente të rrallë muzikorë si: gajdja e Klenjës, kavalli i Kastriotit, fyjet e Selishtës, lauria e Murrës, culet e Venishtit e Palamanit, sharkia e Çidhnës, pipzat e Lurës etj. Hysni Bruçi tregon se orkestra e grupit folklorik të Çidhnës kishte rreth 30 instrumentistë.

Po ashtu ai vlerëson krijimin dhe interpretimin e valleve si: vallja e brezave, vallet lirike të Grykës së Vogël e të Kalasë së Dodës, vallja e Xhafer Kabës, vallet dyshe të burrave të Zall Dardhës, Muhurrit e Maqellarës, vallja këmbë mbas këmbe e Katër Grykëve, Vallja "Hore" e Sllovës, vallja humoristike e Pollozhanit etj.

Shpërthyen këngë brilante si: "Na knojnë pushkët nëpër kulla", "Shtatë liqejt e Lurës", "300 duvakët", "Këngë për Mahmut Dacin", këngët epike për Kosovën ("O prite Azem Galicën", "Këngë për Jakup Ferrin") etj. Emra këngëtarësh të tjerë dibranë u bënë të njohur e të dashur për artdashësit brenda dhe jashtë vendit Vlerësimi i mëtejshëm i punës me folklorin, për të cilin H.Bruçi tregoi përkushtim të rrallë, bëri që Dibra të marrë vendin e parë në Festivalin Folklorik kombëtar të vitit 1978.

Hysni Bruçi ka realizuar edhe kumtesa e studime për çështje të historisë e kulturës së kësaj treve. Ato janë referuar në Sesione Shkencore e disa janë botuar në revista e organe shtypi. Të tilla kanë qenë: "Tema e Qëndresës në krijimtarinë e popullit", botuar në "Dibra e dibranët", "Vlera pedagogjike në Abetaren e Kolë Gjumarit", botuar në gazetën "Mësuesi", "Disa të dhëna historike për lidhjet e Dibrës me Qeverinë e Vlorës të 1912-tës", mbajtur në Konferencën Shkencore të Kulturës të rrethit (1978); "Mbi disa shkaqe e koncepte të mënyrës së jetesës" si dhe "Shkaqe e pasoja të thashethemeve", botuar në "Zëri i Popullit". Gjithashtu Hysni Bruçi ka realizuar trajtesa me vlerë, si: "Ornamenistika në kostumet e shtatë zonave etnografike të Dibrës", "Instrumentistë në kohë që bënë emër dhe Orkestra Folklorike e Dibrës", "Figura mëmëdhetare të Dibrës dhe çështje të simboleve përkujtimore", "Zall Dardha – një nga djepet e folklorit të Dibrës", "Rapsodia Dibrane dhe profile rapsodësh" etj. Do të mjaftonte qoftë dhe botimi në një libër i këtyre kumtesave, studimeve e trajtesave, të realizuara, të mbajtura në sesione shkencore e të botuara me firmën e Hysni Bruçit, për të kuptuar kontributin e tij të veçantë për zhvillimin e letërsisë, artit e kulturës në Dibër.



studime për çështje të historisë e kulturës së kësaj treve. Ato janë referuar në Sesione Shkencore e disa janë botuar në revista e organe shtypi. Të tilla kanë qenë: "Tema e Qëndresës në krijimtarinë e popullit", botuar në "Dibra e dibranët", "Vlera pedagogjike në Abetaren e Kolë Gjumarit", botuar në gazetën "Mësuesi", "Disa të dhëna historike për lidhjet e Dibrës me Qeverinë e Vlorës të 1912-tës", mbajtur në Konferencën Shkencore të Kulturës të rrethit (1978); "Mbi disa shkaqe e koncepte të mënyrës së jetesës" si dhe "Shkaqe e pasoja të thashethemeve", botuar në "Zëri i Popullit".

Vetëm një muaj para se të ndërronte jetë, ai botoi librin "Krojet e këtyre viseve thonë", me një lëndë aq të pasur dhe e



larmishme si dhe vetë poezia e këtij liriku, që pas akumulimit të tij në pesë dekada sjell për lexuesin poezi që u shkrumbëzuan dhe u hirnosën, ndoshta të kyçura në sirtaret e tavolinave të tij të punës si mësues, redaktor letrar në "Ushtima e Maleve" e inspektor i kulturës në ish-Komitetin Ekzekutiv të Dibrës...apo në sepetet e shtëpive të tij në Lukan, Muhurr e Peshkopi, dhe që dalin në dritë me një shkëlqim të rrallë. Në tetë ciklet e këtij libri me poezi Hysni Bruçi vjen si model i poetit të epikës dhe lirikës dibrane, ku përveç bukurive natyrore, ai përçon në vargje pothuajse gjithë historinë disa shekullore të Dibrës. Ndaj dhe Dibra e dibranët do ta kujtojnë atë me respektin e nderimin që meritonte.

Lamtumirë shoku e miku ynë Hysni Bruçi!

Shpirti yt lulëzoftë në kopshtet më të bukura të parajsës!

Faik BRUÇI, Halil RAMA, MEVLUD BUCI

“Futboll buzë Drinit” një veprimtari sportive që zbuloi bukuritë e panjohura të Dibrës



Më 21 maj 2022, në Fushë-Alie u zhvillua veprimtaria “Futboll buzë Drinit”, organizuar nga gazetari sportiv Defrim Methasani - Qytetar i Nderi i Dibrës.

Methasani ka qene disa vite mësues në këtë fshat dhe rikthehet me këtë veprimtari, së bashku me miqtë e tij, si një mënyrë për të promovuar këtë krahinë , e cila rrezikohet nga ujëmbledhësi i Skavicës.

Aktiviteti rezultoi të jetë një manifestim i madh sportiv e artistik në Fushë-Alie të Dibrës, në një prej vendeve më të bukura të Shqipërisë, buzë lumit Drini i Zi. Në organizimin e aktivitetit patën kontribut shumë njerëz që kanë lindur në këtë zonë, ndërkohë që miq të shumtë e të ftuar kishin ardhur nga qytetet e ndryshme të vendit e madje nga shumë vende të botës, duke sjellë një atmosferë festive që rrallë ishte parë gjatë këtyre viteve në këto anë. Një ndihmesë në zhvillimin e këtij aktiviteti e dha edhe Bashkia e Dibrës me kryetar Rahim Spahiun.





GARAT

Organizimi festiv sportiv parashikonte disa ndeshje futbolli, ku organizatorët kishin përfshirë gjithsej 4 ekipe me emërtime shumë domethënëse si “Vendasit”, “Ish-nxënësit”, “Diaspora” dhe “Gazetarët”, me sistem eliminimi. Në fund, turneun “Futboll buzë Drinit” e fitoi ekipi i “Diasporës” që vinin nga Belgjika. Për fituesit u dhanë medalje e kupa të ndryshme. Duhet thënë se me këtë rast u shpërndanë çertifikata mirënjohjeje për emra të spikatur të futbollit e të sportit në tërësi që kanë dalë nga kjo zonë. Entuziazmin e rriti edhe prania e skuadrës së Korabit. Duhet thënë se personalitete të sportit, gazetarisë sportive në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut, si dhe njerëz të artit, kulturës e arsimit kishin zgjedhur të ishin më 21 maj në Dibër, për të parë e kontribuar në këtë manifestim të madh sportiv dhe artistik. Spikati me praninë e tij ish-futbollisti i Flamurtarit dhe Kombëtares, Kreshnik Çipi e shumë emra të tjerë. Një aktivitet, që siç e përmendëm, u zhvillua në një prej vendeve më të bukura e më të begata të Shqipërisë, siç është lugina e Drinit të Zi, aty ku jeton një komunitet i spikatur për vlerat e tij të mikpritjes, kulturës dhe sportit.

LIBRA DHE MATERIALE SPORTIVE PËR SHKOLLËN

Në kuadër të këtij manifestimi të madh, një nga momentet më emocionuese ishte dhënia e dhuratave për shkollën në Fushë-Alie. Uniforma sportive, bazë materiale sportive dhe libra për bibliotekën ishin dhuratë për mësuesit dhe nxënësit e shkollës.

“Një tjetër moment emocionues për mua dhe gjithe të ftuarit ishte momenti ku së bashku me mikun tim të çmuar dhe ish nxënësin tim të para viteve 90-të, Bujar Karoshi, realizuam në shkollën e Fushë-Alies. Uniformat sportive, baza materiale sportive dhe librat për bibliotekën, ishin dhuratë për mësuesit dhe nxënës e shkollës”, shkroi Methasani në profilin e tij në Facebook.

Ai falenderoi edhe drejtoreshën e Zyrës Vendore Arsimore Dibër Brikena Dani dhe stafin e shkollës me drejtor Izmir Shehu, të cilët e vlerësuan shumë këtë gjest. Falenderoj dhe ish drejtorin e shkollës Begu Hajri dhe ish mësuesit e saj, Zylfi Spata, Mehmet Saraçi, Rruzhdi Bitri, Pëllumb Uka, Dine Sina, Gëzim Kaba, Piro Qose, të cilët na u bashkuan në këtë ditë festive.

“I lehtësuar tashmë si kurrë më parë. Misioni u kry. Futboll buzë Drinit mori bekimin e tij, falë qindra e mijëra njerëzve që u bënë pjesë e tij në Fushë-Alie të Dibrës. Falënderoj me shpirt çdokënd që më mbështeti, që mu bë krah, më ndihmoi dhe më motivoi. Aty ku dikur bëheshin betejat e luftës, aty ku të duket se natyra ka pikturuar me dorë, aty këtë 21 maj u luajt futboll, u dhuruan kupa, medalje, uniforma, topa, u kënduan këngë, u bënë valle, u shpalos traditë, u dhuruan libra dhe u bë tifozllik. Falënderoj ata njerëz që na pritën siç i ka hije Çidhnës dhe Dibrës”, shkroi pas aktivitetit gazetari e njëherësh organizatori Defrim Methasani.

Adriatik Balla

REKLAMO BIZNESIN TËND

Një faqe e plotë me ngjyra kushton 15000 lekë

Me **1000** lekë mund të rezervosh një reklamë gjatë gjithë vitit në format kartvizite (8x5cm)

NE JEMI GAZETË E LIRË DHE E PAVARUR NGA NDIKIMI POLITIK. PAVARËSIA DHE LIRIA JONË GARANTOHET VETËM NGA MBËSHTETJA E LEXUESVE...
BËJ PAJTIMIN TËND!
Një pajtim vjetor kushton: **600 lekë.** Në Europë: **10 Euro.** Në SHBA dhe vende të tjera: **15 USD**.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

Botimi i gazetës është punë vullnetare, ndaj çdo pajtim vjetor ose dhurim, është i mirëpritur.
Dhurimet pranohen **VETËM PËRMES LLOGARISË BANKARE** që gjendet më poshtë dhe për çdo rast ai do të bëhet publik.
Raiffeisen Bank, Rr. Kavajës, Tiranë.
SWift code: SGSBALTX.
IBAN(ALL): AL44 2021 1219 0000 0000 1003 6640